Republika e Shqipërisë
Prefekti i Qarkut Fier

# Plani i Qarkut për Emergjencat Civile

## Qarku Fier

2025

Sweden Sverige

CAMÕES INSTITUTO DA COOPERAÇÃO E DA LÍNGUA PORTUGAL MINISTÉRIO DOS NEGÓCIOS ESTRANGEIROS

REPUBLIKA E SHQIPËRISË MINISTRIA E MBROJTJES

AGJENCIA KOMBËTARE MBROJTJES CIVILE

UNDP

## Grupi i punës, Prefekti i Qarkut Fier

1. Arben Velo - Sekretar i Përgjithshëm, Administrata e Prefektit
2. Kreshnik Ymeraj - Përgjegjës i Sektorit të Planifikimit, Përballimit të Emergjencave Civile dhe Krizave, Administrata e Prefektit
3. Vilson Bufazi - Specialist Qendra e Mbrojtjes Civile për qarqet Fier, Vlorë dhe Gjirokastër me qendër në Fier
4. Alma Gjonaj - Përgjegjës i Sektorit Juridik, Administrata e Prefektit
5. Ervis Nilo - Përgjegjës i Zyrës së Gjendjes Civile, Arkivi Fier
6. Sanie Çepele - Përgjegjës i Sektorit të Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, Administrata e Prefektit
7. Rovena Nallbani - Përgjegjës i Sektorit të Zhvillimit Urban, Administrata e Prefektit
8. Blerta Gjoka - Specialist i Sektorit të Monitorimit të Kompentencave Vendore dhe Funksioneve të Deleguara, Administrata e Prefektit
9. Bexhete Xhelilaj - Specialist i Sektorit të Planifikimit, Përballimit të Emergjencave Civile dhe Krizave, Administrata e Prefektit

Mbështetur nga: Forcimi i Aftësisë Ripërtëritëse në Shqipëri – Projekti RESEAL, UNDP në Shqipëri

## Grupi i Punës UNDP

1. Elvita Kabashi – Specialiste Programi, Drejtuese e Departamentit të Mjedisit, Energjisë dhe Klimës të UNDP në Shqipëri
2. Doreid Petoshati- Koordinator Kombëtar i Projektit RESEAL të UNDP në Shqipëri
3. Maksimiljan Dhima- Konsulent Kombëtar i Projeketit RESEAL të UNDP në Shqipëri

## Grupi i punës AKMC

1. Haki Cako - Drejtori i Përgjithshëm
2. Adisa Bala - Drejtor i Zvogëlimit të Riskut, Fatkeqësive dhe Parandalimit
3. Sadik Balliu - Specialist në Sektorin e Planifikimit të Mbrojtjes Civile, Drejtoria e Zvogëlimit të Riskut, Fatkeqësive dhe Parandalimit
4. Xhesi Besho - Specialist në Sektorin e Planifikimit të Mbrojtjes Civile, Drejtoria e Zvogëlimit të Riskut, Fatkeqësive dhe Parandalimit

## Grupi i ekspertëve ICLA & GRI

1. Leonardo Ermini – Drejues Ekipi
2. Eldisa Zhebo – Koordinatore Projekti
3. Armando Curriano – Ekspert Trajnimi dhe Ushtrimesh
4. Daniele Sforzi – Specialist i Menaxhimit të Emergjencave
5. Dukate Dodaj – Specialist i Logjistikës dhe Menaxhimit të Burimeve
6. Rildo Ngjela - Specialist për Informimin Publik dhe Angazhimin e Komunitetit
7. Donald Vullnetari – Ekspert i Qeverisjes Vendore dhe Ndërtimit të Kapaciteteve
8. Alvi Minga - Specialist Mbështetës i Menaxhimit të Emergjencave

Mbështetur nga: Forcimi i Aftësisë Ripërtëritëse në Shqipëri – Projekti RESEAL, UNDP në Shqipëri

***Falënderime***

*Ekipi i konsulentëve shpreh mirënjohje dhe falënderime për Prefektin e Qarkut Fier, z. Arben Çuko, dhe ish Prefektin e Qarkut Fier, z. Lefter Shehaj, të cilët kanë qenë personalisht të angazhuar në procesin e hartimit të dokumentit duke dhënë drejtimin planifikues lidhur me prioritetet e qarkut Fier për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe impaktet prej tyre.*

*Falënderojmë gjithashtu Sekretarin e Përgjithshëm të Prefekturës dhe të gjithë anëtarët e grupit të punës të cilët kanë kontribuar në mënyrë aktive në përgatitjen e të gjitha fazave planifikuese dhe elementeve përbërëse të planit të qarkut Fier për emergjencat civile.*

*Një falënderim i veçantë shkon edhe për Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile për koordinimin edhe asistimin në këtë proces dhe UNDP në Shqipëri, si pjesë e zbatimit të projektit "Forcimi i Aftësive Ripërtëritëse në Shqipëri – Projekti RESEAL", të cilët kanë bërë të mundur një bashkërendim shumë të mirë të aktorëve të përfshirë në procesin e përgatitjes së planit të qarkut të emergjencave civile, si dhe kanë mbështetur procesin në të gjitha hapat e tij duke kontribuar me ekspertizën dhe njohuritë e tyre në fushën e mbrojtjes civile.*

*Ky material u përgatit nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Fier me mbështetjen teknike të ICLA&GRI, në kuadër të projektit: "Forcimi i aftësive ripërtëritëse në Shqipëri" RESEAL të UNDP dhe nën koordinimin e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile. Projekti RESEAL financohet nga Qeveria Suedeze, Portugeze dhe ajo Shqiptare. Mendimet dhe opinionet e shprehura në këtë dokument i përkasin autorëve realizues dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e donatorit.*

*Shënim: Ky dokument është pronësi intelektuale e Institucionit të Prefektit të Qarkut Fier dhe përdorimi i të dhënave në përmbajtje të këtij dokumenti duhet të kryhet gjithnjë duke cituar burimin e informacionit dhe vendosur referencat përkatëse.*

# Tabela e Përmbajtjes


**1 Kuadri ligjor dhe strategjik për mbrojtjen civile ..... 11**

1.1 Kuadri kombëtar ligjor dhe strategjik për mbrojtjen civile ..... 11

1.2 Qarku Fier: Kuadri institucional dhe dokumentet kryesorë për Mbrojtjen Civile ..... 12

1.3 Qëllimet dhe objektivat e përgjithshme të PQEC të Qarkut Fier ..... 13

**2 Parimet e funksionimit të PQEC ..... 14**

2.1 Parashikueshmëria dhe gatishmëria ..... 14

2.2 Vendimmarrja, lidershipi dhe pronësia ..... 14

2.3 Informacioni ..... 15

2.4 Integrimi dhe bashkëpunimi me grupet e interesit ..... 16

2.5 Përshtatja e Kuadrit Sendai, OZHQ-ve dhe Ndryshimeve Klimatike në nivel vendor dhe nivel qarku ..... 17

**3 Sistemi i Mbrojtjes Civile në nivel qendror, nivel qarku dhe në nivel vendor ..... 20**

3.1 Institucionet dhe Strukturat Qendrore të Mbrojtjes Civile ..... 20

3.2 Institucionet dhe strukturat e Mbrojtjes Civile në nivel qarku dhe bashkie/vendor ..... 22

3.2.1 Institucionet dhe strukturat e mbrojtjes civile në nivel qarku ..... 22

3.2.2 Strukturat dhe institucionet e Mbrojtjes Civile në nivel vendor/bashkie ..... 29

**4 Parandalimi/Lehtësimi ..... 36**

4.1 Strukturat dhe institucionet përgjegjësitë e tyre për parandalimin/lehtësimin në nivel qarku ..... 37

**5 Gatishmëria ..... 51**

5.1 Analiza e riskut për Qarkun Fier ..... 51

5.2 Informimi dhe ndërgjegjësimi publik ..... 52

5.3 Masat e gatishmërisë ..... 56

5.4 Qendrat e koordinimit dhe zonat e paracaktuara për evakuim dhe përdorimi i tyre për aktivitete në funksion të përgjigjes në raste të emergjencave civile ..... 58

5.5 Strukturat dhe institucionet përgjegjëse për Gatishmërinë në nivel qarku ..... 60

**6 Përgjigja ..... 75**

6.1 Qëllimet kryesore të përgjigjes ..... 75

6.2 Aktivizimi i përgjigjes në Shqipëri ..... 76

6.3 Aktivitetet e Institucionit të Prefektit të qarkut në fazën e përgjigjes ..... 78

6.3.1 Etapa I: Alarmi për rritjen e gatishmërisë ..... 78

6.3.2 Etapa II: Vendosja e gjendjes së gatishmërisë ..... 79

6.3.3 Etapa III: Aktivizimi ..... 80

6.3.4 Etapa IV. Dalja nga situata ..... 81

6.4 Përgjegjësitë e strukturave dhe institucioneve për përgjigjen në nivel qarku ..... 83

6.5 Funksionet e Përgjigjes ..... 100

# Tabela e Përmbajtjes


**7 Rimëkëmbja** ..... **106**

7.1 Parimet e rimëkëmbjes dhe zbatimi i tyre në Qarkun Fier ..... 106

7.2 Aktivitetet afatshkurtra ..... 107

7.3 Aktivitetet afatmesme ..... 107

7.4 Aktivitetet Afatgjata ..... 109

7.5 Roli i institucioneve, strukturave dhe aktorëve të tjerë institucionalë gjatë rimëkëmbjes ..... 111

7.6 Roli i grupeve jo-institucionale të interesit në rimëkëmbje ..... 122

7.6.1 Roli i Donatorëve dhe kontributi i sektorit privat ..... 122

7.6.2 Roli i individëve dhe komuniteteve në rimëkëmbje ..... 123

**8 Skenarët** ..... **123**

8.1 Skenari i Riskut nga Përmbytjet ..... 123

8.2 Skenari i Riskut të Zjarreve ..... 131

**9 Referenca** ..... **142**

**ANEKSE** ..... **145**

**Aneks 1: Raportimi Fillestar i Emergjencës** ..... **145**

**Aneks 2: Formate orientuese për komunikimin me publikun, sipas etapave** ..... **149**

**Aneks 3: Tabelat e Kapaciteteve** ..... **151**

## Lista e Tabelave

Tabela 1: Strukturat dhe institucionet përgjegjësitë e tyre nëfazën e parandalimit/lehtësimit – Qarku Fier 37

Tabela 2: Strukturat dhe përgjegjësitë e tyre në fazën e gatishmërisë – Qarku Fier 60

Tabela 3: Etapat e Përgjigjes 76

Tabela 4: Etapa 1: Alarmi për rritjen e gatishmërisë 78

Tabela 5: Etapa II: Vendosja e gjendjes së gatishmërisë 79

Tabela 6: Etapa III: Aktivizimi 80

Tabela 7: Etapa IV. Dalja nga situata 82

Tabela 8: Institucionet dhe strukturat, rolet dhe përgjegjësitë e tyre në fazën e Përgjigjes – Qarku Fier 83

Tabela 9: Strukturat dhe përgjegjësitë e tyre në fazën e rimëkëmbjes – Qarku Fier 111

## Lista e Figurave

Figura 1: Emergjencat/model mbi vendimmarrjet për fatkeqësitë 15

Figura 2: Institucionet dhe strukturat qendrore të mbrojtjes civile 20

Figura 3: Ministria përgjegjëse për Mbrojtjen Civile dhe ndërveprimi i saj me nivelin qendror dhe atë vendor (qark/bashki) 21

Figura 4: Strukturat e mbrojtjes civile në nivel qarku dhe QOECQ 24

Figura 5: Strukturat e mbrojtjes civile në nivel vendor dhe QOECB 29

Figura 6: Protokolli i Komunikimit gjatë Emergjencave Civile dhe Roli i Institucionit të Prefektit të Qarkut Fier 53

Figura 7: Buletini ditor nga IGJEO mbi parashikimin e rrezikut hidro-meteorologjik 56

Figura 8: Rreziku i zjarreve në pyje - Buletini ditor i IGJEO 57

Figura 9: Modeli i Ndërhyrjes për Menaxhimin e Emergjencës 77

Figura 10: Etapa 4 “Dalja nga Situata” 83

# Lista e Akronimeve

| | |
|---|---|
| AKMC | Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile |
| BE | Bashkimi Europian |
| EC | Emergjenca Civile |
| EKKSH | Ekipet Kombëtare të Kërkimit dhe Shpëtimit |
| DQO | Drejtues Qendror i Operacionit |
| DOB | Drejtuesi i Operacionit në Bashki |
| DOQ | Drejtuesi i Operacionit në Qark |
| DPRMSH | Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit |
| KM | Këshilli i Ministrave |
| KMCB | Komisioni i Mbrojtjes Civile në nivel Bashkie |
| KMCQ | Komisioni i Mbrojtjes Civile në nivel Qarku |
| KNEC | Komiteti Ndërministror i Emergjencave Civile |
| MB | Ministria e Brendshme |
| MC | Mbrojtja civile |
| MEC | Menaxhimi i Emergjencave Civile |
| MIE | Menaxhimi i Integruar i Emergjencave |
| MIEn | Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë |
| MM | Ministria e Mbrojtjes |
| MSHMS | Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale |
| MVP | Mbështetja e Vendit Pritës (*Host Nation Support – HNS*) |
| NJVKSH | Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor |
| OJF | Organizata Jo-Fitimprurëse |
| OSHEE | Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike |
| OST | Operatori i Sistemit të Transmetimit |
| PQEC | Plani i Qarkut për Emergjencat Civile |
| PH | Paralajmërim i Hershëm |
| PKEC | Plani Kombëtar për Emergjencat Civile |
| PVEC | Plani Vendor për Emergjencat Civile |
| PSV | Procedurë Standarde Veprimi |
| QKOEC | Qendra Kombëtare Operacionale e Emergjencave Civile |
| QOECB | Qendra Operacionale e Emergjencave Civile në Bashki |
| QOECQ | Qendra Operacionale e Emergjencave Civile në Qark |
| RSH | Republika e Shqipërisë |
| SIG/GIS | Sisteme Informative Gjeohapësinore |
| SKZRF | Strategjia Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë |
| SPH | Sistem i Paralajmërimit të Hershëm |
| SVZRF | Strategjia Vendore për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë |
| SHMZSH | Shërbimi i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit |
| SHUM | Shërbimi i Urgjencës Mjekësore |
| VRFNQ | Vlerësimi i Riskut nga Fatkeqësitë në Nivel Qendror |
| VRFNV | Vlerësimi i Riskut nga Fatkeqësitë në Nivel Vendor |
| VKC | Vlerësimi i Kapaciteteve dhe Cenueshmërisë |
| VKM | Vendim i Këshillit të Ministrave |
| ZRF | Zvogëlimi i Riskut nga Fatkeqësitë |

# 1. Kuadri ligjor dhe strategjik për mbrojtjen civile

## 1.1 / Kuadri kombëtar ligjor dhe strategjik për mbrojtjen civile

**Kuadri ligjor për mbrojtjen civile**

Kuadri kryesor ligjor për mbrojtjen civile (MC) në Shqipëri parashikohet nga ligji nr. 45/2019 "Për mbrojtjen civile". Ky ligj përcakton Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile (AKMC) si organin qendror që përgjigjet për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile në të gjithë territorin e vendit, gjithashtu ndër të tjera përcakton rolet dhe përgjegjësitë e institucioneve dhe strukturave të ndryshme në nivel qendror dhe vendor në fushën e zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitë dhe të mbrojtjes civile. Ligji parashikon gjithashtu një klasifikim të emergjencave civile si më poshtë vijon:

- emergjenca civile vendore, që vijnë si pasojë e fatkeqësive që ndodhin në një bashki dhe mund të përballohen me anë të veprimeve të strukturave kompetente të saj;
- emergjenca civile rajonale, që vijnë si pasojë e fatkeqësive që ndodhin në më shumë se një bashki që, për shkak të natyrës, shkallës dhe shtrirjes së tyre, kërkojnë ndërhyrjen e koordinuar të disa bashkive ose qarqeve;
- emergjenca civile kombëtare, që vijnë si pasojë e fatkeqësive që, për shkak të intensitetit, të shkallës dhe të shtrirjes së tyre, kërkojnë ndërhyrje të menjëhershme të të gjitha institucioneve të mbrojtjes civile, qendrore e vendore, edhe me masa të jashtëzakonshme, nëse është e nevojshme.

**Strategjia Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë (SKZRF)**

SKZRF 2023-2030 përshkruan një kuadër strategjik gjithëpërfshirës për menaxhimin e riskut nga fatkeqësitë. Strategjia ofron një qasje shumë-sektoriale, duke u fokusuar tek parandalimi, gatishmëria, përgjigjja dhe rimëkëmbja nga gjashtë risqe kryesore: tërmetet, përmbytjet, rrëshqitjet e dheut, zjarret, aksidentet teknologjike dhe sëmundjet infektive. SKZRF përcakton në detaje rolet institucionale, kuadrin ligjor, vlerësimet e riskut, përfshirjen e komunitetit, shpërndarjen e burimeve dhe bashkëpunimin ndërkombëtar.

**Vlerësimi i Riskut nga Fatkeqësitë në Nivel Qendror (VRFNQ)**

VRFNQ sintetizon një vlerësim të risqeve të shumta me të cilat përballet Shqipëria. Si pjesë e këtij vlerësimi, janë kryer gjashtë vlerësime specifike risku, duke përdorur një metodologji vlerësimi për të renditur nivelet relative të riskut për dymbëdhjetë qarqet për tetë kategori risku (tërmete, përmbytje, rrëshqitje dheu, zjarre masive, aksidente teknologjike, risqe biologjike, çarje digash dhe ortekë). Nga analiza rezulton se çarjet e digave, aksidentet teknologjike, përmbytjet dhe risqet biologjike përfaqësojnë kërcënimet më të mëdha, ndërsa Tirana, Vlora dhe Shkodra janë identifikuar si zonat me rrezikshmërinë më të lartë.

Sipas VRFNQ, Qarku i Fierit përballet me një nivel të lartë risku nga fatkeqësitë. Edhe pse jo ndër qarqet me rrezikshmëri më të lartë, Fieri përballet me risqe të konsiderueshme nga përmbytjet, çarjet e digave dhe risqet teknologjike (kryesisht të lidhura me fushën e naftës Patos-Marinëz). Tërmetet, zjarret masive dhe epidemitë paraqesin risk mesatar. Si kërcënim janë identifikuar gjithashtu risqe si përmbytjet ose tërmetet që mund të shkaktojnë aksidente teknologjike.

**Plani Kombëtar për Emergjencat Civile.**

PKEC u miratua me VKM Nr. 807, datë 28.12.2023 dhe ofron një kuadër gjithëpërfshirës për menaxhimin e emergjencave civile (MEC) dhe fatkeqësive në Shqipëri. Qasja e PKEC bazohet në integrimin e shumë agjencive, duke përcaktuar qartë rolet e institucioneve dhe strukturave qendrore dhe vendore (në nivel qarku dhe bashkie). Elemente kryesore të PKEC përfshijnë:

- Parimet e MEC, duke theksuar kryesisht parashikimin, gatishmërinë, udhëheqjen dhe vazhdimësinë.
- Identifikimin e roleve dhe përgjegjësive të aktorëve të ndryshëm, duke përfshirë AKMC-në dhe ministritë përkatëse në fazat e Parandalimit, Gatishmërisë, Përgjigjes dhe Rimëkëmbjes.
- Detajimin e procedurave të aktivizimit të Përgjigjes ndaj situatave të emergjencave civile (EC), bazuar në llojin e emergjencës dhe shkallën e saj, përfshirë sistemet e nevojshme të komunikimit dhe koordinimin e asistencës ndërkombëtare.
- Përcaktimin e rolit të AKMC-së si mekanizëm institucional që garanton një qasje gjithëpërfshirëse dhe pjesëmarrjen e shumë palëve në të gjitha fazat e MEC. PKEC identifikon AKMC dhe bashkinë si aktorët përgjegjës për trajnimet dhe përmirësimet e vazhdueshme për të fuqizuar kapacitetet gjatë fazës së Gatishmërisë dhe aftësitë reaguese gjatë fazës së Përgjigjes.

## 1.2 / Qarku Fier: Kuadri institucional dhe dokumentet kryesorë për Mbrojtjen Civile

Kuadri institucional dhe strategjik për mbrojtjen civile në Qarkun Fier përfshin institucionet përgjegjëse si Prefekti i Qarkut Fier, Komisioni i Mbrojtjes Civile në nivel Qarku dhe strukturat e planifikimit dhe Mbrojtjes Civile në bashkitë përkatëse. Ky kuadër institucional bazohet në një sërë dokumentesh strategjike, analitikë dhe operacionalë rajonale, duke përfshirë Vlerësimin e Riskut nga Fatkeqësitë në Qarkun Fier (VRFQF), planet për emergjencat civile të bashkive dhe strategjitë vendore për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë.

Në nivel qarku, Prefektit i Qarkut Fier ka rol kyç në koordinimin e përpjekjeve ndërmjet bashkive për shpërndarjen e burimeve, zhvillimin e stërvitjeve ndër-bashkiake dhe organizimin e një reagimi të integruar ndaj emergjencave. Komisioni i Mbrojtjes Civile në nivel qarku i Qarkut Fier funksionon si një organ drejtues për koordinimin e përgjigjes ndaj fatkeqësive, duke bashkërenduar përpjekjet midis autoriteteve vendore dhe institucioneve qendrore.

Dokumentet kyçe për mbrojtjen civile në nivel qarku përfshijnë:

- Vlerësimi i Riskut nga Fatkeqësitë në Qarkun Fier (VRFQ), i cili identifikon risqet më të mëdha dhe masat prioritare për zvogëlimin e tyre.
- Planet për Emergjencat Civile të Bashkive, të cilat përmbajnë protokolle të detajuara për përgatitjen dhe reagimin ndaj fatkeqësive.
- Strategjitë Vendore për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë (SVZRF), që përcaktojnë objektivat, masat dhe politikat për zvogëlimin e ekspozimit dhe cenueshmërisë ndaj fatkeqësive, si dhe për rritjen e aftësisë ripërtëritëse të komuniteteve.

Ndërveprimi ndërmjet bashkive brenda Qarkut Fier është thelbësor për të siguruar një përgjigje të koordinuar dhe efektive ndaj emergjencave civile. Ky bashkëpunim përfshin ndarjen e burimeve, harmonizimin e protokolleve të veprimit dhe mbështetjen e ndërsjellë në raste fatkeqësish.

## 1.3 / Qëllimet dhe objektivat e përgjithshme të PQEC të Qarkut Fier

Qëllimi kryesor i PQEC për Qarkun Fier është të sigurojë një koordinim efektiv të njësive të vetëqeverisjes vendore, të institucioneve, strukturave, organizatave që veprojnë në territorin e qarkut, të rrisë gatishmërinë dhe të sigurojë një përgjigje efektive në raste emergjencash apo fatkeqësish në territorin e qarkut. Në këtë nivel, plani fokusohet në adresimin e nevojave në nivel qarku duke u integruar me sistemin e mbrojtjes civile në nivel qendror. Ky plan synon të garantojë mbrojtjen e jetës së njerëzve, të gjësë së gjallë, të pronës, të trashëgimisë kulturore dhe të mjedisit përmes një qasjeje gjithëpërfshirëse, duke adresuar sfidat e përbashkëta të qarkut si tërmetet, përmbytjet, zjarret në pyje, rrëshqitjet e dheut, aksidentet teknologjike, çarjet e digave, përhapjen e sëmundjeve infektive dhe dëmtimet e infrastrukturës kritike. Ai gjithashtu siguron koordinim të ndihmës humanitare dhe përdorim efikas të burimeve të emergjencës në nivel qarku duke forcuar mekanizmat e parandalimit, përgatitjes dhe rimëkëmbjes.

Objektivat specifike të PQEC për Qarkun Fier përfshijnë:

- Forcimin e bashkëpunimit ndërmjet njësive të vetëqeverisjes vendore, institucioneve, strukturave dhe organizatave të tjera që veprojnë në territorin e qarkut për të garantuar një përgjigje të koordinuar, efektive dhe të shpejtë ndaj emergjencave civile ose fatkeqësive.
- Përcaktimin e qartë të roleve dhe përgjegjësive dhe mekanizmave të qartë koordinues të institucioneve dhe të strukturave në nivel qarku të përfshira në menaxhimin e fatkeqësive.
- Sigurimin e një përgjigje të përshtatur ndaj llojit të risqeve në nivel qarku për të siguruar një përgjigje të shpejtë dhe efikase dhe për të zvogëluar dëmet.
- Zvogëlimi i ndikimit të mundshëm të emergjencave të ardhshme nëpërmjet planifikimit, trajnimit dhe masave parandaluese duke përfshirë forcimin e infrastrukturës dhe zhvillimin e sistemit të paralajmërimit të hershëm.
- Rritjen e kapaciteteve të institucioneve vendore dhe në nivel qarku për të parandaluar, përgatitur dhe reaguar ndaj fatkeqësive.
- Sigurimin e gatishmërisë së strukturave të mbrojtjes civile, përfshirë forcimin e burimeve njerëzore dhe teknologjike për menaxhimin e fatkeqësive.
- Minimizimin e ndikimit të fatkeqësive në komunitetet dhe ekonominë rajonale, përfshirë mbrojtjen e infrastrukturës kritike.
- Ndërgjegjësimin e publikut dhe përfshirjen e komunitetit në përpjekjet për zvogëlimin e riskut dhe përgatitjen ndaj emergjencave.
- Sigurimin e vazhdimësisë së shërbimeve esenciale gjatë dhe pas një emergjence ose fatkeqësie për të zvogëluar ndikimin në jetën e përditshme të banorëve.

- Nxitjen e një qasjeje gjithëpërfshirëse, duke angazhuar autoritetet vendore, institucionet shtetërore, organizatat e shoqërisë civile dhe sektorin privat në përpjekjet për menaxhimin e emergjencave.
- Sigurimi që aktivitetet e përgjigjes të koordinohen dhe të bëshkërendohen midis nivelit qendror dhe atij vendor në mënyrë që të shmangen dyfishimi i përpjekjeve dhe boshllëqeve në përgjigjen ndaj emergjencës.
- Lehtësimin/koordinimin e përpjekjeve për rimëkëmbje duke përfshirë rindërtimin e infrastrukturës, rivendosjen e shërbimeve dhe mbështetjen e komuniteteve të prekura pas një emergjence.

Ky plan është një mjet thelbësor për të garantuar që Qarku Fier të jetë më i përgatitur dhe më i qëndrueshëm ndaj fatkeqësive, duke synuar jo vetëm një përgjigje efektive, por edhe një strategji afatgjatë për zvogëlimin e riskut dhe rritjen e gatishmërisë së komuniteteve të tij.

# 2. Parimet e funksionimit të PQEC

## 2.1 / Parashikueshmëria dhe gatishmëria

Parimet e parashikueshmërisë dhe gatishmërisë janë jetikë si për fazat që i paraprijnë një emergjence civile (*Parandalimi dhe Gatishmëria*) ashtu dhe për fazat që e pasojnë atë. Ato fokusohen në monitorimin aktiv të risqeve të mundshme përmes Menaxhimit të Integruar të Emergjencave (MIE). Planifikimi efikas nxjerr në pah rëndësinë e trajnimeve dhe stërvitjeve pasi rreziqet janë dinamike dhe duhet të vlerësohen dhe menaxhohen vazhdimisht për të mundësuar operacione efikase.

Emergjencat sfidojnë vazhdimësinë e proceseve të punës dhe kërkojnë një ekuilibër midis *Përgjigjes* dhe *Rimëkëmbjes* për të garantuar funksionimin normal të tyre. Ligji nr.45/2019 “Për mbrojtjen civile” thekson bashkëpunimin e institucioneve dhe agjencive për parapërgatitjet për emergjencat, duke garantuar qartësinë e roleve për të gjithë aktorët përgjegjës. Këta aktorë duhet të zhvillojnë plane vazhdimësie për t'u përgatitur në mënyrë efektive për fatkeqësitë e mundshme që mund të ndërpresin aktivitetet e tyre, duke lejuar një përgjigje më të shpejtë dhe më të organizuar.

## 2.2 / Vendimmarrja, lidershipi dhe pronësia

Vendimmarrja është një aftësi jetike në MEC që kërkon trajnim, praktikë dhe një kuptim të thellë të elementeve që karakterizojnë emergjencat. Agjencitë dhe institucionet duhet të sigurohen që menaxherët e emergjencave të kenë mundësi të zhvillojnë aftësitë e tyre vendimmarrëse. Proceset e vendimmarrjes mund të klasifikohen në dy kategori kryesore: *vendimmarrja intuitive*, që mbështetet në njohuritë ekzistuese dhe *vendimmarrja e bazuar në njohuri*, e cila përfshin krahasimin e opsioneve dhe zhvillimin e zgjidhjeve të reja.

Ka disa probleme që mund t'i bëjnë vendimet më pak efikase në një kontekst operacional. Vendimmarrësit duhet të jenë të vetëdijshëm për to dhe duhet të kontrollojnë vendimet e tyre (nëpërmjet diskutimeve me kolegët ose opinioneve të dyta) për të eliminuar pasojat e padëshiruara. Lidershipi efikas nënkupton një kombinim të dy kategorive vendimmarrëse të mësipërme. Për një Lidership sa më efikas në MEC është thelbësore të analizohen nevojat dhe presionet që lindin gjatë një emergjence, sidomos kur informacioni është shpesh i paplotë ose i paqartë.

**Figura 1:** Emergjencat/model mbi vendimmarrjet për fatkeqësitë




*Burimi: Plani Kombëtar për Emergjencave Civile*

Vendosja e qëllimeve dhe objektivave të qarta strategjike i ndihmon agjencitë dhe institucionet të koordinojnë përpjekjet dhe të fokusojnë burimet aty ku nevojitet. Ndërsa veprimet e menjëhershme synojnë të shpëtojnë jetë dhe të zbusin dëmet, fokusi strategjik duhet të përfshijë gjithashtu prioritetet afatgjata të rimëkëmbjes, si rivendosja e shërbimeve parësore dhe mbështetja e komuniteteve të prekura. Objektivat e përbashkëta të Përgjigjes përfshijnë mbrojtjen e jetëve, lehtësimin e pasojave, menaxhimin e emergjencave, ofrimin e informacionit publik dhe lehtësimin e rimëkëmbjes së komunitetit. Këto duhet të përfshijnë dhe mësime të nxjerra për të përmirësuar përgjigjet e ardhshme ndaj emergjencave.

## 2.3 / Informacioni

Informacioni është kritik për *Përgjigjen* dhe *Rimëkëmbjen* ndaj fatkeqësive. Garantimi i rrjedhës së informacionit brenda agjencive, me partnerët dhe publikun e gjerë, është jashtëzakonisht sfidues në kushtet e një emergjence. Rëndësia e informacionit për reaguesit e emergjencës dhe ata të prekur nga ngjarjet nuk mund të nënvlerësohet.

Në nivel qarku, Prefekti i Qarkut Fier dhe Komisioni i Mbrojtjes Civile në nivel Qarku (KMCQ) luajnë një rol kyç në mbledhjen dhe shpërndarjen e informacionit për situatat e emergjencave civile. Përmes një qasjeje të integruar me Strukturat e Planifikimit dhe Mbrojtjes Civile në secilën bashki, KMCQ siguron që informacioni kritik të transmetohet shpejt dhe saktë midis bashkive dhe institucioneve të tjera përgjegjëse.

Menaxhimi i informacionit mbështetet në vetëdijesimin për situatën. Masat për të garantuar rrjedhën e informacionit duhet të parashikojnë përfshirjen e burimeve të shumëfishta dhe vlerësimin e tij. Vlerësimi i informacionit është vendimtar për të përcaktuar qartë rëndësinë, saktësinë, afatin kohor, aksesin, interpretimin dhe transparencën e tij. Në këtë kuadër është jetik transformimi i informacionit të disponueshëm për t'u përdorur sa më lehtë nga strukturat vendore të mbrojtjes civile ose për informacion publik.

Për të shmangur keqkuptimet dhe mbingarkesën e komunikimit mes aktorëve, në nivel qarku janë vendosur protokolle të unifikuara për shkëmbimin e informacionit midis bashkive dhe Prefekturës, duke përfshirë përdorimin e raporteve të standardizuara për situatat e emergjencave civile (Aneksi 1 dhe 2).

Mbledhja, vlerësimi, vërtetimi dhe shpërndarja e informacionit në situata emergjente mund të paraqesin vështirësi. Për shembull, agjenci të ndryshme përdorin metoda dhe procedura të ndryshme në menaxhimin e informacionit ose kanë këndvështrime të ndryshme për ngjarjen apo situatën. Në kushtet e kohës së pamjaftueshme që nxisin tension mes palëve të përfshira, mund të ndodhin gabime dhe keqkuptime, gjë që mund të mbingarkojë më tej komunikimin ndërmjet tyre.

Kur procedurat e informacionit janë të qarta, aktorët vendorë duhet të ndjekin modelet e miratuara në nivel bashkie ose qarku. Përdorimi i modeleve të tilla dhe menaxhimi i informacionit më gjerësisht duhet të përfshihen dhe vlerësohen përmes trajnimeve dhe stërvitjeve.

Për të siguruar që publiku të marrë këshilla dhe paralajmërime në kohë, KMCQ në bashkëpunim me bashkitë ka zhvilluar mekanizma të paralajmërimit të hershëm, duke përfshirë sistemet e alarmit, komunikimet përmes rrjeteve sociale dhe mesazhet SMS për situatat e emergjencave.

Është gjithashtu thelbësore që publiku të marrë këshillat, paralajmërimet dhe informacionin e duhur për të ofruar siguri dhe një bazë për çdo veprim të nevojshëm. Nga pikëpamja ligjore, neni 49 i Ligjit nr. 45/2019 "Për mbrojtjen civile" ka vendosur detyrimin e qeverisjes vendore për të informuar.

## 2.4 / Integrimi dhe bashkëpunimi me grupet e interesit

Numri i madh i institucioneve të përfshira sidomos në fazat e Përgjigjes dhe Rimëkëmbjes nga emergjencat ose fatkeqësitë mund të krijojë vështirësi për menaxhimin efikas të operacioneve. Prandaj efikasiteti mund të arrihet vetëm nëse strukturat bëjnë një planifikim të kujdesshëm paraprak dhe përmes trajnimeve dhe stërvitjeve të vazhdueshme sipas risqeve dhe skenarëve të mundshëm. Emergjencat dhe fatkeqësitë shpesh kanë karakter ndërkufitar, gjë që e bën bashkëpunimin ndërmjet njësive të vetëqeverisjes vendore kyç për suksesin e adresimit të tyre.

Në këtë drejtim, Prefekti i Qarkut Fier dhe Komisioni i Mbrojtjes Civile në nivel Qarku (KMCQ) duhet të sigurojnë bashkëpunim të strukturuar midis bashkive të Fierit, Lushnjës, Divjakës, Roskovecit, Mallakastrës dhe Patosit përmes marrëveshjeve të ndërsjella dhe mekanizmave të koordinimit.

Qarku Fier, për shkak të karakteristikave të tij, duhet të sigurojë bashkëpunim të ngushtë jo vetëm mes bashkive të tij, por edhe me qarqet fqinje, si Berati dhe Vlora, për të adresuar fatkeqësitë që kanë ndikim të gjerë rajonal. KMCQ ka një rol kyç në koordinimin e operacioneve ndër-bashkiake dhe në lidhjen me strukturat kombëtare të emergjencave civile.

Menaxhimi i emergjencave në nivel vendor përfshijnë një numër të madh aktorësh publikë dhe privatë. Menaxhimi i tyre kombinon një numër të madh agjencish, institucionesh dhe organizatash që shpesh nuk janë të lidhura me njëra-tjetrën nga marrëdhëniet hierarkike. Prandaj, proceset e vendimmarrjes duhet të synojnë gjithmonë të jenë gjithëpërfshirëse dhe të arrijnë vendime konsensuale, kurdoherë që është e mundur.

Përveç institucioneve shtetërore, roli i sektorit privat dhe shoqërisë civile në menaxhimin e emergjencave në Qarkun Fier është thelbësor. Bizneset, veçanërisht ato në industrinë e hidrokarbureve dhe bujqësisë, duhet të përfshihen në planet e emergjencës përmes marrëveshjeve të formalizuara të bashkëpunimit dhe koordinimit të kapaciteteve të tyre në rast emergjencash.

Institucionet në nivel qarku duhet të ndjekin një qasje të unifikuar për vendimmarrjen, duke respektuar rolet e KMCQ, prefektit dhe institucioneve kombëtare. Ky proces duhet të jetë gjithëpërfshirës dhe të bazohet në konsensus midis aktorëve kyç. Kjo do të lehtësojë dialogun e hapur që është thelbësor për një qëllim dhe objektiva të përbashkëta për t'u zhvilluar, dakordësuar dhe punuar mbi to.

## 2.5 / Përshtatja e Kuadrit Sendai, OZHQ-ve dhe Ndryshimeve Klimatike në nivel vendor dhe nivel qarku

Plani i Qarkut Fier për Emergjencat Civile, si dhe plani vendor për emergjencat civile në të 6 bashkitë e këtij qarku janë në përputhje me prioritetet dhe objektivat e Kuadrit Sendai për Zvogëlimin e Riskut të Fatkeqësive (2015–2030), Objektivat e Zhvillimit të Qendrueshëm (OZHQ), si dhe Ndryshimet Klimatike.

Gjatë hartimit të Planit të Qarkut për Emergjencat Civile, si dhe planit vendor për emergjencat civile në të 6 bashkitë e këtij qarku, janë marrë në konsideratë vlerësimi i riskut nga fatkeqësitë në nivel qarku, si dhe në nivel vendor për çdo bashki të qarkut, cenueshmëria, si dhe ekspozimi ndaj këtyre risqeve, të cilat kanë lidhje me zbatueshmërinë e Prioritetit 1: Kuptimi i riskut nga fatkeqësitë.

Një vëmendje e veçantë gjatë hartimit të këtyre planeve i është kushtuar përgatitjes, forcimit të strukturave në nivel qarku dhe në nivel vendor për të koordinuar përgjigjen, rimëkëmbjen, parandalimin dhe lehtësimin ndaj fatkeqësive gjë e cila ka lidhje me zbatimin e Prioritetit 2: Forcimi i qeverisjes së riskut nga fatkeqësitë.

Promovimi ose nxitja e investimeve publike dhe private në parandalimin e risqeve nga fatkeqësitë, dhe zvogëlimin e riskut përmes masave strukturore dhe jo strukturore kanë qënë në fokus gjatë hartimit të këtij plani, si dhe planeve vendore për emergjencat civile. Masa të tilla janë efektive për të shpëtuar jetën, për të parandaluar dhe për të zvogëluar humbjet dhe për të siguruar rimëkëmbje efektive dhe rehabilitim të cilat kanë lidhje me Prioritetin 3: Investimi në zvogëlimin e riskut të fatkeqësive për aftësinë ripërtëritëse.

Plani i Qarkut Fier për Emergjencat Civile, si dhe plani vendor për emergjencat civile në të 6 bashkitë e këtij qarku janë fokusuar në masat e gatishmërisë, sistemet e paralajmërimit të hershëm dhe ngritjen e kapaciteteve në nivel qarku dhe bashkie, gjë të cilat kanë lidhje me Prioritetin 4: Përmirësimi i gatishmërisë ndaj fatkeqësisë për përgjigje efektive dhe për "Të rindërtuar më mirë" ("Build Back Better") në rimëkëmbje, rehabilitim dhe rindërtim.

Fokusi i Kuadrit Sendai te rritja e aftësisë ripërtëritëse përputhet me qëllimin për të zvogëluar humbjet e jetës, mjetet e jetesës dhe asetet, të cilat janë qëllimet kryesore të planit të qarkut për emergjencat civile, si dhe të planit vendor për emergjencat civile në të 6 bashkitë e qarkut.

**2. Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ):**

OZHQ-të, veçanërisht Objektivi 13 (Veprimi për Klimën) dhe Objektivi 11 (Qytetet dhe Komunitetet e Qëndrueshme), ofrojnë një udhërrëfyes për zhvillim të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës.

Gjatë hartimit të planeve për emergjencat civile si të atij në qark dhe të atyre në bashki është mbajtur parasysh lidhja e planeve për emergjencat civile me OZHQ-të për të siguruar që menaxhimi i emergjencave të kontribuojnë në qëndrueshmërinë afatgjatë, duke përfshirë masa për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë, për qytetet dhe komunitetet duke adresuar cenueshmërinë urbane dhe duke siguruar që infrastruktura të jetë e qëndrueshme ndaj risqeve gjë e cila ka lidhje me Objektivin 11: Qytetet dhe komunitetet e qëndrueshme.

Gjithashtu, gjatë hartimit të këtyre planeve janë mbajtur parasysh ndryshimet e klimës, si shpeshtësia dhe intensiteti në rritje të ngjarjeve të lidhura me klimën, si përmbytjet dhe rritja e temperaturave. Objektivi 13 (Veprimi për Klimën).

Gjatë hartimit të këtyre planeve ka qenë në fokus për të siguruar që popullatat e cenueshme të mbrohen gjatë dhe pas fatkeqësive dhe proceset e rimëkëmbjes të jenë gjithëpërfshirëse gjë të cilat kanë lidhje me Objektivin 1 (Pa varfëri) dhe Objektivin 3 (Shëndet dhe Mirëqenia e Mirë).

**3. Ndryshimet klimatike:**

Efektet e ndryshimeve klimatike, si rritja e nivelit të detit, rritja e temperaturave dhe ngjarjet më ekstreme të motit, e bëjnë gatishmërinë dhe përgjigjen ndaj fatkeqësive edhe më emergjente.
Plani i Qarkut Fier për Emergjencat Civile, si dhe plani vendor për emergjencat civile në të 6 bashkitë e këtij qarku marrin në konsideratë se si ndryshimi i klimës do të përkeqësojë rreziqet e fatkeqësive.

Për këtë qëllim njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe degët territoriale në nivel qarku duhet të fokusohen në zvogëlimin e cënueshmërisë ndaj ndryshimeve klimatike, nëpërmjet marrjes së masave për përmirësimet e infrastrukturës, planifikimin e përdorimit të tokës dhe menaxhimin e burimeve natyrore.

Disa masa që sugjerojmë të merren në nivel qarku dhe bashkie për t'u përshtatur me Kuadrin Sendai për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë (2015-2030), Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ) dhe ndryshimet klimatike janë:

1. **Vlerësimi i riskut në nivel vendor/qarku:** Kryerja e vlerësimit të riskut në nivel vendor/qarku sipas parashikimeve ligjore jo më pak se një herë në çdo tre vjet, për të identifikuar risqet që lidhen me fatkeqësitë natyrore dhe ndryshimet klimatike.
2. **Angazhimi dhe edukimi i komunitetit:** Përfshirja e komunitetit në planifikimin e zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitë dhe edukimi i tyre rreth praktikave të qëndrueshme dhe përshtatjes klimatike.
3. **Zhvillimi i qëndrueshëm i infrastrukturës:** Promovimi dhe investimi në infrastrukturë me qëllim që t'i rezistojë ndikimeve klimatike.
4. **Përshtatja e bazuar në ekosistem:** Zbatimi i zgjidhjeve të bazuara në natyrë si ripyllëzimi, restaurimi i ligatinave dhe mbrojtja e habitateve natyrore për të rritur aftësinë ripërtëritëse ekologjike ndaj ndikimeve klimatike.
5. **Integrimi i politikave:**Sigurimi që politikat vendore të përputhen me objektivat e Kuadrit Sendai, Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ-të) dhe strategjitë e përshtatjes klimatike.
6. **Ngritja e kapaciteteve:** Zhvillimi i kapaciteteve vendore duke trajnuar personelin, drejtues të komunitetit dhe organizata që veprojnë në territor për menaxhimin e riskut nga fatkeqësitë dhe strategjitë e përshtatjes klimatike.
7. **Sistemet e paralajmërimit të hershëm:** Krijimi dhe mbajtja e  sistemeve të fuqishme të paralajmërimit të hershëm për të paralajmëruar shpejt komunitetet për fatkeqësitë e afërta, duke u mundësuar atyre të marrin masa proaktive për të minimizuar dëmin.
8. **Promovimi i Jetesës së Qëndrueshme:** Mbështetja e iniciativave që përmirësojnë jetesën e banorëve përmes praktikave të qëndrueshme bujqësore, bizneseve miqësore me mjedisin, duke përafruar aktivitetet ekonomike me ruajtjen e mjedisit.
9. **Partneriteti dhe Bashkëpunimi:** Nxitja e partneriteteve me organizatat kombëtare dhe ndërkombëtare, sektorët privatë dhe shoqërinë civile për të siguruar mbështetje dhe burime për zbatimin e masave të përshtatjes në nivel vendor/qarku.
10. **Monitorimi dhe Vlerësimi:** Monitorimi dhe vlerësimi rregullisht i efektivitetit të masave të zbatuara, duke përshtatur politikat, strategjitë sipas nevojës për të siguruar përmirësim të vazhdueshëm dhe përshtatje ndaj sfidave në zhvillim.

# 3. Sistemi i Mbrojtjes Civile në nivel qendror, nivel qarku dhe në nivel vendor

## 3.1 / Institucionet dhe Strukturat Qendrore të Mbrojtjes Civile

Skema mëposhtë paraqet institucionet dhe strukturat qendrore të mbrojtjes civile. Për detaje të mëtejshme referoju Planit Kombëtar për Emergjencat Civile, seksioni 1.4.3.

**Figura 2:** Institucionet dhe strukturat qendrore të mbrojtjes civile




*Burimi: Plani Kombëtar për Emergjencave Civile*

### Ministri i Mbrojtjes (MM)

Sipas fushës së përgjegjësisë shtetërore, MM është përgjegjës për mbrojtjen civile. Detyrat kryesore të Ministrit të Mbrojtjes përfshijnë:

- Përcaktimin e drejtimeve dhe objektivave strategjike të AKMC-së;
- Hartimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të politikave për ZRF dhe MC;
- Informimin periodik të KM për çështjet e ZRF dhe MC;
- Mbikëqyrjen e menaxhimit të buxhetit të AKMC-së, sipas legjislacionit financiar në fuqi.

**Figura 3:** Ministria përgjegjëse për Mbrojtjen Civile dhe ndërveprimi i saj me nivelin qendror, nivelin e qarkut dhe atë vendor




*Burimi: Plani Kombëtar për Emergjencave Civile*

**Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile**

AKMC përgjigjet për ZRF dhe MC në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, duke vepruar sipas Ligjit nr. 45/2019 "Për mbrojtjen civile" dhe VKM nr. 747, datë 20.11.2019. Përgjegjësitë e AKMC ndër të tjera përfshijnë zbatimin e politikave të zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitë dhe të mbrojtjes civile, bashkëpunimin me institucionet qendrore dhe vendore, si dhe përgatitjen e raporteve vjetore për MC dhe ZRF. AKMC koordinon dhe bashkërendon punën për hartimin e SKZRF, VRFNQ dhe PKEC, planifikon financimin për masat parandaluese dhe lidh marrëveshje me organizatat mbi iniciativat dhe aktivitetet për MC. AKMC-ja koordinon në mënyrë të përqendruar shpërndarjen e kapaciteteve logjistike dhe njerëzore, të caktuara për përballimin e emergjencave civile apo të fatkeqësive.

Për detaje të mëtejshme referoju Planit Kombëtar për Emergjencat Civile, seksioni 1.4.3.

## 3.2 / Institucionet dhe strukturat e Mbrojtjes Civile në nivel qarku dhe bashkie/vendor

### 3.2.1 / Institucionet dhe strukturat e mbrojtjes civile në nivel qarku

Bazuar në kuadrin ligjor në fuqi, prefekti i qarkut ka rol parësor në ZRF dhe MC me disa përgjegjësi kritike.
Prefekti:

Disa detyra dhe përgjegjësi të Prefektit të qarkut:

- Refuzimin e buxheteve të bashkive të cilave u mungojnë fonde për masat e ZRF dhe të mbrojtjes civile;
- Kryerjen e vlerësimit të riskut në nivel qarku dhe hartimin, miratimin dhe përditësimin e planit të qarkut për emergjencat civile, të cilin e dërgon në AKMC për qëllim analizimi dhe planifikimi;
- Bashkëpunimin me bashkitë për të vlerësuar risqet nga fatkeqësitë dhe për të informuar publikun;
- Bashkërendimin e aktiviteteve ndërmjet organeve vendore dhe institucioneve dhe strukturave vendore;
- Kërkimin e ndihmës nga AKMC kur burimet brenda qarkut janë të pamjaftueshme;
- Garantimin e funksionimit të SPH, koordinimin e shpërndarjes e ndihmës ndërkombëtare gjatë fatkeqësive dhe dhënien e përparësisë së investimeve për MEC në nivel qarku;
- Krijimin e një baze të dhënash dhe të humbjeve nga fatkeqësitë;
- Menaxhimin e forcave operacionale në rast emergjencash dhe promovimi i bashkëpunimit ndërmjet bashkive dhe qarqeve kufitare;
- Ndarjen e informacionit me AKMC-në, mbikëqyrja e shërbimeve të emergjencës dhe monitorimi i përpjekjeve vendore për ZRF dhe MC;
- Paraqitjen e një kërkese drejtuar AKMC-së për mbështetje për të mbuluar dëmet nëse nevojat për kompensimin e fatkeqësive tejkalojnë 8% të buxhetit të një bashkie.

Pjesë e strukturës së administratës së prefektit janë dhe Sektori i Planifikimit, Përballimit të Emergjencave Civile dhe Krizave, si dhe nëprefekti.

**Nënprefekti:**

Nënprefekti i Lushnjës dhe i Mallakastrës, në funksion të mbrojtjes civile kanë këto përgjegjësi dhe detyra:

- Informon Prefektin e Qarkut Fier për mundësinë e ndodhjes apo ekzistencën e një situate emergjente në territorin e bashkisë ku ushtron detyrën.
- Në bashkëpunim me drejtuesit e forcave operacionale, bashkërendon dhe koordinon përgjigjen dhe kërkon ndihmë për ndërhyrje të strukturave të tjera jashtë territorit të bashkisë, si dhe bashkërendon aktivitetet e forcave që vijnë në ndihmë.
- Raporton periodikisht te Prefekti i qarkut dhe në KMCQ për situatën e emergjencës dhe aktivitetet në përgjigje të saj.
- Mbikëqyr masat e sigurisë dhe të rendit duke informuar Prefektin për veprimet e Policisë së Shtetit dhe të institucioneve vendore në raste emergjente.
- Propozon masa për zvogëlimin e riskut dhe përmirësimin e kapaciteteve të njësive të vetëqeverisjes vendore në menaxhimin e emergjencave.
- Merr pjesë në planifikimin e masave emergjente dhe koordinon me autoritetet vendore për hartimin dhe zbatimin e tyre.
- Përfaqëson Prefektin e Qarkut në veprimtari zyrtare dhe organizime të njësive të vetëqeverisjes vendore që lidhen me mbrojtjen civile dhe përgatitjen për emergjenca.

**Komisioni i mbrojtjes civile në nivel qarku (KMCQ)**

Në çdo qark, nën drejtimin e prefektit të qarkut, krijohet dhe funksionon komisioni i mbrojtjes civile. Përbërja, funksionimi dhe detyrat e komisionit, miratohen me urdhër të prefektit të qarkut.

Disa detyra të Komisionit të Mbrojtjes Civile në nivel qarku (KMCQ):

- Bashkërendimi i të gjitha aktiviteteve të strukturave shtetërore dhe jo shtetërore në qark për menaxhimin e emergjencave civile.
- Koordinimi i veprimeve institucionale të nevojshme në të gjitha etapat e përgjigjes ndaj emergjencës civile.
- Koordinimi i vlerësimit të nevojave materiale dhe financiare, dëmeve të shkaktuara, kostove të rehabilitimit të zonës së prekur nga fatkeqësia duke kërkuar mbështetjen e strukturave të tjera në nivel qarku, sikurse edhe të kapaciteteve qendrore nëpërmjet AKMC-së.
- Bashkërendimi i planeve për emergjencat civile në qark.
- Monitorimi dhe menaxhimi i situatës emergjente nëpërmjet koordinimit të strukturave qendrore të pranishme në këtë nivel, të cilat janë përfshirë në planet për emergjencat civile në nivel qark.
- Kontrolli i marrjes së masave të tjera në nivel qarku, për t'u mbrojtur nga dukuri të mundshme rreziku.

**Këshilli i Qarkut Fier**

Këshilli i Qarkut është i përfshirë në menaxhimin e emergjencave civile, bashkëpunon me administratën e Prefektit, KMCQ-në, si dhe me organet e njësive të vetëqeverisjes vendore.

- Mbështet vlerësimin e dëmeve dhe nevojave, duke bashkëpunuar me Prefektin dhe bashkitë për mbledhjen dhe raportimin e të dhënave.
- Ndihmon në logjistikën emergjente, duke asistuar në strehimin e përkohshëm, dislokimin e mjeteve dhe shpërndarjen e ndihmave humanitare.
- Lehtëson shkëmbimin e informacionit, duke mbështetur koordinimin ndërmjet bashkive dhe institucioneve qendrore.
- Asiston në përgatitjen dhe harmonizimin e planeve të emergjencave, duke siguruar përputhjen me strategjitë kombëtare dhe pjesëmarrjen në stërvitje.
- Mbështet projektet për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë, duke ndihmuar në sigurimin e fondeve dhe përmirësimin e infrastrukturës mbrojtëse.

**Figura 4:** Strukturat e mbrojtjes civile në nivel qarku dhe QOECQ




*Burimi: Plani Kombëtar për Emergjencave Civile*

**Sektori i Planifikimit, Përballimit të Emergjencave Civile dhe Krizave /Administrata e Prefektit**

Në përbërje të strukturës së administratës së prefektit funksionon **Sektori i Planifikimit, Përballimit të Emergjencave Civile** dhe Krizave referuar Urdhërit të Kryeministrit nr. 106, datë 9.07.2024 “Për një ndryshim në urdhrin nr.4, datë 12.1.2016, të Kryeministrit, "Për miratimin e strukturës dhe të organikes së administratës së prefektit të qarkut të Fierit”.

**Disa detyra të Sektorit të Planifikimit, Përballimit të Emergjencave Civile dhe Krizave**

- Harton dhe përditëson Planin e Qarkut për emergjencat civile, duke pasur parasysh risqet e fatkeqësive në qark dhe e dërgon në Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile për qëllim analizimi dhe planifikimi.
- Grumbullon dhe përpunon të dhënat e nevojshme nga bashkitë dhe strukturat e tjera që veprojnë në nivel qarku, për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, si dhe informon në mënyrë të vazhdueshme Prefektin e qarkut dhe Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile.
- Siguron funksionimin e sistemit të monitorimit, paralajmërimit të hershëm, njoftimit dhe alarmit në territorin e qarkut.
- Koordinon forcat operacionale në nivel qarku në rastet e fatkeqësive.
- Koordinon veprimtarinë e organeve, institucioneve dhe strukturave që veprojnë në nivel qarku, me qëllim zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile.
- Bashkëpunon me sektorët përkatës të qarqeve fqinje, në zbatim të detyrave që lidhen me zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, me qëllim bashkimin e kapaciteteve të tyre për trajtimin e çështjeve të përbashkëta në këtë fushë.
- Kontrollon zbatimin e masave të marra nga bashkitë e qarkut për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile.

**Drejtuesi i operacionit në nivel qarku**

Drejtuesi i operacionit në nivel qarku (DOQ), caktohet me urdhër të prefektit të qarkut dhe është pozicion operacional që ngrihet dhe funksionon në situatat e emergjencave civile. DOQ-ja si përgjegjës për menaxhimin e situatës së emergjencave civile në qark është përgjegjës për koordinimin e burimeve njerëzore dhe materiale të listuara në planet për emergjencat civile të qarkut dhe kryen këto detyra:

- Bashkërendon strukturat qendrore në nivel qarku, si dhe strukturat e tjera qendrore ose ndërkombëtare që vijnë në ndihmë.
- Mban lidhje të rregullta dhe kontakte të vazhdueshme me drejtuesit e tjerë të operacioneve në nivel vendor dhe të qarqeve fqinje, informon dhe kërkon asistencë nga KMCQ-ja dhe DQO- ja.
- Menaxhon situatën nëpërmjet drejtimit të strukturave operacionale të angazhuara në nivel qarku, në zbatim të planeve për emergjencat civile të hartuara më parë për përballimin e emergjencave civile në nivel qarku.

- Vepron sipas udhëzimeve që merr nga KMCQ-ja dhe raporton përpara këtij Komisioni, rast pas rasti ose sa herë që e gjykon të nevojshme ky komision.
- Vendos lidhje të drejtpërdrejta me DQO-në, me drejtorin e përgjithshëm të AKMC-së dhe dërgon raporte periodike e përmbledhëse për situatën.
- Bashkëpunon me drejtuesit operacionalë dhe me strukturat e operacionale në bashki.
- Bashkëpunon me grupe vullnetare të emergjencave civile, me organizma e institucione të huaja, të specializuara në përballimin e emergjencave civile, dhe që janë dislokuar dhe ofrojnë ndihmë në territorin e qarkut, OJF-të, si edhe me subjektet private.

**Qendra Operacionale e Emergjencave Civile në Qark (QOECQ)**

QOECQ është nën autoritetin e prefektit. Ajo aktivizohet menjëherë në të gjitha rastet e fatkeqësive kur shpallet gjendja e fatkeqësisë natyrore në një territor që përfshin qarkun. Në rastet e tjera vendimi i aktivizimit merret nga prefekti në bashkërendim me AKMC-në pas konsultimeve me KMCQ-në i cili bën një vlerësim të situatës së pritshme ose aktuale dhe paraqet një raport bazuar në risqet aktuale ose të pritshme. Prefekti cakton një koordinator për të gjitha aktivitetet e qendrës dhe personel me përgjegjësi të përditshme për menaxhimin e kësaj qendre.

Aktivizimi i QOECQ ndodh kur:

- Shpallet gjendja e fatkeqësisë natyrore në një nga bashkitë në juridiksionin e qarkut.
- Rrezikohet një numër i konsiderueshëm jetësh njerëzore.
- Ekziston një shkallë e lartë e nivelit të kërcënimit për njerëzit, gjënë e gjallë, pronën, trashëgiminë kulturore ose mjedisin.
- Kërkohet mbështetje në vend (aktivizimi afatgjatë, burime të kufizuara, etj.).
- Nevojitet një koordinim i burimeve të qarkut, si rezultat i burimeve të kufizuara lokale dhe/ose përmasave të mëdha dhe shtrirjes gjeografike të emergjencës.
- Ekzistojnë shqetësime të larta nga media apo publiku/grupet e interesit.

Për të realizuar detyrat e tij, DOQ do të mbështetet nga Qendra Operacionale e Emergjencave Civile në Qark (QOECQ), e cila duhet të përbëhet nga tre sektorë kryesorë:

- Sektori i Planifikimit
- Sektori Operacional
- Sektori i Logjistikës.

Në varësi të natyrës dhe shkallës së emergjencës, si dhe burimeve të aktivizuara, numri i anëtarëve dhe rolet e tyre përshtaten sipas nevojave të situatës. Në çdo rast, Prefekti i qarkut cakton edhe **Drejtues Operacioni Zëvendësues**, të cilit Drejtuesi i Operacionit i delegon përkohësisht detyrën në rastet kur operacioni zgjat mbi 12 orë.

**Roli dhe funksioni i QOEC-së, në raste emergjencash në nivel qarku**

QOECQ-ja është një strukturë bashkërendimi dhe komunikimi midis drejtuesve kryesorë dhe organizatave të përfshira në përgjigjen ndaj emergjencës, e cila lehtëson shkëmbimin e informacionit midis tyre. Ajo shërben edhe si një sekretari teknike që ndihmon punën për funksionimin e KMC-së dhe Drejtuesit të Operacioneve në qark, në varësi të përmasave të emergjencave.

**Funksionet e QOEC-së në qark.**

**Funksionet kryesore të QOECQ-së janë:**

- Bashkërendimi i punës së institucioneve, strukturave, të agjencive dhe të organizatave të ndryshme.
- Bashkërendimi i centralizuar i operacioneve emergjente, në mbështetje të KMC-së në qark dhe DOQ-së.
- Mbledhja dhe ndarja e informacionit dhe raportimi zyrtar.
- Dhënia e informacionit publikut dhe medias.

**Përgjegjësitë e QOEC-së në qark:**

- Ushtron me efikasitet autoritetin, kur paraqitet nevoja.
- Lehtëson komunikimin në kohë dhe ndarjen e informacionit midis strukturave vendore në territorin e bashkisë.
- Mobilizon me efikasitet personelin dhe burimet.
- Komunikon në kohë me publikun.
- Ofron zgjidhje të shpejtë të mosmarrëveshjeve midis aktorëve të ndryshëm që marrin pjesë në përballimin e emergjencës në lidhje me qëllimet, taktikat dhe burimet.
- Lehtëson ndërveprimin efektiv ndërmjet autoriteteve të qeverisë qendrore, Prefektit të qarkut, bashkive dhe aktorëve të tjerë.

**Sektorët e QOECQ dhe përgjegjësite e tyre:**

• **Sektori i Planifikimit**

o Planifikimi dhe Vlerësimi: Harton, përditëson dhe analizon planet e emergjencave dhe vlerësimin e dëmeve.

o Informimi Publik: Koordinon komunikimin me publikun dhe median, duke siguruar informacion të saktë dhe të verifikuar.

o Dokumentimi dhe Raportimi: Mban të dhëna për operacionet dhe përgatit raportime për ecurinë e emergjencës.

- **Sektori Operacional**

  o Koordinimi dhe Zbatimi: Ekzekuton urdhrat e DOQ dhe koordinon operacionet në terren.

  o Menaxhimi i Burimeve Njerëzore: Koordinon personelin operacional dhe mbështetës për reagimin ndaj emergjencave.

  o Ndërlidhja/Komunikimi: Siguron funksionimin dhe gatishmërinë e rrjeteve të komunikimit ndërmjet ekipeve operacionale.

- **Sektori i Logjistikës**

  o Menaxhimi i Burimeve: Siguron dhe shpërndan pajisje, furnizime dhe ndihma emergjente.

  o Siguria dhe Mbrojtja: Siguron mbrojtjen e personelit dhe infrastrukturës kritike të emergjencës.

  o Infrastruktura dhe Transporti: Koordinon mbështetjen për energjinë, ujin, transportin dhe mirëmbajtjen e objekteve të emergjencës.

**Strukturat e decentralizuara të institucioneve dhe të strukturave qendrore të mbrojtjes civile në territorin e qarkut**

Në Qarkun Fier, strukturat e decentralizuara të institucioneve dhe strukturave qendrore të Mbrojtjes Civile (MC) luajnë një rol kyç në zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë (ZRF) dhe menaxhimin e emergjencave civile (MC). Këto struktura janë të integruara si pjesë përbërëse e Komisionit të Mbrojtjes Civile në nivel Qarku (KMCQ) dhe, sipas rastit, edhe të Komisioneve të Mbrojtjes Civile në nivel Bashkie (KMCB), të krijuara përkatësisht nga Prefekti i Qarkut dhe Kryetarët e Bashkive.

Për të realizuar funksionet dhe përgjegjësitë në fushën e mbrojtjes civile, marrëdhëniet e Prefektit të qarkut me këto struktura janë të parashikuara në ligjin për Prefektin e Qarkut, si dhe në akte të tjera ligjore në fuqi.

Roli i strukturave të decentralizuara përfshin:

- Koordinimin e veprimeve të institucioneve qendrore me ato vendore për menaxhimin e fatkeqësive;
- Mbështetjen e operacioneve të emergjencave përmes ekspertizës teknike dhe burimeve;
- Përmirësimin e kapaciteteve vendore përmes trajnimeve dhe asistencës teknike;
- Zbatimin e politikave dhe strategjive kombëtare të mbrojtjes civile në nivel qarku.

Në raste emergjencash rajonale dhe kombëtare, Prefekti i Qarkut Fier dhe KMCQ sigurojnë koordinimin e integruar të institucioneve dhe strukturave qendrore, duke garantuar një përgjigje të shpejtë dhe të efektshme në të gjitha bashkitë e qarkut.

### 3.2.2 / Strukturat dhe institucionet e Mbrojtjes Civile në nivel vendor/bashkie

Bashkitë e Qarkut Fier kanë një rol kyç në zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë (ZRF) dhe mbrojtjen civile (MC), duke qenë përgjegjëse për:

Vlerësimin dhe dokumentimin e risqeve, informimin dhe paralajmërimin e komunitetit, hartimin dhe zbatimin e strategjive dhe planeve vendore për emergjencat civile, planifikimin dhe përgatitjen për emergjenca, kryerjen e investimeve parandaluese dhe mbrojtëse si edhe koordinimin operacional për menaxhimin e emergjencave. Ato gjithashtu raportojnë periodikisht për kapacitetet dhe situatat emergjente, si edhe bashkëpunojnë për mirëmbajtjen e infrastrukturës kritike dhe koordinimin ndërmjet bashkive për menaxhimin e fatkeqësive.

Në nivel qarku, Prefekti i Qarkut Fier, si përfaqësues i Këshillit të Ministrave, nëpërmjet Komisionit të Mbrojtjes Civile në nivel Qarku (KMCQ), koordinon, mbikëqyr dhe siguron zbatimin e politikave dhe strategjive të mbrojtjes civile në nivel vendor, duke bashkërenduar veprimtarinë ndërmjet institucioneve qendrore, bashkive dhe strukturave të decentralizuara.

**Figura 5:** Strukturat e mbrojtjes civile në nivel vendor dhe QOECB




*Burimi: Plani Kombëtar për Emergjencave Civile*

**Komisioni i Mbrojtjes Civile në Nivel Bashkie (KMCB)**

Në secilën bashki të Qarkut Fier, Komisioni i Mbrojtjes Civile në Nivel Bashkie (KMCB) është struktura përgjegjëse për planifikimin, koordinimin dhe mbikëqyrjen e masave për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë (ZRF) dhe mbrojtjen civile (MC). Ky komision drejtohet nga kryetari i bashkisë dhe përfshin përfaqësues nga institucionet vendore, autoritetet ushtarake, strukturat policore, shërbimet arsimore dhe shëndetësore, organizatat joqeveritare dhe aktorë të tjerë të përfshirë në menaxhimin e emergjencave.

Përgjegjësitë kryesore të KMCB në bashkitë e Qarkut Fier përfshijnë:

- Bashkërendimin e aktiviteteve të strukturave shtetërore dhe joshtetërore në nivel bashkie për menaxhimin efektiv të emergjencave;
- Hartimin dhe zbatimin e masave për parandalimin, lehtësimin, përgatitjen, mbrojtjen dhe përgjigjen ndaj emergjencave civile;
- Koordinimin ndër-institucional midis strukturave shtetërore dhe joshtetërore;
- Bashkëpunimin me KMCQ dhe komisionet e mbrojtjes civile të bashkive fqinje;
- Përgatitjen dhe rishikimin e PVEC dhe dokumenteve të tjera strategjike për ZRF;
- Mbikëqyrjen e logjistikës dhe garantimin e shërbimeve bazë për komunitetin në raste emergjencash;
- Ndërgjegjësimin dhe përgatitjen e komunitetit për përgjigjen ndaj fatkeqësive.

Në nivel qarku, Prefekti i Qarkut Fier dhe Komisioni i Mbrojtjes Civile në nivel Qarku (KMCQ) sigurojnë mbështetjen, koordinimin dhe mbikëqyrjen e strukturave bashkiake të planifikimit dhe mbrojtjes civile, duke garantuar një koordinim efektiv ndërmjet bashkive dhe institucioneve e strukturave në nivel qarku e kombëtare për një përgjigje të integruar ndaj emergjencave civile dhe fatkeqësive.

**Drejtuesi i Operacionit në nivel Bashkie (DOB)**

Në secilën bashki të Qarkut Fier, Drejtuesi i Operacionit në Nivel Bashkie (DOB) është një pozicion operacional i përkohshëm i emëruar nga Kryetari i Bashkisë për menaxhimin dhe koordinimin e operacioneve të emergjencave civile. Ai siguron drejtimin dhe koordinimin e përgjithshëm të burimeve njerëzore dhe materiale të listuara në Planin Vendor për Emergjencat Civile (PVEC) dhe bashkërendon veprimet me institucionet dhe strukturat në nivel qarku dhe kombëtare të mbrojtjes civile.

Përgjegjësitë kryesore të DOB përfshijnë:

- Koordinimin e strukturave bashkiake dhe ndërveprimin me autoritetet në nivel qarku, qendrore dhe ndërkombëtare në rast emergjencash;
- Mbajtjen e komunikimit të rregullt me drejtuesit e tjerë të operacioneve në nivel vendor dhe të bashkive fqinje, DOQ dhe KMCQ për të siguruar ndihmën e ndërsjellë;
- Zbaton udhëzimet e Kryetarit të Bashkisë, mban lidhje të vazhdueshme, raporton dhe ndjek udhëzimet e KMCB;

- Zbatimin e planeve vendorë për emergjencat civile dhe, sipas situatave të krijuara, planeve të qarkut për emergjencat civile;
- Angazhimin e grupeve të specializuara të emergjencave dhe të komunitetit në operacionet e përgjigjes;
- Delegimin e autoritetit sipas nevojës dhe sigurimin e një ekipi mbështetës në raste emergjente;
- Në rast se situata përkeqësohet dhe nëse me mundësitë dhe mjetet që zotëron, bashkia nuk mund ta përballojë situatën e krijuar, i propozon kryetarit të bashkisë të kërkojë mbështetje nga bashkitë fqinje dhe nga autoritetet më të larta shtetërore.

Në raste emergjencash të rajonale dhe kombëtare, Prefekti i Qarkut Fier dhe Komisioni i Mbrojtjes Civile në nivel Qarku (KMCQ) marrin drejtimin e operacioneve në nivel qarku, duke siguruar një përgjigje të harmonizuar ndërmjet bashkive dhe institucioneve shtetërore. DOB-të e bashkive bashkëpunojnë me DOQ dhe KMCQ, institucionet dhe strukturat në nivel qarku për të garantuar menaxhimin efektiv të operacioneve dhe për të koordinuar burimet e emergjencës sipas prioriteteve të situatës.

**Qendra Operacionale e Emergjencave Civile në bashki (QOECB)**

QOECB është strukturë e përkohshme nën autoritetin e bashkisë, dhe është aktive dhe operacionale në të gjitha rastet e shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore. Ajo mund të aktivizohet gjithashtu në situata të tjera emergjente, në varësi të ashpërsisë së fatkeqësisë së pritshme ose të ndodhur dhe kapaciteteve të disponueshme për përballimin e saj.

Aktivizimi i QOECB

- Automatikisht në rastin e shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore territorin e bashkisë.
- Me urdhër të Kryetarit të Bashkisë në koordinim me Prefektin e Qarkut dhe me AKMC dhe pas konsultimit paraprak me KMCB.
- Raportimi: Kryetari i Bashkisë, nëpërmjet strukturës së përhershme të Planifikimit dhe Mbrojtjes Civile në bashki, paraqet në KMCB një raport të argumentuar, bazuar në ashpërsinë e fatkeqësisë së pritshme/të ndodhur dhe kapacitetet përballuese në dispozicion.

Për të realizuar detyrat e tij, DOB do të mbështetet nga Qendra Operacionale e Emergjencave Civile në Bashki (QOECB), e cila duhet të përbëhet nga tre sektorë kryesorë:

- Sektori i Planifikimit
- Sektori Operacional
- Sektori i Logjistikës.

Në varësi të natyrës dhe shkallës së emergjencës, si dhe burimeve të aktivizuara, numri i anëtarëve dhe rolet e tyre përshtaten sipas nevojave të situatës.

Në çdo rast, Kryetari i Bashkisë cakton edhe **Drejtues Operacioni Zëvendësues**, të cilit Drejtuesi i Operacionit i delegon përkohësisht detyrën në rastet kur operacioni zgjat mbi 12 orë.

**Përgjegjësitë e QOEC-së në bashki:**

- Ushtron me efikasitet autoritetin, kur paraqitet nevoja.
- Lehtëson komunikimin në kohë dhe ndarjen e informacionit midis strukturave vendore në territorin e bashkisë.
- Mobilizon me efikasitet personelin dhe burimet.
- Komunikon në kohë me publikun.
- Ofron zgjidhje të shpejtë të mosmarrëveshjeve midis aktorëve të ndryshëm që marrin pjesë në përballimin e emergjencës në lidhje me qëllimet, taktikat dhe burimet.
- Lehtëson ndërveprimin efektiv ndërmjet autoriteteve të qeverisë qendrore, Prefektit të qarkut, bashkive dhe aktorëve të tjerë.

**Funksionet kryesore të QOECB:**

- Mbështet Drejtuesin e Operacioneve në koordinimin e operacioneve emergjente.
- Siguron një qendër komunikimi dhe shkëmbimi informacioni midis aktorëve të përfshirë.
- Ofron asistencë teknike dhe administrative për funksionimin e KMCB dhe DOB.

**Sektorët e QOECB dhe përgjegjësitë e tyre:**

- **Sektori i Planifikimit**

  o **Planifikimi dhe Vlerësimi:** Harton, përditëson dhe analizon planet e emergjencave dhe vlerësimin e dëmeve.

  o **Informimi Publik:** Koordinon komunikimin me publikun dhe median, duke siguruar informacion të saktë dhe të verifikuar.

  o **Dokumentimi dhe Raportimi:** Mban të dhëna për operacionet dhe përgatit raportime për ecurinë e emergjencës.

- **Sektori Operacional**

  o **Koordinimi dhe Zbatimi:** Ekzekuton urdhrat e DOB dhe koordinon operacionet në terren.

  o **Menaxhimi i Burimeve Njerëzore:** Koordinon personelin operacional dhe mbështetës për reagimin ndaj emergjencave.

  o **Ndërlidhja/Komunikimi:** Siguron funksionimin dhe gatishmërinë e rrjeteve të komunikimit ndërmjet ekipeve operacionale.

- **Sektori i Logjistikës**

  o **Menaxhimi i Burimeve:** Siguron dhe shpërndan pajisje, furnizime dhe ndihma emergjente.

  o **Siguria dhe Mbrojtja:** Siguron mbrojtjen e personelit dhe infrastrukturës kritike të emergjencës.

  o **Infrastruktura dhe Transporti:** Koordinon mbështetjen për energjinë, ujin, transportin dhe mirëmbajtjen e objekteve të emergjencës.

- Zbatimin e planeve vendorë për emergjencat civile dhe, sipas situatave të krijuara, planeve të qarkut për emergjencat civile;
- Angazhimin e grupeve të specializuara të emergjencave dhe të komunitetit në operacionet e përgjigjes;
- Delegimin e autoritetit sipas nevojës dhe sigurimin e një ekipi mbështetës në raste emergjente;
- Në rast se situata përkeqësohet dhe nëse me mundësitë dhe mjetet që zotëron, bashkia nuk mund ta përballojë situatën e krijuar, i propozon kryetarit të bashkisë të kërkojë mbështetje nga bashkitë fqinje dhe nga autoritetet më të larta shtetërore.

Në raste emergjencash të rajonale dhe kombëtare, Prefekti i Qarkut Fier dhe Komisioni i Mbrojtjes Civile në nivel Qarku (KMCQ) marrin drejtimin e operacioneve në nivel qarku, duke siguruar një përgjigje të harmonizuar ndërmjet bashkive dhe institucioneve shtetërore. DOB-të e bashkive bashkëpunojnë me DOQ dhe KMCQ, institucionet dhe strukturat në nivel qarku për të garantuar menaxhimin efektiv të operacioneve dhe për të koordinuar burimet e emergjencës sipas prioriteteve të situatës.

**Qendra Operacionale e Emergjencave Civile në bashki (QOECB)**

QOECB është strukturë e përkohshme nën autoritetin e bashkisë, dhe është aktive dhe operacionale në të gjitha rastet e shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore. Ajo mund të aktivizohet gjithashtu në situata të tjera emergjente, në varësi të ashpërsisë së fatkeqësisë së pritshme ose të ndodhur dhe kapaciteteve të disponueshme për përballimin e saj.

Aktivizimi i QOECB

- Automatikisht në rastin e shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore territorin e bashkisë.
- Me urdhër të Kryetarit të Bashkisë në koordinim me Prefektin e Qarkut dhe me AKMC dhe pas konsultimit paraprak me KMCB.
- Raportimi: Kryetari i Bashkisë, nëpërmjet strukturës së përhershme të Planifikimit dhe Mbrojtjes Civile në bashki, paraqet në KMCB një raport të argumentuar, bazuar në ashpërsinë e fatkeqësisë së pritshme/të ndodhur dhe kapacitetet përballuese në dispozicion.

Për të realizuar detyrat e tij, DOB do të mbështetet nga Qendra Operacionale e Emergjencave Civile në Bashki (QOECB), e cila duhet të përbëhet nga tre sektorë kryesorë:

- Sektori i Planifikimit
- Sektori Operacional
- Sektori i Logjistikës.

Në varësi të natyrës dhe shkallës së emergjencës, si dhe burimeve të aktivizuara, numri i anëtarëve dhe rolet e tyre përshtaten sipas nevojave të situatës.

Në çdo rast, Kryetari i Bashkisë cakton edhe **Drejtues Operacioni Zëvendësues**, të cilit Drejtuesi i Operacionit i delegon përkohësisht detyrën në rastet kur operacioni zgjat mbi 12 orë.

**Struktura operacionale të mbrojtjes civile në territorin e qarkut**

**Strukturat e Policisë së Shtetit (PSH)**

Policia e Shtetit (PSH) në Qarkun Fier luan një rol kyç në operacionet e kërkim-shpëtimit dhe ruajtjen e rendit publik gjatë emergjencave civile. Në përputhje me planet operacionale të miratuara dhe në bashkëpunim me institucionet e tjera të mbrojtjes civile, PSH siguron koordinimin e forcave policore në të gjitha bashkitë e qarkut. Strukturat e Policisë së Shtetit në qarkun Fier përbëhen nga Drejtoria Vendore e Policisë Fier, Komisariati i Policisë Fier, Lushnjë, Mallakastër dhe Divjakë, Stacioni i Policisë Roskovec, dhe Patos.

Përgjegjësitë kryesore të PSH përfshijnë:

- Sigurimin e perimetrit dhe mbrojtjen e zonave të prekura nga emergjenca;
- Ruajtjen e rendit dhe qetësisë publike në situata të fatkeqësive;
- Mbështetjen e operacioneve të evakuimit dhe ndihmën në transportin e të lënduarve;
- Identifikimin dhe informimin e personave të prekur nga emergjenca;
- Koordinimin me KMCQ dhe autoritetet vendore për një përgjigje të harmonizuar.

Në raste fatkeqësish, PSH në nivel qarku vepron sipas urdhrave të autoriteteve përkatëse dhe në bashkëpunim me Prefekin e Qarkut Fier dhe Komisionin e Mbrojtjes Civile në nivel Qarku (KMCQ) për të garantuar një ndërhyrje të shpejtë dhe të efektshme në të gjithë territorin e qarkut.

**Shërbimi i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit (SHMZSH)**

Shërbimi i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit (SHMZSH) në Qarkun Fier është një strukturë e specializuar e gatishmërisë së përhershme që operon në të gjitha bashkitë për të garantuar parandalimin dhe ndërhyrjen në raste emergjencash. Ky shërbim është përgjegjës për inspektimin dhe zbatimin e masave të mbrojtjes nga zjarri, si dhe për ndërhyrjet emergjente në zjarre, aksidente, fatkeqësi natyrore dhe ngjarje të shkaktuara nga njeriu.

Përgjegjësitë kryesore të SHMZSH përfshijnë:

- Parandalimin dhe kontrollin e masave të mbrojtjes nga zjarri në mjedise publike dhe private;
- Ndërhyrjen emergjente për shuarjen e zjarreve dhe shpëtimin e njerëzve dhe pasurisë;
- Sigurimin e mbrojtjes së pyjeve, kullotave dhe zonave të ndjeshme nga zjarret;
- Koordinimin me KMCB, KMCQ dhe strukturat bashkiake për një reagim të shpejtë dhe të harmonizuar.

Në raste emergjencash civile rajonale (pa shpallje të gjendjes së fatkeqësisë natyrore), Shërbimi i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit (SHMZSH) vepron nën koordinimin e Prefekturës së Qarkut Fier dhe Komisionit të Mbrojtjes Civile në nivel Qarku (KMCQ), duke siguruar një mobilizim efektiv të burimeve dhe një përgjigje të koordinuar në të gjitha bashkitë e qarkut.

Në operacionet e shpëtimit dhe ndërhyrjeve për fatkeqësi, personeli i shërbimit zjarrfikës vepron nën komandën e drejtpërdrejtë të drejtuesve të tyre përkatës, në përputhje me procedurat operacionale dhe strukturën e zinxhirit të komandës.

**Shërbimet e Urgjencës Mjekësore (SHUM) dhe strukturat e tjera të kujdesit shëndetësor**

Shërbimet e Urgjencës Mjekësore (SHUM), si qendrat shëndetësore bazë, qendrat socio-shëndetësore, qendrat shëndetësore 24/7, ambulanca të tipit A dhe B, janë pjesë thelbësore e forcave operacionale për emergjencat civile. Veprimtaria e tyre rregullohet nga legjislacioni në fuqi për sistemin shëndetësor në Shqipëri, duke siguruar ndihmën e parë në zonat e prekura nga fatkeqësitë dhe transportimin e të plagosurve në qendrat spitalore.

Përgjegjësitë kryesore të SHUM përfshijnë:

- Sigurimin e shërbimit të emergjencës mjekësore për të prekurit nga fatkeqësitë;
- Transportimin e të lënduarve drejt spitaleve rajonale dhe qendrore;
- Koordinimin me strukturat e mbrojtjes civile për përgjigjen ndaj emergjencave;
- Mobilizimin e stafit dhe pajisjeve mjekësore për ndërhyrje të shpejta.

Në raste emergjencash rajonale, SHUM në nivel qarku vepron nën koordinimin e Prefektit të Qarkut Fier dhe KMCQ për të garantuar një përgjigje të integruar shëndetësore në të gjithë territorin e tij.

**Shërbimi Vullnetar i Mbrojtjes Civile**

Ligji nr. 152/2015 "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin" lidhur me vullnetarizmin përkatësisht neni 22 parashikon: "Shërbimi vullnetar i mbrojtjes nga zjarri" është organizimi i strukturës vullnetare për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin, nga organet e njësitë e qeverisjes vendore, nga personat juridikë, që kryejnë veprimtaritë e tyre në Republikën e Shqipërisë, nga institucione dhe agjenci shtetërore, të cilat kanë përgjegjësi për administrimin e pasurive shtetërore me rrezikshmëri nga zjarri".

Drejtoria e Përgjithshme e MZSH-së ka disa detyra të rëndësishme, përfshirë organizimin e kualifikimit dhe trajnimit të personelit të shërbimit të MZSH-së në nivel bashkie, personelit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin e objekteve me rëndësi ekonomike dhe strategjike, si dhe shërbimit vullnetar. Ajo kryen gjithashtu kontrollin dhe mbikëqyrjen e këtyre shërbimeve dhe drejton rritjen e aftësive profesionale të personelit. Përveç kësaj, Ligji nr. 152/2015 parashikon krijimin e shërbimit vullnetar në bashki dhe përcakton miratimin e strukturës, uniformës dhe shenjave dalluese nga këshilli bashkiak.

Në Qarkun Fier, qytetarët mund të kontribuojnë vullnetarisht në menaxhimin e fatkeqësive dhe zvogëlimin e pasojave të tyre përmes Shërbimit Vullnetar të Mbrojtjes Civile në nivel bashkie. Vullnetarët mund të angazhohen individualisht ose në grupe të organizuara (si organizata jofitimprurëse), dhe detyrat e tyre përcaktohen nga strukturat vendore dhe kombëtare të mbrojtjes civile në varësi të nevojave të situatës.

Përgjegjësitë kryesore të Shërbimit Vullnetar të Mbrojtjes Civile përfshijnë:

- Mbështetjen e operacioneve të parandalimit, gatishmërisë dhe përgjigjes ndaj fatkeqësive;
- Angazhimin në fushata ndërgjegjësimi dhe edukimi për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë;
- Pjesëmarrjen në aktivitete të organizuara nga bashkitë dhe KMCQ për mbrojtjen civile;
- Ndihmën për komunitetin dhe institucionet në rast të fatkeqësive.

Për angazhimin e vullnetarëve në aktivitete të mbrojtjes civile dhe operacionet e emergjencave, si dhe për sigurimin e jetës dhe shëndetit të tyre, zbatohen përcaktimet e VKM nr. 667, datë 10.11.2021 "Për trajtimin e vullnetarëve për angazhimin e tyre në aktivitete të mbrojtjes civile apo në operacionet e parandalimit e të përballimit të fatkeqësive". Në raste emergjencash rajonale, Prefekti i Qarkut Fier dhe KMCQ koordinojnë veprimtarinë e Shërbimit Vullnetar të Mbrojtjes Civile në të gjithë territorin e qarkut.

Nga takimet e ekipit të projektit në qarkun e Fierit, rezulton se ekziston angazhimi i vullnetarëve në rastet e operacioneve të parandalimit dhe të përballimit të fatkeqësive, por ky angazhim nuk është i strukturuar apo rregulluar sipas kërkesave të ligjit, për këtë arsye vlerësojmë që struktura dhe mënyra e rregullimit të grupeve vullnetare është e paplotë dhe ka nevojë për rishikim.

# 4. Parandalimi/Lehtësimi

Parandalimi/Lehtësimi është një nga katër fazat e ciklit të menaxhimit të emergjencave miratuar në nivel kombëtar nga AKMC. Koncepti i "parandalimit" i referohet një sërë aktivitetesh që mund të ndërmarrë institucioni i Prefektit të Qarkut Fier për të shmangur plotësisht risqet nga fatkeqësitë e pritshme (të identifikuara në bazë të Vlerësimit të Riskut në nivel Qarku) dhe fatkeqësitë e reja që mund të shfaqen, si rezultat i ngjarjeve të papritura natyrore apo edhe aktivitete të shkaktuara nga njeriu, të cilat mund të kenë pasoja të rrezikshme për jetën e njerëzve, infrastrukturën etj.

Lehtësimi, nga ana tjetër, përfshin zvogëlimin ose minimizimin e ndikimeve negative të një ngjarjeje të rrezikshme.

Edhe pse e vetëdijshme se disa risqe nga fatkeqësitë janë të pamundura për tu eliminuar plotësisht, Prefekti i Qarkut synon nëpërmjet këtij Plani të qarkut për emergjencat civile të zvogëlojë cënueshmërinë dhe ekspozimin ndaj tyre, si dhe të forcojë më tej sistemin e paralajmërimit të hershëm.

PQEC synon edhe integrimin me risqet rajonale (në nivel Qarku dhe më gjerë) që prekin territorin e qarkut, si digat, argjinaturat, risqet nga fatkeqësitë sizmike apo përhapja e sëmundjeve pandemike. Ky kapitull synon të paraqesë aktorët kryesorë të Qarkut Fier të përfshirë në masat parandaluese/lehtësuese dhe detyrat e secilit prej tyre në këtë fazë.

# 4.1 / Strukturat dhe institucionet përgjegjësitë e tyre për parandalimin /lehtësimin në nivel qarku

**Tabela 1:** Strukturat dhe institucionet përgjegjësitë e tyre në fazën e parandalimit/lehtësimit – Qarku Fier

| Institucionet dhe palët e përfshira | Përgjegjësitë në fazën e parandalimit/lehtësimit |
|---|---|
| | **Institucione dhe struktura në nivel bashkie** |
| **Prefekti i Qarkut Fier**<br>Sektori i Planifikimit, Përballimit të Emergjencave Civile dhe Krizave.<br><br>KMCQ | **Vlerësimi i Riskut:**<br>• Harton dhe ndjek miratimin e dokumentit të vlerësimit të riskut nga fatkeqësitë në nivel qarku.<br>• Koordinon me bashkitë për realizimin e vlerësimit të riskut dhe informimin e publikut për rreziqet.<br>• Punon për zhvillimin e hartave të përditësuara që tregojnë zonat e cenueshme ndaj rreziqeve specifike.<br>**Koordinimi i aktiviteteve për zvogëlimin e riskut:**<br>• Koordinon veprimtarinë e institucioneve dhe strukturave në nivel qarku për zvogëlimin e riskut dhe mbrojtjen civile.<br>• Siguron funksionimin e sistemeve të monitorimit, paralajmërimit të hershëm dhe alarmit për rreziqet në territorin e qarkut.<br>**Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave:**<br>• Krijon dhe mirëmban e bazës së të dhënave për humbjet nga fatkeqësitë në nivel qarku dhe shkëmbimi i informacioneve me Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile (AKMC).<br>**Parandalimi dhe zbutja e pasojave:**<br>• Vendos prioritete për investime emergjente dhe masat për parandalimin, mbrojtjen dhe rehabilitimin nga fatkeqësitë.<br>• Bashkëpunon me bashkitë dhe strukturat qendrore për të siguruar masa efektive në zvogëlimin e pasojave të fatkeqësive.<br>**Promovimi i kulturës së sigurisë:**<br>• Shpërndan informacion për publikun dhe komunitetin lidhur me risqet dhe masat parandaluese.<br>• Bashkëpunon me AKMC dhe institucionet e tjera për ndërgjegjësimin dhe edukimin e komunitetit. |
| Sektori Juridik | • Verifikon ligjshmërinë e akteve ligjore që kanë lidhje me cështje të emergjencave civile të nxjerra nga njësitë e vetëqeverisjes vendore.<br>• Jep asistencë Sektorit të Planifikimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile dhe Krizave pranë Administrtës së Prefektit për interpretim të ndryshëm ligjor dhe për hartimin e akteve të ndryshme ligjore. |

| | |
|---|---|
| Sektori i Monitorimit të Kompetencave Vendore dhe Funksioneve të Deleguara | • Ndihmon organet e vetëqeverisjes vendore për njohjen dhe ushtrimin e funksioneve të tyre në fushën e mbrojtjes civile.<br>• Evidenton problemet e organeve të njësive të vetëqeverisjes vendore që i shqetesojnë në fushën e emergjencave civile.<br>• Bashkërendon punën me organet e njësive të vetëqeverisjes vendore në fushën e zhvillimit të qarkut, duke mbajtur parasysh vlerësimin e riskut të fatkeqësive në nivel qarku, në mënyrë që mos të krijohen risqe të reja të fatkeqësive.<br>• Ndjek problemet e sigurisë në plazhe, e në zona të tjera turistike, higjenën, problemet shëndetësorë, të emergjencave civile etj.,<br>• Koordinon punën me intsituticionet në nivel qarku për konsultimet me njësitë e vetëqeverisjes vendore për politikat dhe legjislacionin. |
| Sektori i Zhvillimit Urban | • Monitoron njësitë e vetëqeverisjes vendore lidhur me masat që marrin për mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm.<br>• Monitoron njësitë e vetëqeverisjes vendore në mënyrë që planet e zhvillimit urban të mbajnë parasysh vlerësimin e riskut të fatkeqësive në nivel qarku dhe në nivel bashkie në mënyrë që mos të krijohen risqe të reja të fatkeqësive dhe informon prefektin nëse kë raste të tilla.<br>• Përgatit raporte dhe informacione në mënyrë të vazhdueshme në lidhje me mbledhjen dhe largimin e mbetjeve shtëpiake dhe të ngurta.<br>• Mbledh informacione në lidhje me problematikat e rrugëve rurale dhe urbane në nivel qarku dhe sipas rastit informon prefektin. |
| Sektori i Financës dhe i Shërbimeve Mbështetëse | • Verifikon nëse bashkitë kanë planifikuar fondet buxhetore për marrjen e masave për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, sipas parashikimeve ligjore dhe informon Prefektin e qarkut.<br>• Verifikon nëse vlera e kompensimit e bashkisë ka tejkaluar masën 8 % të buxhetit të saj, për të përcjellë dokumentacionin e paraqitur pranë Prefektit të qarkut për kompensim nga AKMC-ja. |
| Inspektoriati Rajonal Shtetëror Shëndetësor Fier | • Kryen të gjitha inspektimet në fushën e kompetencës së ministrisë përgjegjëse në fushën e shëndetësisë, me përjashtim të inspektimit të veprimtarive në fushën farmaceutike. |

| | |
|---|---|
| Njësitë Vendore të Kujdesit Shëndetësor<br><br>Qendrat Shëndetësore/Ambulanca | • Vlerësimi i Riskut: Harton dokumentin e vlerësimit të riskut nga fatkeqësitë, për institucionet shëndetësore dhe përditëson atë sipas nevojave.<br>**Parandalimi i Ndikimeve Shëndetësore:**<br>• Siguron masa parandaluese për reduktimin e rrezikut ndaj ndërprerjeve të shërbimeve mjekësore.<br>• Vendos protokolle për identifikimin dhe trajtimin e rreziqeve që ndikojnë në shëndetin publik, si përhapja e sëmundjeve ngjitëse.<br>• Kualifikimi i Personelit: Organizimi i trajnimeve për personelin mjekësor për menaxhimin e situatave emergjente.<br>• Ndërgjegjësimi i Komunitetit: Bashkëpunon me autoritetet vendore për ndërgjegjësimin e komunitetit mbi masat parandaluese për fatkeqësitë shëndetësore. |
| Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror | • **Ndërgjegjësimi dhe edukimi publik:** Organizon fushata sensibilizuese dhe trajnimeve për grupet e cenueshme mbi masat parandaluese dhe menaxhimin social të fatkeqësive.<br>• **Identifikimi dhe monitorimi:** Vlerëson grupet e rrezikuara, mban të dhëna sociale dhe bashkëpunon për përmirësimin e mbrojtjes sociale.<br>• **Hartimi i politikave sociale për ZRF:** Integrimi i mbrojtjes sociale në strategjitë vendore për zvogëlimin e riskut dhe forcimi i kapaciteteve të institucioneve sociale.<br>• **Mbështetje për aftësinë ripërtëritëse sociale:** Merr masa parandaluese për të shmangur përkeqësimin e kushteve sociale dhe sigurimi i qasjes në shërbime për grupet e cenueshme. |
| Përfaqësues të FA në nivel qarku<br>(Regjimenti i Këmbësorisë së Jugut, Reparti Ushtarak i Poshnjes) | • Ka përgjegjësinë e shpërndarjes së gatishmërisë në Forcat e Ushtrisë dhe aktivizimin e strukturave në lidhje me fazat.<br>• Mbështetja e bashkive në identifikimin dhe vlerësimin e risqeve specifike të zonës.<br>**Promovimi i Kulturës së Sigurisë:**<br>• Merr pjesë në aktivitete ndërgjegjësuese dhe edukative për komunitetin mbi masat parandaluese.<br>• Bashkëpunon me autoritetet vendore për të informuar publikun mbi praktikat më të mira për zvogëlimin e risqeve. |
| Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare Durrës | **Planifikimi dhe Zbatimi i Masave Antisizmike**<br>• Kryen vlerësimin e riskut sizmik për objektet dhe infrastrukturën e trashëgimisë kulturore në qarkun Fier.<br>• Harton dhe zbaton masa specifike për forcimin strukturor dhe mbrojtjen antisizmike të objekteve të trashëgimisë kulturore, në përputhje me standardet për mbrojtjen e trashëgimisë në zona të ekspozuara ndaj riskut sizmik. |

| | |
|---|---|
| | **Mirëmbajtja Preventive dhe Monitorimi i Vazhdueshëm:**<br>• Siguron mirëmbajtje të vazhdueshme të parqeve arkeologjike, duke përfshirë:<br>• Merr masa për pastrimin e vazhdueshëm të bimësisë që mund të dëmtojë strukturat e trashëgimisë.<br>• Inspekton dhe kryen riparime të vogla për të shmangur dëmtimet afatgjata.<br>• Vendos sisteme të monitorimit për të identifikuar në kohë shenjat e degradimit të infrastrukturës së trashëgimisë kulturore.<br>**Bashkëpunimi për masa preventive:**<br>• Bashkëpunon me institucione qendrore dhe vendore, organizata ndërkombëtare, dhe donatorë për të realizuar:<br>• Zhvillon projekte për përmirësimin e infrastrukturës së trashëgimisë kulturore.<br>• Harton Nisma për të integruar teknologjitë moderne në mbrojtjen e trashëgimisë (p.sh., përdorimi i sensorëve për monitorim sizmik).<br>**Ndërgjegjësimi dhe Edukimi Publik:**<br>• Organizon i fushata për ndërgjegjësimin e komunitetit lokal mbi rëndësinë e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore dhe masat për parandalimin e dëmtimeve.<br>• Bashkëpunon me shkollat dhe qendrat kulturore për të edukuar brezat e rinj mbi vlerën e trashëgimisë kulturore dhe metodat për mbrojtjen e saj. |
| Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST) Fier | **Monitorimi i Rreziqeve të Furnizimit me Energji Elektrike:**<br>• Kryerja e analizave të rreziqeve për rrjetin e transmetimit, duke përfshirë ndikimin e motit ekstrem, ngarkesat e tepërta dhe faktorët gjeologjikë.<br>• Inspektimi i linjave të tensionit të lartë për të shmangur dëmtime nga stuhitë, zjarret ose ndërhyrjet e jashtme.<br>• Zbatimi i teknologjive inteligjente për mbikëqyrjen e rrjetit në kohë reale dhe optimizimin e furnizimit.<br>**Menaxhimi i Infrastrukturës Kritike:**<br>• Identifikimi i pikave kritike të sistemit të transmetimit në rajonin e Fierit dhe investimi në masat mbrojtëse (përforcimi i shtyllave, instalimi i izolatorëve rezistentë ndaj kushteve atmosferike).<br>• Mirëmbajtja dhe përmirësimi i rrjetit të transmetimit për të zvogëluar rrezikun e ndërprerjeve masive.<br>• Sigurimi i furnizimit të vazhdueshëm për infrastrukturën kritike dhe publike (spitale, institucione shtetërore, qendra operacionale të emergjencave).<br>**Bashkëpunimi dhe Koordinimi:**<br>• Koordinimi me Prefekturën dhe bashkitë për të siguruar mbrojtjen e infrastrukturës energjetike dhe për të hartuar plane për menaxhimin e risqeve. |

| | |
|---|---|
| | • Identifikimi dhe menaxhimi i zonave me ndjeshmëri të lartë ku ndërprerjet e transmetimit mund të shkaktojnë pasoja të mëdha në sektorët strategjikë dhe komunitete.<br>• Vendosja e mekanizmave të komunikimit të drejtpërdrejtë me Prefekturën, njësitë e emergjencave dhe operatorët e shpërndarjes për të siguruar koordinimin e shpejtë dhe efektiv gjatë situatave emergjente.<br>**Ndërgjegjësimi dhe Masat Parandaluese:**<br>• Informimi i institucioneve dhe bizneseve mbi masat parandaluese për sigurinë e furnizimit me energji.<br>• Organizimi i trajnimeve për institucionet lokale mbi sigurinë dhe masat e parandalimit për furnizimin me energji. |
| Drejtoria Rajonale e OSHEE-së | **Monitorimi i Rreziqeve të Furnizimit me Energji Elektrike:**<br>• Kontrolli periodik i rrjetit të shpërndarjes për të evidentuar rreziqet që mund të çojnë në defekte të shumta.<br>• Parandalimi i mbingarkesave në rrjet gjatë periudhave të konsumit të lartë për të shmangur prishjet dhe ndërprerjet..<br>• Implementimi i sistemeve inteligjente të shpërndarjes për monitorimin dhe optimizimin e shpërndarjes së energjisë.<br>**Menaxhimi i Infrastrukturës Kritike:**<br>• Investimi në rrjetin e shpërndarjes për ta bërë më rezistent ndaj faktorëve klimatikë dhe ngarkesave të papritura.<br>• Forcimi i kabllove ajrore dhe nënkalimi i tyre në zonat e rrezikuara nga erozioni ose rrëshqitjet e tokës.<br>• Mirëmbajtja periodike e linjave dhe stacioneve shpërndarëse për të zvogëluar rrezikun e defekteve.<br>**Bashkëpunimi dhe Koordinimi:**<br>• Koordinimi me bashkitë dhe njësitë administrative për mbrojtjen e infrastrukturës energjetike dhe hartimin e masave parandaluese.<br>• Identifikimi i zonave me rrezik të lartë për të siguruar masa mbrojtëse dhe për të shmangur ndërprerjet e energjisë në sektorët kritikë.<br>• Garantimi i furnizimit të pandërprerë për institucionet strategjike si spitalet dhe stacionet e pompimit të ujit.<br>**Ndërgjegjësimi i Publikut:**<br>• Informimi i komunitetit mbi përdorimin e sigurt të energjisë dhe parandalimin e mbingarkesave.<br>• Krijimi i një mekanizmi efektiv komunikimi për njoftimet mbi mirëmbajtjen dhe ndërprerjet e planifikuara.<br>• Sigurimi i shërbimit të mbështetjes teknike për abonentët në rast të emergjencave elektrike. |

| | |
|---|---|
| Drejtoria Ujitjes dhe Kullimit Fier | **Përgatitja dhe Mirëmbajtja:**<br>• Kryen mirëmbajtjen dhe pastrimin e vazhdueshëm të kanaleve të ujitjes dhe kullimit për të parandaluar përmbytjet dhe degradimin e tokës.<br>• Identifikon zonat me rrezik për grumbullimin e ujërave dhe marrja e masave parandaluese për të siguruar funksionalitetin e rrjetit të kullimit.<br>• Zbaton masat strukturore dhe jostrukturore të nevojshme për rritjen e kapaciteteve.<br>• Monitoron i kapacitet hidraulike të kanaleve dhe propozimi i investimeve për përmirësimin e sistemit të ujitjes dhe kullimit.<br>**Planifikimi dhe Koordinimi:**<br>• Harton plane për menaxhimin efektiv të sistemeve të ujitjes dhe kullimit, duke përfshirë masat për përballimin e kushteve ekstreme të motit si pasojë e ndryshimeve klimatike .<br>• Koordinon me autoritetet lokale për të siguruar që masat për ujitjen dhe kullimin janë në përputhje me planet për emergjencat civile dhe strategjitë e ZRF. |
| Agjencia Rajonale e Mjedisit | **Vlerësimi i risqeve dhe planifikimi mjedisor**<br>• Kryen vlerësimin e risqeve dhe mjedisore në rajon, duke analizuar rreziqet, ekspozimin, cenueshmërinë dhe ndikimet e mundshme mbi ekosistemet dhe komunitetet<br>• Zhvillon strategji për mbrojtjen e ekosistemeve që zvogëlojnë ndikimet e fatkeqësive mjedisore.<br>• Ofron udhëzime teknike për përdorimin e tokës dhe zonimin për të minimizuar risqet mjedisore dhe ndikimet e urbanizimit në zonat e mbrojtura.<br>**Monitorimi dhe Raportimi:**<br>• Monitoron cilësinë e ajrit, ujit, tokës dhe burimeve natyrore, duke identifikuar rreziqe që mund të kërcënojnë shëndetin publik.<br>• Informon autoritet për çdo kërcënim mjedisor, si ndotje kimike apo degradim ekosistemesh.<br>**Paralajmërimi i hershëm dhe masat parandaluese:**<br>• Zbaton sistemet te paralajmërimit të hershëm për fatkeqësi mjedisore si përmbytjet, rrëshqitjet e tokës apo ndotjet masive.<br>• Harton dhe zbaton planet për mbrojtjen dhe ruajtjen dhe restaurimin e burimeve natyrore.<br>**Mbështetje dhe Ndërgjegjësim:**<br>• Siguron të dhëna dhe politika për zvogëlimin e risqeve mjedisore në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare.<br>• Organizon aktivitete për ndërgjegjësimin e komunitetit mbi risqet mjedisore dhe mbrojtjen e mjedisit. |

| | |
|---|---|
| Shoqëria Ujësjellës Kanalizimeve Sh.a | **Sigurimi i Cilësisë së Ujit të Pijshëm:**<br>• Monitoron dhe garanton kushtet higjeno-sanitare të furnizimit me ujë të pijshëm për popullatën.<br>• Kryen analiza të vazhdueshme për cilësinë e ujit, duke identifikuar dhe parandaluar ndotjet që përbëjnë rrezik për shëndetin publik.<br>• Kryen menaxhimin e përgjithshëm të monitorimit të cilësisë, sasisë së prodhimit të ujërave të ndotura industriale dhe shkarkimeve në mjedisin ujor sipërfaqësor ose nëntokësor pas trajtimit që duhet të kryhet nga organet e përcaktuara me ligje të veçanta.<br>**Parandalimi i Rreziqeve dhe Menaxhimi i Riskut:**<br>• Zbaton masa parandaluese për të minimizuar riskun nga defektet në rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimeve.<br>• Bashkëpunon me institucionet vendore për të siguruar furnizim të qëndrueshëm me ujë në kushte normale dhe emergjente. |
| Drejtoria Rajonale e Arsimit Para-Universitar Fier | • Informon dhe ndërgjegjëson nxënësit/rininë për risqet dhe masat parandaluese.<br>• Edukon  për gatishmërinë ndaj fatkeqësive në kurrikulën shkollore.<br>• Identifikon, sëbashku me ZVAP dhe bashkitë, asetet infrastrukturore arsimore që mund të vihen në dispozicion Qarkut Fier në rast fatkeqësish.<br>• Udhëzon dhe mbikëqyr hartimin e  një plani paraprak evakuimi dhe përcaktimi i një vendi grumbullimi për nxënësit dhe mësuesit në rast emergjence civile.<br>• Harton një planitë detajuar veprimi nga stafi mësimor i shkollës për emergjencat natyrore, i cili duhet të publikohet në çdo korridor dhe në çdo kat të godinave.<br>• Vendos tabela në vende të dukshme: Ndalohet pirja e duhanit, Nuk lejohet zjarr. Rreziku nga zjarri etj.<br>• Pajisë ndërtesat me shenja evakuimi dhe drita emergjence.<br>• Përgatitë dhe shpërndanë broshura, libra edukativë, dhe materiale vizuale për risqet dhe masat për parandalimin e tyre.<br>• Organizon trajnime për mësuesit mbi identifikimin e rreziqeve dhe rolin e tyre në edukimin dhe ndërgjegjësimin e nxënësve.<br>• Identifikon bashkë me DVAP dhe bashkitë i problematikave strukturore që mund të shkaktojnë rrezik (shembje, rrëshqitje, zjarre, etj.) dhe raportimi për ndërhyrje të mëtejshme.<br>• Angazhon shkollat në aktivitete komunitare për ndërgjegjësimin e familjeve dhe banorëve për masat parandaluese.<br>• Mbështetë aktivitet që inkurajojnë mbrojtjen e mjedisit dhe zvogëlimin e faktorëve që mund të rrisin risqet, si pyllëzimi dhe zvogëlimi i ndotjes. |

| | |
|---|---|
| Drejtoria Rajonale e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, Fier | **Monitorimi dhe kontrolli i sigurisë ushqimore**<br>• Siguron përputhshmërinë e produkteve ushqimore, ushqimeve për kafshë dhe inputeve bujqësore me standardet higjieno-sanitare dhe fitosanitare për të parandaluar rreziqet për konsumatorët.<br>• Kryen inspektime të rregullta për identifikimin e praktikave të pasigurta dhe vendos masa parandaluese ndaj operatorëve që nuk përmbushin kriteret ligjore.<br>**Vlerësimi dhe parandalimi i risqeve ushqimore**<br>• Analizon faktorët që mund të ndikojnë në sigurinë ushqimore dhe merr masa për parandalimin e ndotjeve kimike, mikrobiologjike dhe fizike të ushqimeve.<br>• Bashkëpunon me institucionet e shëndetit publik për monitorimin e cilësisë së furnizimeve ushqimore dhe për zbatimin e standardeve të sigurisë ushqimore.<br>**Përmirësimi i kapaciteteve dhe ndërgjegjësimi**<br>• Organizon fushata ndërgjegjësuese për operatorët e biznesit ushqimor dhe publikun mbi praktikat e sigurta të përpunimit, ruajtjes dhe konsumit të ushqimit.<br>• Mbështet trajnime për aktorët e përfshirë në zinxhirin ushqimor për të forcuar kapacitetet parandaluese ndaj risqeve ushqimore.<br>**Planifikimi për sigurinë ushqimore në raste emergjencash**<br>• Harton masa parandaluese për garantimin e furnizimit me ushqime të sigurta në situata të jashtëzakonshme.<br>• Bashkëpunon me institucionet përgjegjëse për të siguruar një zinxhir furnizimi të qëndrueshëm dhe të kontrolluar në rast të krizave ushqimore. |
| Përfaqësues të kompanive të telekomunikacionit (Vodafone & One) | • Mirëmbajtja dhe forcimi i rrjetit telekomunikues, për të shmangur ndërprerjet dhe për të garantuar funksionimin e vazhdueshëm të infrastrukturës.<br>• Identifikimi dhe minimizimi i risqeve për infrastrukturën kritike, duke kryer inspektime të rregullta dhe ndërhyrje parandaluese për mbrojtjen e pikave të ndjeshme të rrjetit telekomunikues.<br>• Koordinimi me Bashkinë dhe strukturat emergjente për të përditësuar dhe forcuar kapacitetet e rrjetit telekomunikues, duke siguruar gatishmërinë dhe funksionimin e tij në çdo situatë.<br>• Ndërgjegjësimi i komunitetit mbi përdorimin e rrjeteve të komunikimit në situata emergjente, për të parandaluar mbingarkesën e rrjetit dhe për të përmirësuar reagimin e komunitetit në raste krizash. |

| | |
|---|---|
| Zyra e Administrimit të Basenit Ujor Shkumbin-Seman | **Monitorimi dhe vlerësimi i burimeve ujore**<br>• Mbledh dhe përditëson të dhënat mbi sasinë dhe cilësinë e burimeve ujore në basenin lumor.<br>• Monitoron ndikimin e faktorëve natyrorë dhe njerëzorë mbi burimet ujore dhe harton raporte mbi rreziqet dhe kërcënimet e mundshme.<br>**Menaxhimi i risqeve të lidhura me ujërat**<br>• Analizon dhe parashikon rreziqet e përmbytjeve dhe thatësirave, duke hartuar plane parandaluese dhe masa mbrojtëse.<br>• Koordinon zbatimin e kushteve të lejeve dhe autorizimeve për përdorimin e ujit me qëllim parandalimin e dëmtimit të ekosistemeve ujore.<br>**Planifikimi dhe koordinimi për zvogëlimin e riskut**<br>• Bashkëpunon me institucionet qendrore dhe vendore për zbatimin e strategjive për mbrojtjen dhe menaxhimin e burimeve ujore.<br>• Harton dhe ndjek zbatimin e planeve të menaxhimit të baseneve ujore, duke përfshirë masa për zvogëlimin e ndikimeve të fatkeqësive natyrore në furnizimin me ujë.<br>**Sistemet e paralajmërimit dhe ndërgjegjësimi publi**k<br>• Përgatit dhe shpërndan informacion për komunitetet e rrezikuara mbi masat e mbrojtjes dhe përdorimin e qëndrueshëm të ujit.<br>• Bashkëpunon me Këshillin e Basenit Ujor për të përcaktuar prioritetet e ndërhyrjeve dhe masave parandaluese. |
| ARRSH Gjirokastër për Rajonin Jugor (Gjirokastër) | **Masat parandaluese për sigurinë e infrastrukturës rrugore**<br>• Kryen mirëmbajtje parandaluese të rrjetit rrugor për të shmangur dëmtime strukturore që mund të ndikojnë sigurinë e qarkullimit.<br>• Identifikon dhe dhe merr masa për minimizimin e zonave me risk të lartë nga përmbytjet, rrëshqitjet e dheut dhe faktorë të tjerë natyrorë që mund të ndikojnë rrugët.<br>• Mbikëqyr zbatimin e standardeve teknike në ndërtimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve për të siguruar që infrastruktura të jetë rezistente ndaj fatkeqësive natyrore.<br>**Bashkëpunimi dhe koordinimi për masa parandaluese**<br>• Bashkëpunon me prefekturën dhe institucionet përgjegjëse për identifikimin dhe zgjidhjen e problematikave që lidhen me sigurinë e rrugëve në situata të jashtëzakonshme.<br>• Siguron informacion të vazhdueshëm mbi zonat me rrezik të lartë për aktorët institucionalë dhe publikun për të rritur ndërgjegjësimin dhe parandalimin e aksidenteve.<br>**Masat për sigurinë e qarkullimit**<br>• Vendos dhe mirëmban sinjalistikë rrugore për paralajmërimin e rreziqeve dhe kufizimin e qarkullimit në zona të rrezikuara.<br>• Përmirëson sistemin e menaxhimit elektronik të trafikut për të siguruar informacion në kohë reale mbi gjendjen e rrugëve dhe rekomandimet për drejtuesit e mjeteve. |

| | |
|---|---|
| IKMT Fier | **Monitorimi dhe inspektimi i territorit për parandalimin e ndërtimeve të paligjshme**<br>• Kontrollon zbatimin e legjislacionit për ndërtimet për të parandaluar zhvillimet e paautorizuara që mund të rrisin rrezikun e emergjencave civile (EC).<br>• Inspekton dhe ndalon ndërtimet që shkaktojnë ndikime negative në menaxhimin e fatkeqësive (shembje, rrezik për përmbytje, rrëshqitje toke, etj.).<br>**Mbrojtja e burimeve ujore dhe parandalimi i degradimit të territorit**<br>• Monitoron dhe ndalon aktivitetet e paligjshme që dëmtojnë ekosistemet ujore dhe rrisin rrezikun e emergjencave (p.sh., ndotja e ujërave dhe devijimi i rrjedhave natyrore).<br>• Mbikëqyr zbatimin e legjislacionit për menaxhimin e burimeve ujore në funksion të zvogëlimit të risqeve nga fatkeqësitë natyrore.<br>**Inspektimi dhe parandalimi i dëmtimit të mjedisit**<br>• Inspekton ndotjen e ajrit, tokës dhe ujit, me synim parandalimin e ndikimeve negative në shëndetin publik dhe mjedisin.<br>• Zbaton masa për të kufizuar dëmtimet që mund të kontribuojnë në përkeqësimin e situatave emergjente, siç janë përmbytjet dhe ndotja e ujërave.<br>**Koordinimi me institucionet për planifikimin e territorit**<br>• Bashkëpunon me njësitë e qeverisjes vendore për zbatimin e standardeve të sigurisë në planifikimin urban, për të shmangur ndërhyrjet që mund të shkaktojnë rrezik për EC.<br>• Jep rekomandime për masa mbrojtëse ndaj zonave të rrezikuara nga fatkeqësitë.<br>**Fushata ndërgjegjësimi për parandalimin e ndërtimeve të paligjshme dhe degradimit të mjedisit**<br>• Ofron informacione dhe këshilla për publikun dhe bizneset për efektet e ndërtimeve të paligjshme dhe ndotjes në menaxhimin e emergjencave civile.<br>• Organizon fushata ndërgjegjësuese për promovimin e ndërtimit të qëndrueshëm dhe praktikave të menaxhimit të mjedisit. |
| Administrata e Zonave të Mbrojtura Pyjore qarku Fier | **Menaxhimi i burimeve natyrore dhe biodiversitetit**<br>Monitoron dhe menaxhon zonat e mbrojtura për të parandaluar degradimin e habitateve dhe për të ruajtur biodiversitetin, duke minimizuar risqet mjedisore që ndikojnë në fatkeqësitë natyrore.<br>**Parandalimi i zjarreve dhe degradimit të pyjeve**<br>Zhvillon dhe zbaton masa parandaluese për zjarret në pyje, duke përfshirë krijimin e korsive të ndalim-zjarrit dhe kontrollet periodike mbi aktivitetet me rrezik të lartë. Bashkëpunon me institucionet përgjegjëse për të siguruar zbatimin e rregulloreve për mbrojtjen e pyjeve dhe parandalimin e ndotjes. |

| | |
|---|---|
| | **Ndërgjegjësimi dhe edukimi për mbrojtjen e zonave të mbrojtura**<br>Ofron fushata informuese dhe trajnime për publikun dhe strukturat vendore mbi rëndësinë e mbrojtjes së ekosistemeve dhe masat që duhen marrë për të parandaluar degradimin e zonave të mbrojtura.<br>**Monitorimi dhe raportimi mbi risqet mjedisore**<br>Identifikon dhe vlerëson risqet mjedisore që mund të ndikojnë në zonat e mbrojtura, si zjarret, përmbytjet dhe erozioni, duke integruar këto analiza në planifikimin strategjik për parandalimin e emergjencave.<br>**Bashkëpunimi institucional për mbrojtjen e zonave të mbrojtura**<br>Koordinon veprimtarinë me institucionet qendrore dhe vendore për të siguruar një menaxhim të integruar të zonave të mbrojtura, duke përfshirë monitorimin e aktiviteteve që mund të ndikojnë negativisht në ekosisteme. |
| Agjencia Rajonale Ekstensionit Bujqësor Lushnjë | **Ndërgjegjësimi dhe edukimi i fermerëve:**<br>• Organizizon aktivitete ndërgjegjësuese dhe fushatave informuese për fermerët mbi mbrojtjen dhe shpëtimin e bimëve dhe produkteve bimore nga faktorët e rrezikut.<br>• Trajnon fermerët mbi teknikat e parandalimit të sëmundjeve dhe dëmtuesve të bimëve për të reduktuar ndikimin e rreziqeve natyrore dhe klimaterike.<br>**Monitorimi dhe kontrolli i shëndetit të bimëve:**<br>• Mbikëqyr dhe vlerëson gjendjen shëndetësore të bimëve dhe produkteve bimore për të identifikuar dhe parandaluar përhapjen e sëmundjeve dhe dëmtuesve.<br>• Siguron informacionin për fermerët mbi masat mbrojtëse dhe përdorimin e inputeve bujqësore në përputhje me standardet e sigurisë dhe mjedisit.<br>**Planifikimi dhe mbështetja teknike:**<br>• Asiston fermerët në zbatimin e praktikave të qëndrueshme bujqësore për të zvogëluar ndikimin e faktorëve të jashtëm në rendimentin e prodhimit.<br>• Ofron këshillime për përdorimin e teknologjive inovative në bujqësi për të rritur aftësinë ripërtëritëse ndaj rreziqeve natyrore.<br>**Koordinimi dhe bashkëpunimi:**<br>• Bashkëpunon me institucionet përkatëse për mbledhjen e të dhënave mbi ndikimin e fenomeneve natyrore në sektorin bujqësor dhe për hartimin e strategjive parandaluese.<br>• Siguron shkëmbimin e informacionit dhe praktikave më të mira me institucionet e kërkimit shkencor dhe organizatat mbështetëse për bujqësinë. |

| | |
|---|---|
| Drejtoria Rajonale e Veterinarisë dhe Mbrojtjes së bimëve Vlorë, Sektori Veterinar Qarku Fier | • Monitoron dhe kontrollon shëndetin e kafshëve dhe bimëve për të parandaluar shpërthimet e sëmundjeve infektive dhe dëmtuesve që mund të ndikojnë në shëndetin publik dhe ekonominë bujqësore.<br>• Harton dhe zbaton masa të biosigurisë në fermat blegtorale dhe zonat bujqësore për të reduktuar përhapjen e sëmundjeve dhe ndotjen nga pesticidet ose substancat e tjera të dëmshme.<br>• Organizon aktivitete edukative dhe fushatave ndërgjegjësuese për fermerët dhe operatorët e sektorit mbi menaxhimin e shëndetit të kafshëve dhe mbrojtjen e bimëve nga faktorët e rrezikut.<br>• Inspekton ferma dhe subjekte agro-veterinare për të siguruar përputhshmërinë me standardet e sigurisë ushqimore dhe të shëndetit të kafshëve e bimëve.<br>• Bashkëpunon me institucionet përkatëse për menaxhimin e rreziqeve që lidhen me shëndetin e kafshëve dhe bimëve, si dhe me autoritetet përgjegjëse për emergjencat bujqësore.<br>• Siguron mbledhje dhe analizimin e të dhënave për të vlerësuar rreziqet dhe për të marrë masa parandaluese në kohë.<br>• Merr masa për kontrollin dhe menaxhimin e përdorimit të produkteve veterinare dhe fitosanitare, duke parandaluar ndikimet negative në shëndetin e kafshëve, bimëve dhe mjedisin. |
| Albpetrol | • Monitoron dhe vlerëson rreziqet – Identifikon dhe vlerëson rreziqet mjedisore dhe operacionale të lidhura me aktivitetet e nxjerrjes dhe përpunimit të hidrokarbureve për të parandaluar ndotjen dhe aksidentet industriale.<br>• Zbaton standarde të sigurisë dhe mjedisit – Përdorimi i standardeve më të mira ndërkombëtare për të minimizuar ndikimin negativ të operacioneve hidrokarbure në mjedis dhe për të parandaluar aksidentet.<br>• Harton dhe zbaton i politika të sigurisë – Zhvillimi i strategjive dhe masave për të siguruar që operacionet të kryhen në përputhje me standardet teknike dhe ligjore për të shmangur incidentet dhe ndotjen.<br>• Inspekton dhe mirëmban infrastrukturën – Kontrolli i rregullt i instalimeve, puseve të naftës dhe pajisjeve teknike për të parandaluar defektet teknike që mund të çojnë në aksidente apo ndotje.<br>• Bashkëpunon me institucionet publike dhe rregullatore – Koordinimi me institucionet përkatëse për të garantuar zbatimin e politikave të sigurisë dhe mbrojtjes së mjedisit në industrinë hidrokarbure.<br>• Redukton ndikimin në shëndetin publik – Hartimi dhe zbatimi i masave për të minimizuar efektet e mundshme të operacioneve hidrokarbure në shëndetin e komunitetit dhe punonjësve.<br>• Zbaton masa për ruajtjen e biodiversitetit – Përfshirja e politikave për të mbrojtur ekosistemet në zonat ku zhvillohen operacionet e kërkimit dhe prodhimit të hidrokarbureve.<br>• Raporton dhe transparenca – Publikimi i informacionit mbi aktivitetet e Albpetrol dhe masat e marra për mbrojtjen e mjedisit dhe sigurinë publike. |

| | |
|---|---|
| Dega e Doganës Fier | • **Monitorim dhe kontroll i përputhshmërisë** – Kryerja e kontrolleve të rregullta për të siguruar që subjektet dhe mallrat e importuara/eksportuara janë në përputhje me ligjin doganor dhe rregulloret për mbrojtjen e mjedisit.<br>• **Zbaton standardet e sigurisë** – Mbikëqyrja dhe zbatimi i rregullave për shmangien e kontrabandës dhe rreziqeve që lidhen me hyrjen dhe daljen e mallrave të ndaluara ose të rrezikshme.<br>• **Identifikon dhe vlerëson risqet** – Vlerësimi i riskut për mallrat që kalojnë nëpër pikat doganore, për të parandaluar hyrjen e produkteve që mund të përbëjnë kërcënim për shëndetin publik ose sigurinë kombëtare.<br>• **Inspekton dhe mirëmban  infrastrukturën doganore** – Kontrolli i rregullt i terminaleve, hapësirave të magazinimit dhe infrastrukturës për të shmangur mangësi që mund të rrezikojnë sigurinë ose procesin doganor.<br>• **Promovon transparencën dhe komunikimin** – Sigurimi i informimit të subjekteve dhe publikut mbi procedurat doganore për të minimizuar shkeljet dhe për të rritur përputhshmërinë me rregulloret në fuqi.<br>• **Parandalon rreziqet nga mallrat e rrezikshme** – Verifikimi i dokumentacionit dhe kushteve të transportit për mallrat e rrezikshme, si lëndët kimike ose produktet farmaceutike, për të parandaluar incidente që lidhen me trajtimin e tyre të pasaktë.<br>• **Bashkëpunon me institucionet e tjera** – Koordinimi me institucionet ligjzbatuese dhe autoritetet përkatëse për të përmirësuar mbikëqyrjen doganore dhe parandalimin e shkeljeve. |
| Drejtoria Rajonale e Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive | • Monitoron tendencat etë tregut të punës – Analizimi i sektorëve ekonomikë dhe identifikimi i rreziqeve për punësimin me qëllim parandalimin e papunësisë strukturore pas emergjencave civile.<br>• Ndërmjetëson dhe jep orientim profesional – Ofrimi i informacionit dhe këshillimit për fuqinë punëtore në lidhje me sektorët më të sigurt dhe të qëndrueshëm për punësim.<br>• Koordinon me institucionet për nxitjen e punësimit – Bashkëpunimi me institucionet publike dhe organizatat joqeveritare për të lehtësuar integrimin e punëkërkuesve në tregun e punës pas situatave të jashtëzakonshme.<br>• Zhvillon politika aktive të punësimit – Hartimi dhe zbatimi i programeve që ndihmojnë grupet e cenueshme të përfshihen në tregun e punës në rastet e humbjes së vendeve të punës nga faktorë të jashtëm.<br>• Promovon masav mbrojtëse në tregun e punës – Ofrimi i skemave të mbrojtjes për të garantuar që punonjësit dhe punëkërkuesit të kenë mbështetje sociale për të lehtësuar ndikimet e pasigurive ekonomike.<br>• Informon mbi mundësitë e punësimit – Publikimi i njoftimeve për punësim dhe programe mbështetëse për punëkërkuesit në zonat me rrezik të lartë ekonomik pas emergjencave. |

| | |
|---|---|
| Drejtoria Rajonale e Entit Kombëtar të Banesave | • Monitoron dhe planifikon hapësira të sigurta për strehim – Identifikimi i zonave me risk të ulët dhe promovimi i zhvillimit të qëndrueshëm të banesave për të minimizuar nevojën për strehim emergjent në rast fatkeqësish natyrore.<br>• Promovon ndërtimin e qëndrueshëm – Hartimi dhe zbatimi i udhëzimeve për projektimin dhe ndërtimin e banesave të sigurta dhe rezistente ndaj fatkeqësive natyrore, në përputhje me standardet teknike dhe urbanistike.<br>• Ndërgjegjësimi dhe edukimi – Ofron informacion dhe këshilla për qytetarët mbi rëndësinë e sigurisë strukturore të ndërtesave dhe masat që duhen marrë për të reduktuar rrezikun nga fatkeqësitë natyrore.<br>• Bashkëpunon me institucionet e planifikimit urban – Angazhimi në zhvillimin dhe zbatimin e politikave të menaxhimit të tokës dhe urbanizimit për të parandaluar ndërtimet në zona me risk të lartë.<br>• Mbikëqyrë zbatimin e rregulloreve të ndërtimit – Sigurimi që ndërtesat dhe zonat e reja të banimit të ndërtohen sipas standardeve të sigurisë dhe planeve rregulluese për të zvogëluar ekspozimin ndaj rreziqeve natyrore. |
| Drejtoria Vendore e Policisë Fier/Komisariatet/ Stacionet e Policisë | • Harton dhe përditëson planet e sigurisë për parandalimin e situatave emergjente, duke u bazuar në zonat e ndjeshme dhe risqet e identifikuara në dokumentet e vlerësimit të riskut.<br>• Identifikon dhe monitoron zonat të ndjeshme nga kërcënimet e mundshme për sigurinë publike.<br>• Sensibilizon komunitetet për rëndësinë e sigurisë dhe masat parandaluese në rast fatkeqësish.<br>• Bashkëpunon me autoritetet vendore dhe institucionet përkatëse për të koordinuar masat parandaluese dhe lehtësuese në komunitet. |
| Kryqi i Kuq i Shqiptar, /Degët e Kryqit të Kuq që veprojnë në qark | • Ndërgjegjësimi dhe edukimi i komunitetit<br>o Organizon fushata të informimit mbi masat parandaluese për të zvogëluar ndikimin e fatkeqësive të shkaktuara nga rreziqet natyrore dhe në veçanti, emergjencave shëndetësore.<br>o Promovon sjellje të sigurta dhe masave vetëmbrojtëse, duke ndihmuar komunitetet të zvogëlojnë ekspozimin ndaj rreziqeve.<br>• Mbështetja e Strukturave Vendore për Zvogëlimin e Riskut<br>o Këshillon institucionet lokale për përcaktimin e masave të duhura parandaluese, bazuar në vlerësimin e riskut.<br>o Bashkëpunon me komunitetet për të identifikuar faktorët e riskut dhe për të promovuar masa mbrojtëse afatgjata.<br>• Bashkëpunimi me Institucionet Shtetërore dhe Organizatat Ndërkombëtare<br>o Kontribuon në përcaktimin e prioriteteve për zvogëlimin e riskut në nivel vendor dhe kombëtar.<br>• Shpërndan udhëzimet dhe praktikat më të mira ndërkombëtare, të adaptuara për realitetin lokal. |

# 5. Gatishmëria

## 5.1 / Analiza e riskut për Qarkun Fier

**Qarku Fier dhe gjashtë bashkitë në territorin e tij - Fier, Lushnjë, Divjakë, Patos, Roskovec dhe Mallakastër - janë të ekspozuara ndaj një sërë risqesh të ndryshme**. Sipas gjetjeve të Raportit të Vlerësimit të Riskut nga Fatkeqësitë në Qarkun Fier (2023-2024), këto bashki përballen me nivele të ndryshme ekspozimi ndaj risqeve të shumta:

- **Bashkia Fier:** Identifikohet si më e ekspozuara, veçanërisht e ndjeshme ndaj aktivitetit sizmik, zjarreve në pyje, rrëshqitjeve të dheut, përmbytjeve, risqeve biologjike dhe aksidenteve industriale. Afërsia e saj me zonat kryesore industriale, përfshirë objektet e naftës dhe gazit e rrit ndjeshëm nivelin e riskut për risqe teknologjike dhe ndotje mjedisore. Për më tepër, terreni i sheshtë dhe sistemet lumore e bëjnë atë më të prekshme ndaj përmbytjeve.
- **Bashkia Lushnjë**: Shumë e ndjeshme ndaj aktivitetit sizmik, rrëshqitjeve të dheut, përmbytjeve, risqeve biologjike, aksidenteve industriale dhe zjarreve në pyje. Infrastruktura kritike dhe tokat bujqësore janë shpesh në risk, veçanërisht në zonat pranë pellgjeve ujore dhe rajoneve kodrinore. Kjo bashki përballet gjithashtu me risqe biologjike, të cilat u evidentuan gjatë pandemisë COVID-19.
- **Bashkia Divjakë:** Është e ekspozuar ndaj aktiviteteve sizmike, rrëshqitjeve të dheut dhe risqeve biologjike, kryesisht për shkak të ekosistemit të saj unik, duke përfshirë ligatinat dhe pyjet. Risqe të tjera, si përmbytjet dhe risqet teknologjike, paraqiten në nivel më të ulët.Parku Kombëtar Divjakë-Karavasta përbën një aset të rëndësishëm mjedisor, por rrit riskun e zjarreve në pyje dhe dëmtimit të ekosistemit.
- **Bashkia Patos:** Përballet me risqe të konsiderueshme teknologjike për shkak të rolit të saj si një qendër kryesore për nxjerrjen dhe përpunimin e naftës. Ajo është gjithashtu, e ndjeshme ndaj risqeve sizmike, biologjike, rrëshqitjeve të dheut në zonat kodrinore dhe zjarreve në pyje. Infrastruktura e vjetëruar i përkeqëson më tej këto risqe, duke ndikuar si në sigurinë mjedisore ashtu edhe në atë publike. Risku i përmbytjeve është gjithashtu i pranishëm, edhe pse në një nivel më të ulët krahasuar me risqet e tjera.
- **Bashkia Roskovec:** Edhe pse relativisht më pak e ekspozuar krahasuar me bashkitë e tjera, përballet gjithsesi me risqe biologjike, rrëshqitje dheu, risqe sizmikë dhe teknologjikë. Tokat e saj bujqësore janë të cenueshme ndaj ngjarjeve ekstreme të motit, ndërsa prania e objekteve industriale në afërsi rrit ekspozimin ndaj risqeve të mundshme mjedisore dhe teknologjike. Përmbytjet dhe zjarret në pyje janë të pranishme, por në një shkallë më të ulët.
- **Bashkia Mallakastër:** Kjo bashki përballet me një nivel të lartë të risqeve biologjike, rrëshqitjeve të dheut, sizmike, përmbytjeve Afërsia me zonat industriale ndjeshmërinë ndaj incidenteve teknologjike dhe ndotjes mjedisore. Terreni kodrinor e amplifikon më tej riskun e rrëshqitjeve të dheut dhe përkeqëson pasojat e reshjeve të dendura.

## 5.2 / Informimi dhe ndërgjegjësimi publik

Komunikimi është një element kyç gjatë situatave emergjente. Ai shërben për të garantuar sigurinë e popullatës, rrit besimin e publikut dhe redukton ndjeshëm situatat e panikut. Për këtë arsye, informacioni duhet të jetë i qartë, i saktë dhe në kohë reale, si për banorët e kërcënuar nga rreziku, ashtu edhe për çdo palë tjetër të përfshirë në proces. Në vijim PQEC paraqet strategjitë kryesore për koordinimin ndërinstitucional dhe komunikimin me publikun.

### Komunikimi ndërinstitucional

Gjatë emergjencës, është e rëndësishme që të gjitha institucionet e përfshira (qeverisja vendore, SHUM, kujdesi shëndetësor dhe agjencitë kombëtare) të komunikojnë në mënyrë efektive. Në bazë të VKM nr. 923, datë 25.11.2020, pika nr. 17: "*Komunikimi me publikun në rastet e emergjencave/fatkeqësive natyrore kryhet nga ministria përgjegjëse për mbrojtjen civile*".

Komunikimi ndërinstitucional siguron:

- *Unifikimin e informacionit:* Institucionet e përfshira në menaxhimin e emergjencave duhet të shpërndajnë informacion të saktë dhe të harmonizuar për të shmangur keqinformimin.
- *Rolet e qarta:* Asnjë institucion nuk duhet të japë informacion të paqartë ose të pakoordinuar me partnerët e tjerë. Për këtë arsye, protokollet e komunikimit duhet të jenë të përcaktuara paraprakisht mes tyre. (shih tabelën më poshtë)
- *Koordinimi i centralizuar:* është shumë e rëndësishme krijimi i një qendre të dedikuar për menaxhimin e informacionit të mare nga institucionet e tjera që veprojnë në bashkërendim. Kjo siguron që mesazhet të jenë të qarta, të sakta dhe pa keqkuptime.
- *Përdorimi i teknologjisë:* Platformat dixhitale dhe sistemet e brendshme të komunikimit mund ndihmojnë në shpërndarjen më të shpejtë dhe efikase të informacionit ndërmjet institucioneve.
- *Pajisje radiomarrëse:* Në raste emergjente, energjia elektrike mund të ndërpritet, jo vetëm në zonën e prekur nga fatkeqësia, por edhe më gjerë, duke ndikuar në funksionimin e antenave të operatorëve celularë. Mbyllja e këtyre kanaleve të komunikimit e vështirëson edhe më tej koordinimin dhe përgjigjen ndaj emergjencës. Për këtë arsye, të gjitha institucionet duhet të jenë të pajisura me një numër të mjaftueshëm radiomarrësish me valë të gjata të cilët duhet të testohen rregullisht për të siguruar funksionalitetin e tyre në çdo kohë.

*Figura 6* shërben si udhëzues për rrjedhën e informacionit për situatat para emergjencave dhe në rastet kur përgjigja ndaj fatkeqësive/emergjencave ka filluar dhe vazhdon.

**Figura 6:** Protokolli i Komunikimit gjatë Emergjencave Civile




## Fushata ndërgjegjësuese

Është thelbësore që popullata të informohet periodikisht. Në fund të sezonit të verës në periudhën Shtator-Tetor duhet të bëhen fushata ndërgjegjësimi me komunitetin lidhur me reshjet / stuhitë / përmbytjet për periudhën vjeshtë-dimër, kurse në fund të muajit Shkurt dhe fillim në të Marsit për reshjet gjatë sezonit të pranverës. Ndërsa për zjarret që mund të ndodhin gjatë stinës së verës, fushatat e ndërgjegjësimit me komunitetin duhet të zhvillohen qysh gjatë muajit Maj e në vazhdim. Qëllimi i saj është të informojë popullatën për kërcënimet e ardhshme, si të parandalohen rreziqet tashmë të njohura në kohë reale, sipas një protokolli të detajuar, i cili përfshin institucionet publike hap pas hapi. Gjithashtu, Prefekti i qarkut Fier/ Sektori i Planifikimit, Përballimit të Emergjencave Civile dhe Krizave duhet të zhvillojnë fushata informimi për komunitetin, duke shpërndarë materiale sensibilizuese si postera dhe fletëpalosje në të gjithë zonën e qarkutduhet të informojë banorët me postera dhe fletëpalosje të shpërndara në të gjithë territorin e saj (Shih Kreu 4.2). Fushata informimi duhen ndërmarrë edhe me institucionet arsimore për të kultivuar parimin e parandalimit të kërcënimeve nga risqet e fatkeqësive.

Sektori i Planifikimit, Përballimit të Emergjencave Civile dhe Krizave duhet të zhvillojnë fushata informimi për komunitetin, duke shpërndarë materiale sensibilizuese si postera dhe fletëpalosje në të gjithë zonën e qarkut.

### Komunikimi me publikun gjatë një emergjence

Komunikimi publik është një aspekt shumë i rëndësishëm përpara dhe gjatë emergjencave. Informacioni i dhënë gjatë kësaj kohe parandalon përhapjen e panikut. Megjithatë duhet të bëhet kujdes që publikut jo vetëm t'i ofrohet informacioni i duhur por edhe në kohën e duhur. Në rast emergjence, popullata duhet të informohet për nivelin e riskut, masat që duhen marrë dhe procedurat për evakuim, nëse është e nevojshme.

Njoftimi i popullatës në rast emergjence jepet nga Sektori i Planifikimit dhe Mbrojtjes Civile në Administratën e Prefektit os QOECQ kur ajo është e aktivizuar. Njoftimi duhet të shmangë situatat e alarmit të panevojshëm. Gjithashtu, informacionet duhet të përcaktohen me kujdes për t'u ndarë me publikun, duke marrë parasysh mundësinë e keqinterpretimit dhe rrezikun e shkaktimit të panikut në situata emergjente.

- Informacioni duhet të vijë drejtpërdrejt nga përfaqësues/zyrtarë të institucioneve publike.
- Informacioni i përzgjedhur për transmetim duhet të miratohet nga autoritetet përkatëse, si në nivel qarku ashtu dhe në nivel qendror (QKOEC në AKMC). Nuk duhet të transmetohet më shumë informacion sesa ai i miratuar, për të shmangur keqkuptimet.
- Gjuha e përdorur duhet të tregojë se autoritetet janë të përgatitura për t'u marrë me një situatë të tillë dhe se janë marrë masat e duhura.
- Ndonëse është e rëndësishme të shmanget paniku, kjo nuk duhet të komprometojë transparencën në lidhje me rreziqet reale. Të gjitha kërcënimet duhet të bëhen publike. Në të kundërtën do të cenohet besueshmëria e institucioneve.
- Rekomandohet që koordinatorit të caktuar për informimin publik t'i ruhet qëndrueshmëria në detyrë, për të siguruar vazhdimësinë dhe saktësinë e komunikimit. Ndryshimi i koordinatorit duhet të ndodhë vetëm në rrethana të jashtëzakonshme, kur situata e kërkon dhe një autoritet tjetër e merr përsipër këtë përgjegjësi. Një ndryshim i paarsyeshëm mund të shkaktojë konfuzion dhe të ndikojë negativisht në besimin e publikut.
- Pasi të përcaktohet natyra e informacionit, ai duhet të transmetohet përmes kanaleve më të njohura dhe më të aksesueshme nga popullata, si televizioni, radio, rrjetet sociale, SMS, etj.

### Plani i komunikimit dhe fazat e emergjencës

Plani i komunikimit në nivel Qarku duhet të përfshijë të gjithë informacionin e nevojshëm.

- Përpara emergjencës (*Parandalim/Gatishmëri*): Duhet të transmetohen mesazhe për gatishmërinë dhe edukimin e popullatës për kërcënimet e mundshme, të njohura dhe të panjohura.
- Emergjenca (*Përgjigje*): Çdo informacion duhet të jetë i qartë dhe të ofrojë një pasqyrë të gjerë të situatës, sigurisë, planit të masave dhe veprimeve konkrete që do të ndërmerren. Është e rëndësishme që publiku të mos marrë shumë informacion menjëherë.
- Përshkallëzimi i emergjencës (*Përgjigje*): Vetëm në këtë rast duhet të rritet frekuenca e komunikimit, duke transmetuar përditësime më të detajuara me tone të qeta.
- Pas emergjencës (*Rimëkëmbje*): Në këtë fazë transmetohet informacioni për rehabilitimin/rimëkëmbjen, normalitetin e shërbimeve publike dhe pasojat afatgjata (nëse ka).

## Komunikimi para emergjencës

Përgatitja është çelësi për një përgjigje efektive emergjente. Komunikimi publik përpara se të ndodhë një emergjencë mund të zvogëlojë ndjeshëm risqet dhe të rrisë aftësinë ripërtëritëse të komunitetit. Komunikimi para emergjencës duhet të fokusohet në:

- *Fushatat e ndërgjegjësimit publik*: Edukimi i publikut për rreziqet/risqet e mundshme dhe rëndësinë e gatishmërisë përmes fushatave të vazhdueshme.
- *Trajnime dhe stërvitje*: Aktivitetet e angazhimit publik, të tilla si stërvitjet dhe sesionet e trajnimit, do të ndihmojnë në njohjen e publikut me rrugët e evakuimit, kontaktet emergjente dhe masat e ndihmës së parë.
- *Bashkëpunimi me drejtuesit lokalë*: Partneriteti me drejtuesit e komunitetit lokal për të shpërndarë informacionin e gatishmërisë emergjente siguron kontakt më të mirë me komunitetet.
- Duke kultivuar një kulturë gatishmërie, publiku do të ketë më shumë gjasa të ndjekë udhëzimet gjatë një emergjence aktuale, duke minimizuar panikun dhe konfuzionin.

## Fluksi i informacionit dhe fazat e emergjencës

Plani i komunikimit duhet të pasqyrojë fazat e ndryshme të një emergjence:

- *Parandalimi dhe Gatishmëria* – Fokusimi në mesazhet e gatishmërisë dhe edukimit për risqet.
- *Përgjigja* – Sigurimi i informacionit të menjëhershëm dhe të qartë për situatën, masat e sigurisë dhe veprimet e reagimit. Shmangia e ngarkesës së publikut me shumë informacione në të njëjtën kohë. Rritja e frekuencës së komunikimit ndërsa situata evoluon, duke ofruar përditësime të detajuara dhe duke ruajtur qetësinë.
- *Rimëkëmbja* (ose situata post-emergjencë) – Dhënia e informacionit mbi përpjekjet për rimëkëmbje, shërbimet publike dhe çdo ndikim afatgjatë. Garantimi i publikut dhe inkurajimi i nismave për rimëkëmbjen e komunitetit.

## Angazhimi i komunitetit

Përfshirja e komunitetit në PQEC është jetike për zbatimin e suksesshëm të Planit. Strategjitë e angazhimit duhet të përfshijnë:

- *Ndërtimin e besimit*. Lejimin e publikut për të bërë pyetje ose për të dhënë komente gjatë dhe pas emergjencave ndërton besimin dhe ofron njohuri të vlefshme për të ardhmen.
- *Vullnetarët e komunitetit*. Trajnimi i vullnetarëve lokalë të cilët mund të veprojnë si ndërlidhës komunikimi ndërmjet autoriteteve dhe anëtarëve të komunitetit në lagjet e tyre.
- *Angazhimin gjithëpërfshirës*. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet garantimit që të gjitha grupet demografike, përfshirë popullsinë e margjinalizuar, të përfshihen në përpjekjet e komunikimit dhe angazhimit.

## 5.3 / Masat e gatishmërisë

Faza e *Gatishmërisë* në ciklin e menaxhimit të emergjencave civile lidhet me njohuritë dhe kapacitetet e institucioneve përgjegjëse në nivel qarku, si dhe të komunitetit për t'iu përgjigjur fatkeqësive të mundshme. Plani përbën një mjet operacional për MEC bazuar në njohuritë e marra dhe organizimin e miratuar përpara se të ndodhë ngjarja.

Faza e Gatishmërisë, përbëhet nga shtatë komponentë kryesorë:

- Informimi dhe edukimi lidhur me risqet kryesore me të cilat përballet Qarku Fier, bazuar në vlerësimin e riskut.
- Sistemet e paralajmërimit të hershëm dhe komunikimi i emergjencave përfshijnë zhvillimin dhe funksionimin e mekanizmave për mbledhjen dhe shpërndarjen e informacionit mbi risqet, përmirësimin e kanaleve të komunikimit ndërmjet institucioneve dhe komunitetit, si dhe sigurimin e aksesit gjithëpërfshirës në informacion për të gjitha grupet e popullsisë, veçanërisht për grupet e cenueshme.
- Ngritja e kapaciteteve të menaxhimit të riskut nga fatkeqësitë, trajnimi dhe stërvitjet e vazhdueshme për t'u përballur me skenarët më të mundshëm të emergjencave në nivel Qarku.
- Lokalizimi, përgjigja dhe përgatitja janë një tjetër komponent i fazës së Gatishmërisë që lidhet me përgatitjen e kapaciteteve, testimin e gatishmërisë së tyre.
- Vlerësimi i riskut i kryer paraprakisht është një prej dokumenteve bazë të identifikimit të kërcënimeve dhe të shkallës së tyre.
- Vazhdimësia e shërbimeve lidhet me nevojën që të gjitha bizneset në territorin e qarkut dhe shërbimet e institucioneve shtetërore dhe aktorëve të tjerë jo-shtetërorë, të ruajnë vijimësinë e tyre në mënyrë sa më praktike dhe të sigurt të jetë e mundur.
- Partneritetet: fuqizimi i bashkëpunimit midis të gjithë aktorëve përgjegjës për emergjencat civile si dhe rritja e bashkëpunimit me grupet vullnetare dhe komunitetet vendore në përgjithësi.

**Figura 7**: Buletini ditor nga IGJEO mbi parashikimin e rrezikut hidro-meteorologjik

| Niveli i Rrezikut | Rrjeshje shiu (mm / 24 orë) |
|---|---|
| S'ka rrezik | të dobëta (0-15 mm / 24 orë)<br>Nuk priten fenomene hidro-meteorologjike problematike. |
| I ulët | mesatare (15-45 mm / 24 orë)<br>Mundësi që të shfaqen fenomene hidro-meteorologjike problematike. |
| I moderuar | intensive (45-90 mm / 24 orë)<br>Moti parashikohet i rrezikshëm.<br>Parashikohen fenomene të pazakonta hidro-meteorologjike |
| I lartë | shumë intensive ( >90 mm / 24 orë)<br>Moti është i rrezikshëm. Parashikohen fenomene të pazakonta hidro-meteorologjike mjaft intensive. |

Legjenda: Reshjet 24-oreshe

**Figura 8:** Rreziku i zjarreve në pyje - Buletini ditor i IGJEO

| | |
|---|---|
| **S'ka rrezik** | Zjarret e mundshëm janë ët kontrollueshëm lehtësisht. |
| **I ulët** | Barërat e thatë dhe pyjet mund të digjen lehtë. Flakët janë të mesme në pyje dhe të shpejta në zonat e ekspozuara. |
| **I moderuar** | Ndezja e zjarreve mund të ndodhë lehtë dhe me përhapje të shpejtë. Zjarret mund të jenë shumë të nxehtë, me kurora përhapje të vogla dhe të mesme. |
| **I lartë** | Ndezja mund të shkaktohet edhe nga një shkëndijë. Zjarret janë shumë të nxehtë me përhapje shumë të shpejtë të flakëve si rrjedhim kontrolli i tyre është shumë i vështirë. |

Legjenda: Zjarre në pyje

Në nivel qarku, roli më i rëndësishëm i Institucionit të Prefektit të qarkut është shpërndarja e sinjalizimeve meteorologjike. Pas një alarmi meteorologjik Institucioni i Prefektit të qarkut:

- Komunikon alarmin meteorologjik tek organet e vetëqeverisjes vendore, strukturat operacionale, administrative dhe vullnetare;
- Aktivizohet informacioni paraprak për bashkitë e prekura në lidhje me alarmin dhe skenarët e tij. Ofrohen këshilla për rregullat e vetëmbrojtjes dhe kanalet zyrtare të informacionit;
- Kontrollon gatishmërinë e shërbimeve teknike të Qarkut dhe të bashkive që pritet të preken nga situata emergjente, për të garantuar aktivizimin e menjëhershëm të tyre në rastin e emergjencës;
- Kontrollon disponueshmërinë e grupeve/skuadrave vullnetare vendore;
- Verifikon disponueshmërinë e burimeve shtesë (publike ose private) të pranishme në territor;
- Verifikon nevojën për aktivizimin e QOECQ;
- Verifikon kushtet specifike të cënueshmërisë të strukturave kritike ose përkohshme (p.sh. ngjarje ose punime) dhe aktivizon masat parandaluese të sigurisë ose bllokimin e zonave me risk të lartë;
- Verifikon funksionimin e sistemeve teknologjike e lidhjeve telefonike dhe rrjetit të QOECQ;
- Ndjek zhvillimin e emergjencës, për të aktivizuar të gjitha resurset që në fazat fillestare të emergjencës;
- Informon QKOEC për çdo veprim operacional të ndërmarrë;

Mjetet që do të përdoren për të shpërndarë sinjalizimet janë si më poshtë:

- Televizioni dhe media e shkruar
- Buletinet radiofonike
- Mesazhe zanore nga ndërtesat fetare (kisha, xhami, etj.)
- Media sociale
- SMS dhe e-mail celular
- Njoftimet e komunitetit
- Njoftimet përmes automjeteve nga policia/Forcat e Armatosura/Kryqi i Kuq

- Ekrane publike dhe tabela
- Sinjalet tymuese ose fluturuese.

## 5.4 / Qendrat e koordinimit dhe zonat e paracaktuara për evakuim dhe përdorimi i tyre për aktivitete në funksion të përgjigjes në raste të emergjencave civile

*Në rastet e shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore* në territorin e një Qarku, aktivizohet menjëherë QOECQ. Prefekti emëron një Koordinator të QOECQ dhe personelin me përgjegjësi ditore të menaxhimit të situatës. Ai cakton me urdhër DOQ që është përgjegjës për menaxhimin e situatës së fatkeqësisë në territorin e Qarkut.

*Në rastet kur nuk është shpallur gjendja e fatkeqësisë natyrore*, vendimi për aktivizimin e QOECQ merret nga Prefekti në bashkërendim me AKMC-në, bazuar në shkallën e fatkeqësisë së pritshme dhe në kapacitetet e disponueshme. Kjo qendër është përgjegjëse për koordinimin e burimeve dhe asistencën për popullatën si dhe për koordinimin me QOECB-të kur ato janë ngritur. Në varësi të situatës, në QOECQ mund të atashohen përfaqësues të institucioneve të përfshira në menaxhimin e situatës.

Për të zgjedhur një vendndodhje të përshtatshme të ambientit të një qendre operacionale të emergjencës për EC në nivel Qarku, është e nevojshme të merren në konsideratë jo vetëm elementët strukturore të godinës, por edhe karakteristikat gjeomorfologjike përreth, përshtatshmërinë nga pikëpamja hidrogjeologjike, ndikimin e kushteve lokale në përforcimin e lëkundjeve sizmike në rast tërmeti, kushtet e rrezikshmërisë nga rrëshqitjet/qëndrueshmëria e shpatit, lëngëzimi i tokës dhe risku hidraulik, si dhe elementët që burojnë nga risqet e shkaktuara nga njeriu.

Qendra Operacionale e Emergjencave Civile të Qarkut Fier ndodhet në katin e dytë të godinës së Institucionit të Prefektit Fier, Salla e Mbledhjeve të Prefekturës. Qendra shërben si vend ku mblidhen gjithë aktorët përkatës në raste emergjencash. Në QOECQ marrin pjesë aktorë të ndryshëm sipas detyrave të tyre përkatëse siç janë: si përfaqësues të rendit publik, shëndetësisë, të FA, arsimit, etj.

### Zonat e emergjencës dhe kriteret për identifikimin e tyre

Zonat e emergjencës janë vendndodhje të identifikuara paraprakisht si të përshtatshme për aktivitetet e MC në raste emergjencash ose fatkeqësish. Ato identifikohen paraprakisht në PQEC në bazë të idenfikimit të kryer në nivel bashkie. Në kuadër të kompetencave të tyre, autoritetet vendore identifikojnë:

- Zonat dhe qendrat e ndihmës për popullsinë (vendet e pritjes, akomodimit dhe të strehimit të popullsisë së evakuuar ose të shpërngulur nga banesat e tyre për shkak të emergjencës), të cilat mund të jenë terrene të hapura në të cilat ngrihen strukturat për ndihmën e popullsisë së prekur nga një ngjarje emergjente ose të mbyllura (Palestra shkollash, pallate sporti, hotele).

- Zonat për grumbullimin e personelit që merret me shpëtimin e popullsisë, materialeve pajisjeve, mjeteve, automjeteve të tyre, në të cilat të kanalizohen personeli që merret me shpëtimin, burimet dhe automjetet e nevojshme për shpëtimin e popullsisë.
- Pikat e hyrjes për burimet (personel, pajisje, mjete, automjete), në të cilat të priten dhe regjistrohen kolonat e shpëtimit, që vijnë nga zona të jashtme, duke lejuar më pas kalimin e tyre drejt zonës së prekur.
- Zonat e uljes emergjente, të nevojshme për të arritur pjesë të territorit që janë të vështira për të arritur dhe në të cilat planifikohet ulja e mjeteve ajrore.

Zonat e emergjencës duhet të vendosen në vende që nuk janë subjekt rreziku, duke shmangur për shembull zonat e përmbytjeve, zonat pranë shpateve të paqëndrueshme, shembjet e strukturave ngjitur, në rrezik zjarresh në pyje. Të gjitha zonat duhet të jenë lehtësisht të aksesueshme edhe nga automjete të mëdha. Numri i zonave që përzgjidhen varet nga disponueshmëria në territor, numri i banorëve dhe shtrirja e bashkisë.

**Zonat e Pritjes**

Janë zonat ku në momentet menjëherë pas fatkeqësisë, do të grumbullohen njerëzit të cilët janë larguar nga banesat e tyre pas ngjarjes ose pas dhënies së urdhërit për tu evakuuar nga zona kur ka ndodhur fatkeqësia në të cilat garantohet ndihma e parë për popullatën, në pritje të përgatitjes së vendeve të strehimit ose kthimit në kushte normale të jetesës. Këto zona duhen të jenë të sigurta. Zonat e pritjes do të përdoren për një periudhë kohore nga disa orë në disa ditë.

**Zonat e ndihmës ose qendrat e akomodimit/strehimit të popullsisë**

Këto hapësira i dedikohen menaxhimit të popullsisë për periudha që variojnë nga disa javë deri në disa muaj. Zona të ndihmës për popullsinë janë zonat me një minimum zhvillimi urban dhe infrastrukture (ujë, kanalizim, energji elektrike) në të cilat është e mundur ngritja e një kampi të përkohshëm strehimi. Për një kamp të përkohshëm strehimi tendash me 250 shtretër nevojiten përafërsisht 6000 m2. Qendra e akomodimit/strehimit të popullsisë konsiderohen strukturat ekzistuese publike ose private që përmbushin nevojat për strehim të popullsisë (hotele, qendra sportive, objekte ushtarake, shkolla, kampingje etj.). Preferohet që zonat dhe qendrat e asistencës të kenë afër hapësira të lira të përshtatshme për një zgjerim të mundshëm dhe për të siguruar ruajtjen e materialeve mbështetëse të aktivitetit të tyre.

**Zonat për grumbullimin e personelit që merret me shpëtimin e popullsisë, materialeve pajisjeve, mjeteve, automjeteve të tyre.**

Zonat e grumbullimit të burimeve emergjente dhe ekipeve të shpëtimit janë zonat ku dislokohen/magazinohen burimet dhe forcat operacionale për të mbështetur autoritetin lokal në operacionet e shpëtimit. Këto zona duhet të jenë veçanërisht të mëdha (minimumi 6000 m2) dhe të kenë një karrexhatë sepse duhet të lejojnë parkimin e shumë kamionëve dhe trajtimin e mallrave me anë të pajisjeve ngritëse.

**Zonat e uljes emergjente**

Zona të përshtatshme për ulje emergjente të helikopterëve. Këto zona duhet të kenë karakteristikat e mëposhtme:

- Sipërfaqe pa pengesa (tokë dhe ajër), e sheshtë, me përmasa minimale 40m x 40m;
- Mbulesë e qëndrueshme, si bar kompakt ose asfalto/betoni;
- Pa pengesa ajrore në afërsi (p.sh. pemë të larta, shtylla elektrike, kulla, ndërtesa mbi 2 kate, kambanore ose struktura të tjera të larta);
- Lidhje të drejtpërdrejta me rrjetin rrugor për akses të shpejtë në qendrat e koordinimit dhe objektet kritike.

## 5.5 / Strukturat dhe institucionet përgjegjëse për Gatishmërinë në nivel qarku

**Tabela 2:** Strukturat dhe përgjegjësitë e tyre në fazën e gatishmërisë – Qarku Fier

| Institucionet dhe palët e përfshira | Përgjegjësitë kryesore në fazën e Gatishmërisë |
|---|---|
| | **Institucione dhe struktura në nivel bashkie** |
| **Prefekti i Qarkut Fier**<br>Sektori i Planifikimit, Përballimit të Emergjencave Civile dhe Krizave/KMCQ | **Planifikimi dhe Koordinimi:**<br>• Hartimi dhe përditësimi i Planit për Emergjencat Civile në Qark, duke siguruar koordinimin me planet e bashkive.<br>• Mbështetja e bashkive në përgatitjen dhe përditësimin e planeve për Emergjencat Civile dhe vlerësimit të riskut për territorin e tyre.<br>• Koordinimi me institucionet shtetërore dhe me ato joqeveritare për garantimin e gatishmërisë operacionale.<br>• Hartimi dhe nënshkrimi i marrëveshjeve ndërisntitucionale për shkëmbimin e burimeve, ekspertizës, dhe kapaciteteve operacionale me qëllim garantimin e gatishmërisë gjatë emergjencave.<br>**Monitorimi dhe Menaxhimi i Burimeve:**<br>• Mbajtja e një baze të dhënash të burimeve të disponueshme emergjente, të tilla si strehimoret, pajisjet dhe personeli i trajnuar.<br>• Sigurimi i funksionimit të sistemeve të monitorimit dhe paralajmërimit të hershëm për rreziqet në qark.<br>**Ndërgjegjësimi dhe Përgatitja Operacionale:**<br>• Zhvillimi i fushatave informuese për publikun mbi rreziqet kryesore, rrugët e evakuimit dhe vendstrehimet e sigurta.<br>• Sigurimi i aksesit të popullatës në informacion të qartë dhe të përditësuar për gatishmërinë dhe reagimin ndaj fatkeqësive. |

| | |
|---|---|
| Sektori Juridik | • Verifikon ligjshmërinë e akteve ligjore që kanë lidhje me cështje të mbrojtjes civile të nxjerra nga njësitë e vetëqeverisjes vendore të cilat kanë lidhje me cështjet e gatishmërisë dhe cështje të tjera sipas rastit.<br>• Jep asistencë Sektorit të Planifikimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile dhe Krizave pranë Administratës së Prefektit për interpretim të ndryshëm ligjor dhe për hartimin e akteve të ndryshme ligjore që kanë lidhje me gatishmërinë. |
| Sektori i Monitorimit të Kompetencave Vendore dhe Funksioneve té Deleguara | • Ndihmon organet e vetëqeverisjes vendore për njohjen dhe ushtrimin e funksioneve të tyre në fushën e mbrojtjes civile për cështjet e gatishmërisë.<br>• Informon Prefektin e qarkut lidhur me problemet e organeve të njësive të vetëqeverisjes vendore që i shqetesojnë në fushën e emergjencave civile.<br>• Ndjek problemet e sigurisë në plazhe, e në zona të tjera turistike, higjenën, problemet shëndetësore, të emergjencave civile etj., |
| Sektori i Zhvillimit Urban | • Monitoron njësitë e vetëqeverisjes vendore lidhur me zbatimin e masave që marrin për mbrojtjen e mjedisit.<br>• Përgatit raporte dhe informacione në mënyrë të vazhdueshme në lidhje me mbledhjen dhe largimin e mbetjeve shtëpiake dhe të ngurta, si pasojë e të cilave mund të shkaktohen situata emergjente<br>• Mbledh informacione në lidhje me problematikat e rrugëve rurale dhe urbane në nivel qarku dhe sipas rastit informon prefektin. |
| Sektori i Financës dhe i Shërbimeve Mbështetëse | • Verifikon nëse bashkitë kanë planifikuar fondet buxhetore për marrjen e masave për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, sipas parashikimeve ligjore dhe informon Prefektin e qarkut. |
| Inspektoriati Rajonal Shtetëror Shëndetësor Fier | • Kryen inspektimet në fushën e kompetencës së ministrisë përgjegjëse në fushën e shëndetësisë |
| Njesia Vendore e Kujdesit Shendetsor | **Vlerësimi i Riskut**: Harton dokumentin e vlerësimit të riskut nga fatkeqësitë, për institucionet shëndetësore dhe përditëson atë sipas nevojave.<br>**Parandalimi i Ndikimeve Shëndetësore:**<br>• Siguron masa parandaluese për reduktimin e rrezikut ndaj ndërprerjeve të shërbimeve mjekësore.<br>• Vendos protokolle për identifikimin dhe trajtimin e rreziqeve që ndikojnë në shëndetin publik, si përhapja e sëmundjeve ngjitëse.<br>• Kualifikimi i Personelit: Organizimi i trajnimeve për personelin mjekësor për menaxhimin e situatave emergjente.<br>• Ndërgjegjësimi i Komunitetit: Bashkëpunon me autoritetet vendore për ndërgjegjësimin e komunitetit mbi masat parandaluese për fatkeqësitë shëndetësore. |

| | |
|---|---|
| Shërbimi i Urgjencës Mjekësore | • **Planifikimi dhe Koordinimi:** Përgatitjen e planeve të gatishmërisë emergjente që përputhen me udhëzimet shëndetësore. Koordinime me shërbime të tjera vendore, si zjarrfikësit dhe strukturat e policisë.<br>• **Mbikëqyrja dhe Monitorimi:** Monitorimi i kërcënimeve shëndetësore dhe shpërthimeve në komunitet të sëmundjeve dhe gjurmimi i të dhënave për të parashikuar emergjencat e mundshme.<br>• **Trajnime dhe stërvitje:** Kryerja e trajnimeve dhe ushtrimeve simuluese për stafin shëndetësor dhe reaguesit e urgjencës për të siguruar gatishmëri.<br>• **Edukimi i Shëndetit Publik:** Edukimi i publikut për gatishmërinë për emergjenca, duke ofruar informacion në lidhje me parandalimin e sëmundjeve, ndihmën e parë dhe çfarë duhet bëjnë gjatë një emergjence.<br>• **Kujdesi dhe trajtimi i menjëhershëm:** Ofrimi nga Qendrat shëndetësore/ambulancat kujdes të menjëhershëm mjekësor gjatë një emergjence, duke përfshirë klasifikimin, trajtimin dhe stabilizimin e pacientëve.<br>• **Mbikëqyrja shëndetësore:** Monitorimi dhe raportimi për kërcënimet shëndetësore në zhvillim dhe ofrimi i paralajmërimit të hershëm për autoritetet vendore shëndetësore.<br>• **Angazhimi i komunitetit:** Përmes programeve informuese, duke edukuar njerëzit rreth praktikave parandaluese shëndetësore dhe çfarë duhet të bëjnë në rast emergjence. |
| Spitalet rajonale dhe bashkiake | • Trajnimi i vazhdueshëm i stafit mjekësor dhe ndihmës për menaxhimin e situatave emergjente dhe fluksit të lartë të pacientëve.<br>• Formimi dhe përgatitja e ekipeve emergjente shëndetësore për reagim të menjëhershëm në situata emergjente.<br>• Sigurimi dhe rishikimi i rezervave farmaceutike dhe pajisjeve shtesë për gatishmërinë ndaj situatave emergjente masive.<br>• Mirëmbajtja dhe monitorimi i bankave të gjakut për gatishmëri në raste urgjente<br>• Hartimi dhe përditësimi i planit të gatishmërisë spitalore, për menaxhimin e fluksit të pacientëve përtej kapaciteteve të zakonshme.<br>• Sigurimi dhe mirëmbajtja e flotës së mjaftueshme të autoambulancave dhe mjeteve të transportit për gatishmërinë ndaj emergjencave.<br>• Përdorimi strategjik i personelit dhe pajisjeve të përshtatshme në çdo njësi që ofron shërbimin e urgjencës mjekësore për të garantuar transportin e shpejtë dhe efektiv të pacientëve.<br>• Përmirësimi i vazhdueshëm i kapaciteteve të infrastrukturës për të mbështetur operacionet e emergjencës. |
| Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror | • **Hartimi i planeve të gatishmërisë për emergjencat civile –** Identifikon nevojat dhe burimet e domosdoshme për të siguruar ndihmë sociale në rast emergjence, duke përfshirë ndihmën ekonomike dhe përkujdesjen për grupet e cenueshme. |

| | |
|---|---|
| | • **Trajnimi i personelit dhe koordinimi institucional –** Ofron trajnime për stafin dhe punonjësit socialë mbi procedurat e reagimit dhe mbështetjen sociale në raste emergjencash, si dhe bashkërendon me institucionet dhe OJQ-të për zbatimin e masave të gatishmërisë.<br>• **Identifikimi dhe Regjistrimi i Grupeve të cenueshme–** Vlerëson dhe përditëson listat e individëve që mund të preken më rëndë nga fatkeqësitë (persona me aftësi të kufizuara, të moshuar, familje në varfëri ekstreme), duke garantuar që ata të përfitojnë mbështetje prioritare.<br>• **Përmirësimi i komunikimit me komunitetin –** Zhvillon strategji dhe fushata informimi për edukimin e qytetarëve mbi masat mbrojtëse dhe mënyrat e marrjes së ndihmës sociale gjatë emergjencave.<br>• **Sigurimi i burimeve për ndihmë sociale –** Përgatit dhe ruan stoqet e ndihmave të emergjencës (ushqim, strehim të përkohshëm, shërbime psiko-sociale) për t'u shpërndarë shpejt gjatë emergjencave. |
| Përfaqësues të FA në nivel qarku (Regjimenti i Këmbësorisë së Jugut, Reparti Ushtarak i Poshnjes) | • Ka përgjegjësinë e shpërndarjes së gatishmërisë në Forcat e Ushtrisë dhe aktivizimin e strukturave në lidhje me fazat.<br>• Mbështetja e bashkive në identifikimin dhe vlerësimin e risqeve specifike të zonës.<br>• Organizon ushtrime të vendosjes së shpejtë gjatë emergjencave.<br>• Zhvillon plane logjistike për përgjigjen ndaj fatkeqësive, të tilla si transporti i furnizimeve.<br>• Përgatit pajisjet ushtarake, transportin dhe spitalet në terren për mbështetje emergjente.<br>• Koordinon me autoritetet vendore dhe shërbimet e mbrojtjes civile për planifikimin dhe zbatimin e përbashkët të gatishmërisë emergjente.<br>• Siguron trajnime për stafin, reaguesit e parë dhe komunitetin mbi gatishmërinë për emergjencat. |
| Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare Durrës | **Planifikimi dhe Monitorimi**<br>• Hartimi dhe përditësimi i planeve të gatishmërisë për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore në rast fatkeqësish.<br>• Monitorimi i aseteve kulturore për identifikimin e rreziqeve dhe nevojave për ndërhyrje parandaluese.<br>**Forcimi i Kapaciteteve**<br>• Përmirësimi i kapaciteteve njerëzore dhe përmirësimi i mjeteve të mbrojtjes së aseteve kulturore.<br>• Organizimi i trajnimeve për stafin dhe vullnetarët mbi masat e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore në situata emergjente.<br>**Ndërgjegjësimi dhe Sensibilizimi**<br>• Zhvillimi i fushatave sensibilizuese për komunitetin, pronarët dhe administratorët e aseteve kulturore mbi masat parandaluese dhe gatishmërinë ndaj rreziqeve.<br>• Bashkëpunimi me institucione vendore dhe ndërkombëtare për shkëmbimin e praktikave të mira në ruajtjen e aseteve kulturore në situata emergjente. |

| | |
|---|---|
| Operatori i Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike Fier OST | **Monitorimi dhe Sigurimi i Infrastrukturës Kritike**<br>• Vendos dhe operon sisteme të avancuara monitorimi për të gjurmuar funksionalitetin e rrjetit të transmetimit të energjisë.<br>• Identifikon dhe zbaton masa mbrojtëse për nënstacionet kritike, transformatorët dhe linjat e transmetimit.<br>**Planifikimi dhe Testimi i Gatishmërisë**<br>• Planifikon dhe teston skenarët e furnizimit të vazhdueshëm me energji për shërbimet kritike gjatë emergjencave.<br>• Zhvillon masa parandaluese për të reduktuar ndërprerjet e furnizimit me energji në situata të jashtëzakonshme. |
| Drejtoria Rajonale e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE) në qark/bashki | **Monitorimi dhe Menaxhimi i Riskut**<br>• Vendos sisteme të avancuara monitorimi për të gjurmuar funksionalitetin e rrjeteve të shpërndarjes dhe për të identifikuar ndërprerjet e mundshme.<br>• Inspekton dhe mirëmban nënstacionet, transformatorët dhe linjat e e shpërndarjes për të parandaluar defektet në rrjet.<br>• Analizon ngarkesat në rrjet për të shmangur mbingarkesat dhe kolapsin e sistemit të shpërndarjes.<br>**Planifikimi dhe Sigurimi i Furnizimit**<br>• Planifikon dhe teston skenarët e furnizimit të vazhdueshëm me energji për infrastrukturën kritike dhe publike si spitalet dhe impiantet e ujit.<br>• Siguron zgjidhje alternative, si furnizimi me gjeneratorë rezervë, për objektet kritike në raste të emergjencave.<br>• Harton dhe përditëson planet e gatishmërisë për ndërprerjet e energjisë, duke përfshirë strategjitë e riparimit të shpejtë.<br>**Koordinimi dhe Komunikimi**<br>• Bashkëpunon me bashkitë dhe institucionet për të garantuar gatishmërinë ndaj emergjencave energjetike.<br>• Krijon një mekanizëm efektiv komunikimi për të informuar autoritetet dhe konsumatorët për ndërprerjet e planifikuara ose situatat emergjente. |
| Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Fier | **Sigurimi i Funksionalitetit të Infrastrukturës:**<br>• Monitorimi i vazhdueshëm dhe mirëmbajtja e rrjetit të ujitjes dhe kullimit për të garantuar gatishmërinë teknike.<br>• Identifikimi i pikave kritike të rrjetit dhe përgatitja e masave për ndërhyrje të shpejta.<br>**Përgatitja e Burimeve Njerëzore dhe Teknike:**<br>• Sigurimi i gatishmërisë së menaxherëve dhe specialistëve të jenë në gatishmëri dhe të përgatitur për të vepruar shpejt gjatë situatave emergjente.<br>• Organizimi i trajnimeve për stafin mbi procedurat teknike dhe riparimet emergjente për të garantuar gatishmërinë teknike të infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit. |

| | |
|---|---|
| | **Planifikimi dhe Koordinimi:**<br>• Hartimi dhe përditësimi i planeve të gatishmërisë për menaxhimin e ujit duke u fokusuar në masat ndërhyrjet e menjëhershme dhe sigurinë e infrastrukturës.<br>• Bashkëpunimi me bashkitë dhe institucionet përgjegjëse për koordinimin e masave parandaluese dhe emergjente. |
| Drejtoria Rajonale e Arsimit Para-Universitar Fier | • **Mbështetja e institucioneve arsimore** në hartimin dhe përditësimin e **planeve të gatishmërisë** dhe protokolleve të evakuimit, duke siguruar që ato të jenë në përputhje me planin vendor të emergjencave civile.<br>• **Koordinimi me institucionet përgjegjëse** për zbatimin e masave të sigurisë dhe gatishmërisë në institucionet arsimore.<br>• **Ndërgjegjësimi i nxënësve dhe stafit arsimor** për masat parandaluese dhe sjelljen e duhur gjatë situatave emergjente, në përputhje me udhëzimet e institucioneve përgjegjëse.<br>• **Monitorimi i kapaciteteve të institucioneve arsimore** për përballimin e situatave emergjente dhe raportimi i problematikave tek autoritetet përkatëse.<br>• **Mbështetja për organizimin e simulimeve dhe ushtrimeve praktike**, duke siguruar që shkollat të bashkëpunojnë me autoritetet lokale për zbatimin e protokolleve të sigurisë.<br>• **Sigurimi i funksionimit të shërbimeve psikosociale** për të ofruar mbështetje emocionale për nxënësit dhe personelin në rast të situatave të jashtëzakonshme.<br>• **Koordinimi me njësitë e vetëqeverisjes vendore** për sigurimin e infrastrukturës së përshtatshme dhe mirëmbajtjen e objekteve arsimore për të garantuar sigurinë e tyre. |
| Drejtoria Rajonale e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, Fier | **Monitorimi i rreziqeve për sigurinë ushqimore**<br>• Mbledh dhe analizon të dhëna mbi fatkeqësitë natyrore, aksidentet industriale dhe shpërthimet e sëmundjeve që mund të ndikojnë në sigurinë ushqimore.<br>• Siguron informacion mbi situatën e furnizimit me produkte ushqimore në treg.<br>**Mbikëqyrja e operatorëve ushqimorë për përgatitjen ndaj emergjencave**<br>• Siguron që operatorët e biznesit ushqimor zbatojnë masa parandaluese për ruajtjen e standardeve të sigurisë në rast emergjencash.<br>• Jep udhëzime teknike për ruajtjen e ushqimeve dhe zvogëlimin e humbjeve në situata emergjente.<br>**Koordinimi përgatitor për emergjencat ushqimore**<br>• Merr pjesë në planet e gatishmërisë me institucionet përgjegjëse për menaxhimin e emergjencave.<br>• Bashkëpunon me shëndetin publik dhe qeverisjen vendore për të siguruar një përgjigje të shpejtë dhe të organizuar. |

| | |
|---|---|
| | Inspektimi i pikave të kontrollit kufitar<br>• Zbaton protokolle të rrepta kontrolli për të parandaluar hyrjen e ushqimeve të pasigurta në situata emergjente.<br>**Mbështetja e mekanizmave të paralajmërimit të hershëm**<br>• Monitoron dhe raporton për ndotjet ushqimore dhe faktorët që mund të sinjalizojnë rreziqe.<br>**Sigurimi i zinxhirit të furnizimit**<br>• Raporton për gjendjen e furnizimit me ushqime, duke garantuar që produktet bazë mbeten të disponueshme në treg edhe gjatë krizave. |
| Përfaqësues të kompanive të telekomunikacionit (Vodafone & One) | **Planifikimi dhe Përditësimi i Sistemeve të Komunikimi**t<br>• Zhvillimi, testimi dhe përditësimi i planeve të gatishmërisë për komunikimet për rastet e emergjencave.<br>• Vendosja e linjave prioritare të komunikimit për autoritetet dhe shërbimet e emergjencës.<br>**Sigurimi i Mbështetjes Teknike dhe Operacionale**<br>• Ofrimi i mbështetjes teknike për institucionet vendore dhe shërbimet e emergjencës për të garantuar funksionimin e rrjetit gjatë emergjencave.<br>• Trajnimi i stafit mbi protokollet emergjente për menaxhimin dhe mirëmbajtjen e rrjetit në emergjenca.<br>**Komunikimi dhe Informimi i Përdoruesve**<br>• Sigurimi i udhëzimeve dhe informacioneve të menjëhershme për përdoruesit mbi përdorimin e shërbimeve të komunikimit emergjent. |
| Zyra e Administrimit të Basenit Ujor Shkumbin - Seman | • **Monitorimi i vazhdueshëm i burimeve ujore:** Mbledh dhe analizon të dhëna mbi sasinë dhe cilësinë e ujërave për të identifikuar sinjalet e hershme të krizave ujore (p.sh., ndotje, thatësira ose përmbytje të mundshme).<br>• **Identifikimi dhe raportimi i kërcënimeve ndaj burimeve ujore:** Vlerëson dhe dokumenton rreziqet që lidhen me ndotjen, abuzimin ose keqmenaxhimin e burimeve ujore dhe njofton autoritetet për marrjen e masave të nevojshme.<br>• **Monitorimi i përputhshmërisë me kushtet e lejeve dhe autorizimeve:** Inspekton në terren përdorimin e burimeve ujore për të siguruar që operatorët e ujit të zbatojnë kërkesat ligjore dhe të mos cënojnë sigurinë e furnizimit.<br>• **Koordinimi për gatishmërinë ndaj krizave ujore:** Bashkëpunon me institucionet përkatëse (autoritetet lokale, Këshillin e Basenit Lumor, prefekturat) për të harmonizuar masat parandaluese dhe për të përmirësuar mekanizmat e reagimit ndaj emergjencave ujore.<br>• **Sigurimi i informacionit për publikun mbi masat mbrojtëse të ujit:** Përhap informacion mbi përdorimin e qëndrueshëm të ujërave dhe masat mbrojtëse në rast të përkeqësimit të cilësisë ose sasisë së ujit. |

| | |
|---|---|
| ARRSH Gjirokastër për Rajonin Jugor (Gjirokastër) | • Monitorimi i gjendjes së rrugëve në lidhje me risqet emergjente: Inspekton dhe dokumenton situatën e infrastrukturës rrugore për të identifikuar dëmtime ose rreziqe që mund të përkeqësohen gjatë fatkeqësive natyrore (p.sh., përmbytje, rrëshqitje dhe dëmtim i urave).<br>• Vlerësimi i ndikimeve të motit ekstrem: Analizon ndikimin e kushteve të motit (reshjet e dendura, ngricat) në rrjetin rrugor dhe harton plane masash për të siguruar kalueshmërinë.<br>• Koordinimi për ndërhyrjet emergjente në rrugë: Punon me Prefekturën dhe Policinë e Shtetit për ngritjen e shtabeve të emergjencave, sidomos gjatë dimrit ose krizave të tjera që mund të ndikojnë në infrastrukturën rrugore.<br>• Sigurimi i komunikimit të qartë mbi situatat emergjente: Bashkëpunon me strukturat vendore për të dhënë udhëzime për qytetarët dhe drejtuesit e mjeteve mbi gjendjen e rrugëve dhe rreziqet e mundshme.<br>• Mbështetja e përpjekjeve për zhbllokimin e rrugëve: Ndihmon në planifikimin dhe koordinimin e hapjes së akseve të bllokuara nga reshjet e dendura ose rrëshqitjet e dheut.<br>• Testimi dhe përmirësimi i planeve të reagimit: Merr pjesë në stërvitje dhe simulime për reagimin ndaj emergjencave rrugore, në bashkëpunim me njësitë e emergjencave civile dhe institucionet përkatëse. |
| IKMT Fier | **Monitorimi dhe mbikëqyrja e territorit për situata emergjente**<br>• Identifikon dhe raporton në kohë reale shkeljet që mund të përkeqësojnë situatat emergjente, si ndërtimet e paligjshme, ndërhyrjet në mjedis dhe ndotja e ujërave.<br>• Kryen inspektime të shtuara në zonat e rrezikuara për ndërtimet që mund të shkaktojnë rrëshqitje dhe përmbytje.<br>**Vlerësimi dhe raportimi i risqeve mjedisore**<br>• Analizon dhe vlerëson ndikimin e ndotjeve industriale dhe degradimit të territorit në përkeqësimin e fatkeqësive natyrore.<br>• Raporton në mënyrë të vazhdueshme tek autoritetet për çdo ndryshim në territor që mund të ndikojë në sigurinë publike.<br>**Koordinimi me institucionet e emergjencave**<br>• Bashkëpunon me prefekturat, bashkitë dhe institucionet e tjera për të hartuar skenarë për reagimin ndaj emergjencave.<br>• Pjesëmarrja në mbledhjet e shtabeve të emergjencave për të dhënë informacion mbi gjendjen e territorit dhe ndërtimet problematike.<br>**Përcaktimi i procedurave për ndërhyrje të shpejta**<br>• Harton dhe zbaton plane veprimi për kontrollin e ndotjes dhe dëmtimit të territorit në raste të motit ekstrem.<br>• Siguron që planet e ndërhyrjes për zbatimin e masave mbrojtëse ndaj rrëshqitjeve, përmbytjeve dhe ndotjeve të jenë të azhurnuara dhe të testuara. |

| | |
|---|---|
| | **Inspektimi i pikave të rrezikut mjedisor dhe ndërtimor**<br>• Kontrollon subjektet me ndikim të lartë mjedisor (industria, guroret, landfill-et) për të minimizuar rrezikun e ndotjes së ujërave dhe ajrit në situata emergjente.<br>• Vlerëson gjendjen e ndërtimeve në zonat me rrezik të lartë për t'u siguruar që nuk ka shembje të mundshme.<br>**Përfshirja në sistemin e paralajmërimit të hershëm**<br>• Monitoron dhe raporton në mënyrë të vazhdueshme mbi faktorët që mund të sinjalizojnë rreziqe për territorin dhe ndërtesat.<br>• Siguron bashkëpunimin me institucionet që operojnë sistemet e paralajmërimit për përmbytjet dhe rrëshqitjet e dheut.<br>**Ndërgjegjësimi dhe informimi për masat e sigurisë**<br>• Ofron udhëzime për qytetarët dhe bizneset mbi masat mbrojtëse që duhen marrë për të shmangur ndërtimet e rrezikshme dhe ndotjen e mjedisit.<br>• Bashkëpunon me autoritetet lokale për të shpërndarë informacione mbi zonat e rrezikshme dhe mënyrat e reagimit ndaj emergjencave. |
| Administrata e Zonave të Mbrojtura Pyjore qarku Fier | **Monitorimi dhe raportimi i gjendjes së ekosistemeve pyjore dhe zonave të mbrojtura**<br>• Kryen monitorime të vazhdueshme për identifikimin e rreziqeve, si përmbytjet, zjarret e pyjeve dhe ndotjet industriale që mund të prekin zonat e mbrojtura.<br>• Raporton në strukturat përkatëse mbi kërcënimet ndaj biodiversitetit dhe habitatit natyror gjatë periudhave të emergjencave mjedisore.<br>• Mbledh dhe analizon të dhëna mbi ndikimet e faktorëve natyrorë dhe njerëzorë në zonat e mbrojtura për të përmirësuar masat e gatishmërisë.<br>**Zhvillimi dhe zbatimi i planeve emergjente për mbrojtjen e zonave të mbrojtura**<br>• Harton dhe përditëson planet e gatishmërisë për zjarret pyjore, përmbytjet dhe ndotjen e burimeve ujore.<br>• Koordinon me institucionet përgjegjëse për reaksionin e shpejtë ndaj fatkeqësive mjedisore brenda zonave të mbrojtura.<br>• Propozon masa parandaluese për reduktimin e ndikimeve të fatkeqësive natyrore në biodiversitet.<br>• Bashkëpunimi dhe koordinimi me institucionet për një përgjigje efektive<br>• Punon me AKMC, bashkitë dhe institucionet mjedisore për të siguruar koordinimin e masave mbrojtëse.<br>• Pjesëmarrje në Komisionet e Mbrojtjes Civile për të dhënë informacion mbi zonat e mbrojtura të rrezikuara dhe masat për mbrojtjen e biodiversitetit. |

| | |
|---|---|
| | **Implementimi i sistemeve të paralajmërimit të hershëm për rreziqet mjedisore**<br>• Monitoron dhe raporton shenjat e hershme të ndotjes së ujërave dhe ajrit, si dhe ndryshimet klimatike që ndikojnë ekosistemet e mbrojtura<br>• Bashkëpunon me institucionet shkencore dhe qendrat e monitorimit për sinjalizimin e hershëm të zjarreve pyjore dhe përmbytjeve.<br>**Ndërgjegjësimi dhe edukimi i komuniteteve lokale**<br>• Informon dhe ndërgjegjëson komunitetet lokale mbi risqet për zonat e mbrojtura dhe masat mbrojtëse që mund të ndërmarrin<br>• Organizimi i trajnimeve për stafin dhe vullnetarët mbi gatishmërinë për emergjenca mjedisore dhe ruajtjen e burimeve natyrore. |
| Agjencia Rajonale Ekstensionit Bujqësor | **Monitorimi dhe vlerësimi i ndikimit të situatave emergjente në bujqësi**<br>• Kryen monitorim dhe mbledh të dhëna mbi ndikimin e fatkeqësive natyrore si përmbytjet, thatësirat, breshëri dhe sëmundjet e bimëve në sektorin bujqësor.<br>• Përpilon raporte të rregullta mbi ekspozimin e sektorit bujqësor ndaj risqeve dhe propozon masa për të përmirësuar gatishmërinë dhe mbrojtjen e fermerëve.<br>• Ofron rekomandime për përdorimin e metodave të qëndrueshme bujqësore që zvogëlojnë ndjeshmërinë ndaj ndryshimeve klimatike dhe fatkeqësive.<br>**Ndërgjegjësimi dhe këshillimi i fermerëve mbi risqet bujqësore dhe gatishmërinë**<br>• Informon dhe këshillon fermerët për rreziqet natyrore dhe ndikimin e tyre në prodhimin bujqësor.<br>• Udhëzon fermerët mbi praktikat e sigurta të ruajtjes së prodhimeve dhe masat parandaluese për të minimizuar dëmet nga faktorët e jashtëm të rrezikut.<br>• Siguron informacion për zbatimin e strategjive për gatishmërinë, duke ndihmuar fermerët të kenë rezerva ujore, mbrojtje ndaj dëmtuesve dhe sigurime bujqësore.<br>**Koordinimi për rritjen e gatishmërisë në sektorin bujqësor**<br>• Bashkëpunon me ministrinë përgjegjëse për bujqësinë, strukturat e emergjencave civile dhe njësitë vendore për menaxhimin e fatkeqësive që prekin sektorin bujqësor.<br>• Jep mbështetje teknike për identifikimin dhe zbatimin e masave të gatishmërisë që ndihmojnë në mbrojtjen e prodhimit bujqësor dhe të gjësë së gjallë.<br>• Siguron pjesëmarrjen e fermerëve në programet e gatishmërisë dhe i lidh ata me mekanizmat ekzistues të menaxhimit të risqeve në sektorin bujqësor. |

| | |
|---|---|
| | **Ofrimi i trajnimeve mbi gatishmërinë dhe menaxhimin e risqeve në bujqësi**<br>• Organizon trajnime për fermerët dhe specialistët bujqësorë mbi menaxhimin e thatësirave, përmbytjeve dhe sëmundjeve bujqësore.<br>• Zhvillon udhëzime teknike mbi mbrojtjen e kulturave bujqësore dhe përdorimin e metodave rezistente ndaj ndryshimeve klimatike.<br>• Siguron trajnime mbi sistemet e hershme të paralajmërimit dhe masat e gatishmërisë që fermerët mund të ndërmarrin për të reduktuar dëmet. |
| Drejtoria Rajonale e Veterinarisë dhe Mbrojtjes së bimëve Vlorë, Sektori Veterinar Qarku Fier | **Monitorimi dhe vlerësimi i risqeve për shëndetin e kafshëve dhe bimëve**<br>• Kryen monitorim të vazhdueshëm mbi shëndetin e kafshëve dhe bimëve, duke vlerësuar rreziqet për shpërthimin e sëmundjeve.<br>• Mbledh të dhëna mbi shpërthimet e mundshme të sëmundjeve infektive dhe ndikimet e tyre në shëndetin publik dhe sektorin bujqësor.<br>• Përgatit raporte periodike mbi situatat e rrezikut, të cilat dërgohen në Drejtorinë e Përgjithshme për koordinim të mëtejshëm.<br>**Planifikimi i masave parandaluese për sëmundjet e kafshëve dhe bimëve**<br>• Zhvillon dhe përditëson plane për parandalimin dhe menaxhimin e shpërthimeve epidemike, duke përfshirë protokollet për veprim në situata emergjente.<br>• Siguron që të gjitha strukturat veterinare dhe të mbrojtjes së bimëve janë të përgatitura për ndërhyrje, në përputhje me rregullat dhe standardet ligjore.<br>• Koordinon me Drejtorinë e Përgjithshme për planifikimin e nevojave për shërbimin veterinar dhe mbrojtjen e bimëve në territorin e mbuluar.<br>**Ndërgjegjësimi dhe trajnimi për parandalimin e sëmundjeve**<br>• Ofron udhëzime teknike për fermerët dhe operatorët bujqësorë mbi masat e gatishmërisë për sëmundjet e kafshëve dhe bimëve.<br>• Siguron trajnime për fermerët mbi praktikat e sigurta në menaxhimin e shëndetit të kafshëve dhe mbrojtjen e bimëve nga infeksionet.<br>• Promovon masa për sigurinë veterinare dhe fitosanitare, duke ofruar informacion mbi monitorimin e sëmundjeve dhe përdorimin e mjeteve parandaluese.<br>**Koordinimi dhe mbështetja institucionale për gatishmërinë**<br>• Bashkëpunon me institucionet vendore dhe qendrore për të siguruar një planifikim të unifikuar për menaxhimin e emergjencave që prekin shëndetin e kafshëve dhe bimëve.<br>• Koordinon me institucionet ndërkombëtare dhe partnerët e fushës për të përdorur praktikat më të mira në parandalimin e shpërthimeve epidemike.<br>• Siguron përputhshmërinë e ofrimit të shërbimeve veterinare dhe fitosanitare me standardet ligjore dhe rregulloret në fuqi. |

| | |
|---|---|
| Albpetrol | **Zhvillimi dhe testimi i planeve të emergjencave:** Përditëson dhe teston periodikisht planet e emergjencave për menaxhimin e situatave kritike, duke përfshirë aksidentet industriale, rrjedhjet e hidrokarbureve dhe shpërthimet.<br>**Sigurimi i kapaciteteve të nevojshme për ndërhyrje emergjente:** Garantimi i pajisjeve të duhura për menaxhimin e emergjencave dhe sigurimi që personeli ka akses në mjetet e nevojshme për ndërhyrje.<br>**Trajnimi i stafit për menaxhimin e emergjencave:** Organizimi i trajnimeve dhe simulimeve për skenarët e emergjencave për të përgatitur punonjësit mbi procedurat e evakuimit dhe sigurisë.<br>**Bashkëpunimi dhe koordinimi me institucionet shtetërore:** Pjesëmarrja në platforma koordinimi me agjencitë qeveritare dhe institucionet përgjegjëse për emergjencat, për të garantuar një përgjigje të unifikuar në rast krizash.<br>**Sistem paralajmërimi të hershëm për rreziqet operacionale:** Implementimi i mekanizmave të paralajmërimit të hershëm për të njoftuar autoritetet dhe komunitetin në rast të një rreziku të identifikuar nga operacionet e Albpetrol.<br>**Përditësimi i protokolleve dhe procedurave operacionale për emergjenca:** Sigurimi që të gjitha protokollet e gatishmërisë janë të përditësuara dhe të harmonizuara me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të sigurisë në sektorin e hidrokarbureve. |
| Dega e Doganës Fier | • **Hartimi dhe përditësimi i procedurave për situata emergjente** – Sigurimi që strukturat doganore kanë udhëzime të qarta për menaxhimin e emergjencave dhe që personeli është i informuar për to.<br>• **Inspektimi dhe mirëmbajtja e infrastrukturës doganore** – Kryerja e kontrolleve të rregullta në terminale, hapësirat e magazinimit dhe pikat hyrëse për të garantuar që ato janë të përshtatshme për të përballuar një situatë emergjente.<br>• **Sigurimi i trajnimeve për personelin** – Organizimi i trajnimeve periodike për stafin doganor mbi procedurat e gatishmërisë për emergjenca, përfshirë sigurinë dhe menaxhimin e krizave.<br>• **Bashkëpunimi paraprak me institucionet e sigurisë dhe emergjencave** – Zhvillimi i protokolleve të komunikimit dhe ndarjes së informacionit me institucionet përkatëse për të përmirësuar gatishmërinë në rast emergjencash dhe krizash.<br>• **Parandalimi i rreziqeve nga mallrat e rrezikshme** – Verifikimi i dokumentacionit dhe kushteve të transportit për mallrat e rrezikshme për të shmangur situatat që mund të paraqesin rrezik në një krizë të mundshme. |

| | |
|---|---|
| Drejtoria Rajonale e Shërbimit Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive | • Hartimi i planeve të gatishmërisë për punësimin – Siguron që ekzistojnë strategji të përshtatura për të mbështetur punëkërkuesit në rast të ndikimeve të emergjencave në tregun e punës.<br>• Sigurimi i aksesit në informacionin mbi mundësitë e punësimit – Publikon informacion për punëkërkuesit mbi sektorët me rrezik më të ulët dhe mundësitë e mundshme të punësimit gjatë emergjencave.<br>• Mbështetja e institucioneve dhe punëdhënësve për menaxhimin e burimeve njerëzore në raste emergjente – Bashkëpunon me sektorin privat dhe publik për të lehtësuar transferimin e punonjësve në sektorë më të qëndrueshëm në rast të ndikimeve ekonomike.<br>• Koordinimi për zhvillimin e kapaciteteve të fuqisë punëtore – Ndihmon në identifikimin dhe promovimin e programeve të trajnimit për sektorët që kanë rëndësi kritike gjatë emergjencave.<br>• Zhvillimi i mekanizmave të integrimit të punëkërkuesve të prekur nga emergjencat – Siguron që individët e prekur nga situata të jashtëzakonshme të kenë qasje në mbështetje për riintegrimin në tregun e punës. |
| Drejtoria Rajonale e Entit Kombëtar të Banesave | • **Identifikimi i kapaciteteve të strehimit emergjent** – Përcaktimi dhe listimi i banesave sociale, objekteve të përshtatshme për përdorim emergjent dhe opsioneve të tjera strehimore për qytetarët e prekur nga fatkeqësitë. **Koordinimi paraprak me autoritetet vendore dhe qendrore** – Përcaktimi i mekanizmave të bashkëpunimit me bashkitë dhe institucionet përgjegjëse për identifikimin e kapaciteteve strehimore dhe krijimin e skemave të mundshme të zhvendosjes para ndodhjes së një emergjence.<br>• **Hartimi i skenarëve të gatishmërisë për strehim** – Planifikimi i opsioneve të mundshme për strehimin afatshkurtër të qytetarëve në rast emergjencash, duke përfshirë **modalitetet e aktivizimit të kapaciteteve të strehimit.**<br>• **Verifikimi i gjendjes së objekteve të banimit** – Kontrolli periodik i infrastrukturës së banesave publike dhe sociale për të siguruar që janë të sigurta dhe të disponueshme për përdorim në raste emergjente.<br>• **Bashkëpunimi me sektorin privat për opsione alternative strehimi** – Negocimi dhe krijimi i marrëveshjeve me subjekte private për përdorimin e hapësirave të përkohshme të strehimit në raste emergjente. |
| Agjencia Rajonale e Mjedisit | • **Monitorimi i treguesve mjedisorë për gatishmërinë** – Kryerja e matjeve dhe analizave të ajrit, ujit dhe tokës për të vlerësuar ndotjen dhe gjendjen mjedisore që mund të ndikojë në situata emergjente.<br>• **Inspektimi dhe kontrolli i operatorëve me ndikim mjedisor** – Mbikëqyrja e subjekteve që kanë detyrimin të zbatojnë masat për parandalimin e ndotjes dhe rreziqeve mjedisore, duke siguruar përputhshmërinë me kriteret e lejeve mjedisore. |

| | |
|---|---|
| | • **Identifikimi i ndotësve dhe faktorëve të rrezikut për situata emergjente**<br>Përcaktimi i zonave me ndotje të lartë ose rrezik për ndotje industriale, për të minimizuar efektet negative në rast fatkeqësish.<br>• **Hartimi i planeve të gatishmërisë për emergjenca mjedisore –** Përgatitja e masave të paracaktuara për të siguruar përgjigje efektive në situatat që përfshijnë ndotje ose dëmtime mjedisore me ndikim të lartë.<br>• **Bashkëpunimi me njësitë e qeverisjes vendore për menaxhimin e ndotjes dhe emergjencave –** Koordinimi i përpjekjeve me institucionet përkatëse për të krijuar një sistem efikas të mbikëqyrjes dhe reagimit ndaj incidenteve mjedisore.<br>• **Raportimi dhe shkëmbimi i informacionit mbi situatat mjedisore** – Sigurimi që informacioni mbi ndotësit dhe gjendjen mjedisore të raportohet në kohë reale në Drejtorinë e Përgjithshme për të përmirësuar gatishmërinë në menaxhimin e emergjencave mjedisore.<br>• **Përcaktimi i masave parandaluese dhe mbrojtëse në zonat me risk të lartë mjedisor –** Identifikimi i procedurave mbrojtëse për të reduktuar ekspozimin ndaj ndotësve në rast emergjencash natyrore apo teknologjike.<br>• **Edukimi dhe informimi i qytetarëve mbi masat e gatishmërisë –** Organizimi i fushatave ndërgjegjësuese dhe publikimi i udhëzimeve për qytetarët mbi sjelljen e duhur në rast ndotjesh ose emergjencash mjedisore. |
| Shoqëria e Ujësjellës Kanalizimeve SH.a | **Sigurimi i Furnizimit të Qëndrueshëm me Ujë**<br>• Planifikimi dhe garantimi i burimeve alternative për furnizimin me ujë në raste emergjencash për institucionet kritike, si spitalet, shkollat dhe zonat urbane.<br>• Identifikimi dhe përgatitja e skenarëve të ndërprerjeve të furnizimit me ujë, duke siguruar masa alternative për vazhdimësinë e shërbimeve.<br>**Funksionaliteti i Infrastrukturës**<br>• Inspektimi dhe mirëmbajtja e sistemeve rezervë të trajtimit të ujit për t'u siguruar që ato janë funksionale gjatë emergjencave.<br>• Kryerja e kontrolleve dhe ndërhyrjeve të rregullta dhe mirëmbajtja parandaluese e rrjetit ekzistues të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve për të siguruar funksionimin gjatë emergjencave.<br>**Përgatitja Operacionale**<br>• Rishikimi i kapaciteteve teknike dhe burimeve për t'u siguruar që ekipi dhe infrastruktura janë në gatishmëri për ndërhyrje të menjëhershme.<br>• Koordinimi me njësitë e emergjencave dhe institucionet përgjegjëse për të garantuar një reagim të shpejtë dhe efikas. |

| | |
|---|---|
| Kryqi i Kuq Shqiptar,<br>/Degët e Kryqit të Kuq që veprojnë në qark | • Sigurimi dhe mirëmbajtja e stoqeve emergjente të furnizimeve, të tilla si ushqim, ujë dhe komplete mjekësore për përdorim në raste fatkeqësish.<br>• Zhvillimi dhe zbatimi i programeve komunitare të gatishmërisë ndaj fatkeqësive duke rritur kapacitetin lokal për reagim.<br>• Trajnimi i vullnetarëve në përgjigjen emergjente dhe ndihmën e parë<br>• Organizimi i ushtrimeve dhe simulimeve për të testuar dhe përmirësuar aftësitë e reagimit të vullnetarëve dhe komunitetit.<br>• Organizimi i fushatave ndërgjegjëuese publike për të përmirësuar njohuritë mbi gatishmërinë dhe masat parandaluese ndaj fatkeqësive.<br>• Krijimi dhe mobilizimi i strukturave të vullnetarëve, të trajnuar për ndërhyrje në situata emergjente. |
| Drejtoria Vendore e Policisë Fier/Komisariatet/Stacionet e Policisë | **Planifikimi dhe Trajnimi për Situata Emergjente**<br>• Zhvillimi dhe përditësimi i planeve të sigurisë për mbrojtjen e popullsisë dhe infrastrukturës gjatë emergjencave.<br>• Trajnimi i oficerëve për evakuim, menaxhimin e turmave dhe reagim ndaj fatkeqësive<br>• Organizimi i ushtrimeve dhe simulimeve në bashkëpunim me shërbimet e emergjencës.<br>**Masat për Sigurinë dhe Rendin Publik**<br>• Planifikimi dhe zbatimi i masave paraprake për garantimin e rendit dhe sigurisë publike para ndodhjes së emergjencave.<br>• Identifikimi dhe hartimi i skenarëve për menaxhimin e trafikut dhe lëvizjen e qytetarëve në rast evakuimi.<br>**Koordinimi dhe Mbështetja Operacionale në Fazën e Gatishmërisë**<br>• Planifikimi i mbështetjes logjistike për operacionet e evakuimit, përfshirë identifikimin e rrugëve të sigurta, zonave të grumbullimit dhe mjeteve të transportit emergjent.<br>• Koordinimi me institucionet dhe strukturat e emergjencave për hartimin e strategjive të evakuimit dhe mbrojtjes së grupeve vulnerabël.<br>• Përcaktimi i protokolleve për asistencën ndaj popullsisë në rrezik, duke siguruar që mekanizmat e ndihmës të jenë të qarta dhe të gatshme për zbatim. |

# 6. Përgjigja

Faza e *Përgjigjes* ndaj një emergjence i referohet ofrimit të shërbimeve dhe ndihmës emergjente përpara, gjatë ose menjëherë pas një fatkeqësie, për të mbrojtur jetën e njerëzve, të gjësë së gjallë, pronës, trashëgimisë kulturore dhe mjedisit, për të garantuar sigurinë publike dhe për të përmbushur nevojat themelore për mbijetesë të njerëzve të prekur.

## 6.1 / Qëllimet kryesore të përgjigjes

*Shpëtimi i jetëve*. Objektivi kryesor është ruajtja dhe mbrojtja e jetës njerëzore duke kërkuar ndihmë për ata që janë në rrezik dhe duke garantuar sigurinë e viktimave dhe strukturat e Përgjigjes. Mirëqenia e tyre duhet të trajtohet në mënyrë efektive që ata të jenë në gjendje t'u përgjigjen nevojave të njerëzve në rrezik.

*Zbutja e vuajtjeve*. Dëmtimi fizik dhe psikologjik mund të shkaktojë ndikime afatshkurtra dhe afatgjata te individët, familjet dhe komunitetet. Masat e përgjigjes duhet të marrin parasysh të gjitha masat e arsyeshme për të reduktuar ose eliminuar vuajtjet njerëzore.

*Kufizimi i emergjencës*. Kufizimi i përshkallëzimit ose përhapjes së emergjencës dhe zbutja e ndikimeve të saj. Përgjigjja ndaj nevojave imediate të situatës emergjente për të parandaluar përkeqësimin e situatës duke kontrolluar rreziqet dhe duke zbutur rreziqet e mëtejshme për të zvogëluar humbjet ose dëmtimet e mëtejshme.

*Mbrojtja e shëndetit publik*. Adresimi i nevojave mjekësore, parandalimi i sëmundjeve dhe sigurimi i aksesit në objektet e kujdesit shëndetësor për të lënduarit ose të prekurit nga emergjenca.
Sigurimi i nevojave thelbësore. Sigurimi i furnizimit me ujë, ushqim dhe strehim për ata që janë zhvendosur ose janë prekur nga emergjenca.

*Mbrojtja e pronës*. Minimizimi i dëmit të pronës dhe ruajtja e infrastrukturës kritike, duke përfshirë shtëpitë, bizneset dhe objektet publike.

*Mbrojtja e mjedisit*. Mjedisi është thelbësor për komunitetet. Minimizimi i dëmit në mjedis duhet të jetë qëllimi i masave mbrojtëse për personelin e reagimit.

*Rivendosja e funksionimit të komunitetit*. Përqendrimi në rivendosjen e funksionimit të komunitetit dhe mbështetjen e individëve të prekur. Kjo përfshin rihapjen e shërbimeve thelbësore, lehtësimin e rivendosjes së shpejtë të shërbimeve dhe funksioneve komunitare, shërbimet komunitare, transportin dhe sistemet e komunikimit, ofrimin e ndihmës financiare dhe rivendosjen e besimit dhe moralit të publikut.

## 6.2 / Aktivizimi i përgjigjes në Shqipëri

Në PQEC të Qarkut Fier faza e Përgjigjes kalon nëpër katër etapa aktivizimi.

**Tabela 3:** Etapat e Përgjigjes

| | | |
|---|---|---|
| **Etapa I** | Alarmi për rritjen e gatishmërisë | Të gjitha masat për njoftimin e parë.<br>Mbledhja e informacionit.<br>Sinjalizimi për të rritur gatishmërinë. |
| **Etapa II** | Vendosja e gjendjes së gatishmërisë | Gatishmëri e plotë.<br>Njoftimi i situatës së pashmangshme |
| **Etapa II** | Aktivizimi | Dislokimi i plotë dhe mobilizimi |
| **Etapa IV** | Dalja nga situata | Rikthimi i burimeve në veprimtaritë e zakonshme |




**Figura 9:** Modeli i Ndërhyrjes për Menaxhimin e Emergjencës

## 6.3 / Aktivitetet e Institucionit të Prefektit të qarkut në fazën e përgjigjes

### 6.3.1 / Etapa I: Alarmi për rritjen e gatishmërisë

Vlerësohet nevoja për fillimin e Etapës I "*Alarm për rritjen e gatishmërisë*", në çastin e marrjes së njoftimit paraprak ose të informacionit për mundësinë e ndodhjes së një ngjarje e cila mund të shoqërohet me dëmtime në njerëz dhe dëme materiale.

**Tabela 4:** Etapa I: Alarmi për rritjen e gatishmërisë

| Prefekti/Përgjegjësi i Sektorit të Planifikimit, Përballimit të Emergjencave Civile dhe Krizave në Prefekturë | Koha e reagimit |
|---|---|
| Informon Prefektin për situatën dhe nevojën e aktivizimit të Etapës I: "*Alarm për rritjen e gatishmërisë*".<br>Prefekti pas vlerësimit të situatës dhe konsultimeve vendos për fillimin e kësaj etape. | Urgjente |
| Komunikon me AKMC-në, QKOEC-në, N/prefektët, kryetarët e bashkive, drejtuesit e institucioneve dhe strukturave në nivel qarku, me sektorët/specialistët e ngarkuar për planifikimin dhe mbrojtjen civile në bashki në lidhje me situatën. | E menjëhershme |
| Verifikon nëse QOECQ ka staf dhe pajisje të mjaftueshme për të punuar 24 orë gjatë etapës "Alarm për rritjen e gatishmërisë". | E menjëhershme |
| Verifikon dhe jep informacion AKMC-së, QKOEC-së për ngjarje të mundshme rreziku. | Brenda 1 ore |
| Informon institucionet dhe strukturat përkatëse monitoruese dhe informuese/njoftuese në nivel qarku dhe kërkon prej tyre monitorimin e vazhdueshëm të rrezikut, dhënien e informacionit dhe parashikimin e zhvillimit të situatës. | Brenda 1 ore |
| Informon institucionet dhe strukturat përkatëse monitoruese dhe informuese/njoftuese në nivel qarku dhe kërkon prej tyre monitorimin e vazhdueshëm të rrezikut, dhënien e informacionit dhe parashikimin e zhvillimit të situatës. | Brenda 1 ore |
| Verifikon nëse mjetet e transportit ose më saktë kapacitetet e deklaruara në PQEC të qarkut Fier janë në gatishmëri, të pajisura me mjetet e nevojshme dhe nëse kanë rezerva karburanti. | Brenda 1 ore |
| Kërkon informacion për rezervat monetare të gatshme, të mbajtura nga bashkitë dhe degët territoriale për situata emergjente. | Brenda 1 ore |
| Kontrollon mjetet e komunikimit, përditësimin e listave të kontaktit të planit të qarkut për emergjencat civile dhe aktivizon sistemin e paralajmërimit. | Brenda 1 ore |
| Siguron informacion të saktë për të bërë paralajmërimet dhe këshillimet e duhura për publikun me anë të mjeteve të informimit. | Brenda 1 ore |
| Përgatit informacion të përmbledhur për AKMC-në dhe QKOEC-në nëse është e nevojshme. | Çdo 2 orë |

### 6.3.2 / Etapa II: Vendosja e gjendjes së gatishmërisë

Vlerësohet nevoja për të hyrë në etapën e dytë "*Vendosja e gjendjes së gatishmërisë*". Kjo bëhet kur një rrezik i afërt është i pashmangshëm dhe ka gjasa të shkaktojë dëme në njerëz, pasuri ose mjedis.

**Tabela 5:** Etapa II: Vendosja e gjendjes së gatishmërisë

| Prefekti/Përgjegjësi i Sektorit të Planifikimit, Përballimit të Emergjencave Civile dhe Krizave në Prefekturë | Koha e reagimit |
|---|---|
| Informon AKMC-në për situatën dhe nevojën e fillimit të Etapës 2 "*Vendosja e gjendjes së gatishmërisë*". Prefekti pas konsultimeve dhe vlerësimeve vendos nisjen e kësaj etape. | Urgjente |
| Pas miratimit nga prefekti mblidhet KMCQ dhe kërkohet përgatitje për vendimmarrje, takime informuese për median dhe popullatën. | Brenda 2 orësh |
| Komunikon me AKMC-në, QKOEC-në, Nënprefektët, kryetarët e bashkive, drejtuesit e institucioneve dhe strukturave në nivel qarku, si dhe me sektorët/specialistët përgjegjës për planifikimin dhe mbrojtjen civile në bashki, duke i informuar për fillimin e Etapës 2 "*Vendosja e gjendjes së gatishmërisë*". Gjithashtu u kërkon atyre të monitorojnë situatën dhe të raportojnë mbi zhvillimet. | Menjëherë |
| Komunikon me strukturat e MM, FA dhe PSH dhe u kërkon atyre të ndjekin situatën sipas PQEC dhe të japin informacion të vazhdueshëm për situatën. Informon AKMC-në lidhje me këtë. | Brenda 1 ore |
| Komunikon me institucionet dhe strukturat e tjera monitoruese dhe informuese/njoftuese, operacionale aktive, operacionale mbështetëse dhe me strukturat e decentralizuara që operojnë në territorin e qarkut dhe kërkon prej tyre të ndjekin situatën sipas PQEC dhe të japin informacion të vazhdueshëm për zhvillimin e situatës. | Brenda 1 ore |
| Harton raportin e parë mbi situatën dhe informacionin periodik që i dërgohet AKMC-së dhe QKOEC-së. | Brenda 2 orësh |
| Verifikon dhe konfirmon që të gjitha masat e mëparshme janë zbatuar. | Brenda 1 ore |
| Aktivizon QOECQ që punon me staf të plotë, të pajisur për të punuar në etapën II "*Vendosja e gjendjes së gatishmërisë*" për 24 orë. | Menjëherë |
| Përgatit informacion për AKMC-në, publikun, median, donatorët dhe OJF-të e interesuara. | Brenda 2 orësh |
| Në bashkëpunim me bashkitë, këshillin e qarkut, degët territoriale krijon, organizon, koordinon dhe merr pjesë në grupe të përbashkëta vlerësimi dhe verifikimi të të dhënave për situatën në zonat në rrezik fatkeqësie. | Brenda 4 orësh |
| Informon popullatën për situatën e pritshme dhe i komunikon nevojën e zbatimit të masave vetëmbrojtëse. Prioritet u jepet banorëve të zonave në rrezik dhe në veçanti grupeve të cenueshme, si personat me aftësi të kufizuara, të moshuarit, personat, që jetojnë vetëm, grave, duke siguruar që informacioni të arrijë te të gjithë në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme. | Brenda 2 orësh |

| | |
|---|---|
| Verifikon disponueshmërinë/funksionalitetin e zonave të emergjencës (zona e dislokimit të personelit dhe të mjeteve, zonat e pritjes së të evakuuarve, vendet/objektet e akomodimit apo të strehimit të përkohshëm të popullsisë dhe rrugëve të evakuimit). | Brenda 1 ore |

### 6.3.3 / Etapa III: Aktivizimi

Aktivizimi fillon në rastet kur një ngjarje e papritur shkakton dëme në njerëz, pasuri ose mjedis, ose kur një ngjarje me zhvillim të ngadaltë paraqet rrezik të lartë për pasoja të njëjta, duke tejkaluar kapacitetet e strukturave të mbrojtjes civile në nivel vendor.

Ministri përgjegjës për Mbrojtjen Civile është autoriteti që shpall nisjen e Etapës së tretë, "*Aktivizimi*", duke angazhuar në mision vetëm strukturat e përhershme që kanë detyra të mbrojtjes civile.

Në rastet e emergjencave civile kombëtare kur shpallet gjendja e fatkeqësisë natyrore, KNEC krijohet me vendim të Këshillit të Ministrave. Në mbledhjen e tij të parë, KNEC emëron DQO, i cili merr drejtimin e përgjithshëm të përgjigjes në nivel qendror dhe koordinon ndihmën ndërkombëtare, sipas nevojës.

**Tabela 6:** Etapa III: Aktivizimi

| **Për emergjencat e shkallës më të ulët, Prefekti i qarkut/KMCQ** | **Koha e reagimit** |
|---|---|
| Siguron aktivizimin e të gjitha strukturave dhe kapaciteteve të reagimit operacional dhe mbështetës në nivel qarku, funksionimin e KMCQ dhe aktivizimin e QOECQ. | Brenda 1 ore |
| Kërkon informacion nga Përgjegjësi i Planifikimit, Përballimit të Emergjencave Civile dhe Krizave në prefekturë për gjendjen emergjente. | Brenda 1 ore |
| Mbledh KMCQ ose thërret urgjentisht atë pjesë të nevojshme të tij për konsultime sipas llojit të emergjencës për procesin e vendimmarrjes. | Brenda 2-4 orësh |
| Qëndron në kontakt me AKMC-në për të siguruar mundësi mbështetjeje për përballimin e situatës në rast nevoje. | Vazhdimisht |
| Nëse është e nevojshme, i propozon AKMC-së shpalljen e "Gjendjes së Fatkeqësisë Natyrore" për zonën e prekur. | Sipas situatës |
| **Përgjegjësi i Sektorit të Planifikimit, Përballimit të Emergjencave Civile dhe Krizave në prefekturë** | |
| Kërkon informacion periodik për situatën në terren nga grupet e përbashkëta të vlerësimit të situatës. | Çdo 2 orë |
| Nëse është e nevojshme, i propozon Prefektit shpalljen e "Gjendjes së Fatkeqësisë Natyrore" për zonën e prekur. | Sipas situatës |

| | |
|---|---|
| Harton raportin e parë për situatën dhe informacionin periodik, të cilat i dërgohen Prefektit, AKMC-së, QKOEC-së. | Çdo 2 orë |
| **Për emergjenca të shkallës më të lartë, pas emërimit të DOQ. DOQ do të sigurojë këto aktivitete.** | |
| Siguron aktivizimin e të gjitha strukturave dhe kapaciteteve të reagimit operacional dhe mbështetës në nivel qarku, si dhe aktivizimin e KMCQ dhe krijimin dhe funksionimin e QOECQ. | Menjëherë |
| Harton raporte me shkrim të situatës për Prefektin/AKMC-në/ QKOEC-në dhe KMCQ. | Çdo 2 orë |
| Koordinon strukturat vendore në nivel qarku, si dhe strukturat e tjera qendrore apo ndërkombëtare që vijnë në ndihmë. | Vazhdimisht |
| Mban lidhje të rregullta dhe kontakte të vazhdueshme me drejtues të tjerë të forcave operacionale në nivel qarku, informon dhe kërkon ndihmë nga DQO. | Vazhdimisht |
| Zbaton detyrat dhe urdhrat e marra nga KMCQ-në, si edhe nga DQO. | Vazhdimisht |

### 6.3.4 / Etapa IV. Dalja nga situata

Në etapën IV, "Dalja nga situata", mund të kalohet:

- Drejt e nga etapa I ose etapa II, pa kaluar në situatën e fatkeqësisë.
- Nga etapa III, kur një fatkeqësi ka ndodhur realisht dhe situata është stabilizuar.

Etapa IV përfaqëson rikthimin në situatë normale, ku nuk ka më një kërcënim të drejtpërdrejtë.

Dalja nga situata bëhet kur:

- Është kryer një vlerësim i plotë i situatës.
- Kërcënimi i fatkeqësisë është zvogëluar në mënyrë të qëndrueshme.
- Operacionet e ndihmës kanë dhënë rezultatet e pritshme.
- Nevojat më urgjente janë adresuar.

**Tabela 7:** Etapa IV. Dalja nga situata.

| **Prefekti/Përgjegjësi i Sektorit të Planifikimit, Përballimit të Emergjencave Civile dhe Krizave në prefekturë.** | **Koha e reagimit** |
|---|---|
| Komunikon me të gjithë njësitë e qeversisjes vendore, institucionet dhe strukturat në nivel qarku për shpalljen e Etapës IV "*Dalja nga situata*" dhe raporton tek Prefekti. Prefekti pas konsultimeve dhe vlerësimeve vendos nisjen e kësaj etape. | Menjëherë |
| Verifikon nëse informacioni dhe këshillat e nevojshme i janë transmetuar popullatës nëpërmjet mjeteve të informimit publik. | Brenda 2 orësh |
| Informon të gjitha strukturat në varësi, institucionet dhe strukturat e tjera që veprojnë në territorin e qarkut për kalimin në etapën IV "*Dalja nga situata*". | Menjëherë |
| Harton raportin përfundimtar të situatës dhe ia dërgon AKMC-së. | Brenda 2-4 orësh |
| Përgatit informacion përmbledhës, për Etapën "*Dalja nga situata*", për mediat, donatorët dhe përfaqësuesit e OJQ-ve. | Vazhdimisht |
| Grumbullon të gjitha të dhënat, raportet, hartat dhe korrespondencën duke i vendosur në dosjet përkatëse nën datën/numrin dhe titullin përkatës. | Brenda 2-4 orësh |
| Kthen çdo pajisje të marrë hua nga institucione dhe struktura të tjera. | Brenda ditës |
| Siguron rikthimin e QOECQ në gjendjen e mëparshme dhe administratës së prefektit në gjendjen normale të funksionimit. | Brenda ditës |
| Kontrollon që mjetet e transportit dhe asetet e tjera të marra nga institucionet dhe kompanitë private gjatë situatës, të kthehen në pronësi dhe gjendje normale pranë tyre. | Brenda ditës |
| U kërkon bashkive dhe institucioneve e strukturave, inventarizimin e gjendjes financiare dhe mbledhjen e faturave përkatëse. | Çdo ditë |
| Kontrollon funksionimin e mjeteve të komunikimit, përditësimin e listës së kontakteve dhe rishikimin e numrave të celularëve të personelit kyç. | Në vazhdim |

Diagrami në Figurën 10 më poshtë ilustron katër raste se si mund të arrihet Etapa 4.

**Figura 10:** Etapa 4 “Dalja nga Situata”




## 6.4 / Përgjegjësitë e strukturave dhe institucioneve për përgjigjen në nivel qarku

**Tabela 8:** Institucionet dhe strukturat, rolet dhe përgjegjësitë e tyre në fazën e *Përgjigjes* – Qarku Fier

| Institucionet dhe palët e përfshira | Përgjegjësitë kryesore në fazën e Përgjigjes |
|---|---|
| | **Institucione në nivel bashkie** |
| **Prefekti i qarkut Fier**<br>Përgjegjësi i Sektorit të Planifikimit, Përballimit të Emergjencave Civile dhe Krizave në prefekturë.<br>KMCQ | **Roli kryesor:** Organizimi, koordinimi, bashkëpunimi me njësitë vendore, me institucione dhe struktura që veprojnë në nivel qarku, me qarqet fqinje, me subjektet private, me organizatat e shoqërisë civile dhe me komunitetin për të përballuar emergjencën ose fatkeqësinë.<br><br>**Bazuar në PQEC:** |

| | |
|---|---|
| | **Koordinimi në nivel qarku:**<br>• Koordinon me strukturat në nivel qarku për përballimin dhe zbutjen e pasojave të fatkeqësisë.<br>• Koordinon shpërndarjen e ndihmës ndërkombëtare në rast fatkeqësish në nivel qarku.<br>**Bashkëpunimi ndërinstitucional:** Bashkëpunon me bashkitë e qarkut dhe me prefektët e qarqeve fqinje për të bashkuar kapacitetet e tyre për përballimin e emergjencës ose fatkeqësisë;<br>**Shkëmbimi i informacionit:** Shkëmben informacion me AKMC-në, njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe prefektët e rajoneve të tjera të prekura nga fatkeqësia ose në rrezik prej saj.<br>**Monitorimi dhe aktivizimi i masave emergjente:**<br>• Koordinon marrjen e masave të nevojshme për përballimin e situatës, monitorimin dhe zbatimin e shërbimeve të emergjencës,<br>• Aktivizon institucionet dhe administratat për ndërhyrje specifike.<br>**Kërkesa për mbështetje:** Drejton një kërkesë për mbështetje në AKMC, sipas kërkesës së bashkive.<br>**Përgjegjësi të detajuara:**<br>- Mobilizimi, koordinimi dhe aktivizimi i burimeve njerëzore, materiale, teknike dhe financiare në nivel qarku për përballimin e emergjencës apo fatkeqësisë.<br>- Koordinimi i punës së strukturës së PSH, SHMZSH, FA me strukturat e tjera përkatëse për kryerjen e procesit të kërkim-shpëtimit.<br>- Evakuimi në kohë i popullatës civile.<br>- Sigurimi i strehimit/akomodimit të përkohshëm për banorët gjatë emergjencës dhe plotësimi i kushteve dhe nevojave të tyre.<br>- Adresimi i nevojave të popullatës së prekur nga fatkeqësia për ofrimin e kujdesit shëndetësor, si dhe për shëndetin mendor.<br>- Sigurimi dhe shpërndarja e ndihmës ushqimore dhe burimeve esenciale gjatë emergjencës për banorët e prekur nga fatkeqësia.<br>- Bashkëpunimi me strukturat e PSH për garantimin e sigurisë publike në zonat e prekura nga fatkeqësia.<br>- Koordinim dhe bashkëpunim me njësitë vendore dhe strukturat e tjera në nivel qarku për mbrojtjen e gjësë së gjallë.<br>- Lëshimi i paralajmërimeve të hershme dhe informimi publik për EC.<br>- Vlerësimi i situatës në terren për të kuptuar natyrën dhe shtrirjen e emergjencës dhe masat që duhen marrë për përballimin e saj.<br>- Koordinimi i punës në nivel qarku për vlerësimin fillestar dhe të specializuar të dëmeve dhe nevojave në zonat e prekura nga fatkeqësia.<br>- Përgatitja e informacionit, raporteve për situatën për Prefektin, KMCQ dhe për AKMC .<br>- Mbështetja e QOECQ dhe DOQ në zbatimin e detyrave të tyre (në rastet kur ato janë krijuar).<br>- Komunikimi i vazhdueshëm me AKMC-në për situatën, si dhe nevojat për përballimin e saj. |

| | |
|---|---|
| | -Komunikimi i vazhdueshëm me Nën Prefektët, njësitë vendore dhe institucionet dhe strukturat e tjera në nivel qarku për situatën, si dhe me strukturat që janë të angazhuara për përballimin e emergjencës apo fatkeqësisë.<br>-Komunikimi dhe bashkëpunimi me qarqet fqinje për kryerjen e përgjigjes emergjente.<br>- Aktivizimi i QOECQ, bazuar në kriteret e përcaktuara në PKEC dhe PQEC.<br>- Menaxhimi i asistencës ndërkombëtare duke kryer procedurat e Mbështetjes së Vendit Pritës (MVP).<br>- Koordinimi dhe bashkëpunimi me strukturat përkatëse për sigurimin dhe restaurimin e infrastrukturës publike dhe kritike në nivel qarku (ujë, rrugë, energji elektrike, kanalizime, qendra publike, shkolla etj.).<br>- Garantimi që të gjitha aktivitetet e përgjigjes të jenë në përputhje me praktikat ligjore në fuqi.<br>- Dokumentimi i të gjithë ciklit të MEC ose fatkeqësive për analiza të ardhshme, llogaridhënie dhe raportim tek autoritetet më të larta. |
| Sektori Juridik | - Mbështetje të Sektorit të Planifikimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile dhe Krizave, në hartimin e akteve, dokumenteve ligjore që kërkohen për menaxhimin e emergjencës civile.<br>- Pjesëmarrje në grupe pune për vlerësimin e situatës së shkaktuar nga emergjenca.<br>- Pjesëmarrje në grupe pune për vlerësimin e nevojave në nivel qarku.<br>- Verifikim i të gjitha procedurave që po kryhen për menaxhimin e emergjencës në mënyrë që të jenë konform akteve ligjore në fuqi.<br>- Mbështetje e QOECQ me stafin e nevojshëm. |
| Sektori i Monitorimit të Kompetencave Vendore dhe Funksioneve të Deleguara | - Pjesëmarrje në grupe pune për vlerësimin e situatës.<br>- Pjesëmarrje në grupe pune për vlerësimin e nevojave të shkaktuara nga emergjenca.<br>- Ndihmë dhe mbështetje të njësive të vetëqeversijes vendore për të kryer funksionet e tyrë në fushën e mbrojtjes civile.<br>- Mbështetje e QOECQ me stafin e nevojshëm. |
| Sektori i Zhvillimit Urban | - Pjesëmarrje në grupe pune për vlerësimin e situatës së shkaktuar nga emergjenca civile.<br>- Pjesëmarrje në grupe pune për vlerësimin e nevojave.<br>- Mbështetje e QOECQ me stafin e nevojshëm. |

| | |
|---|---|
| Sektori i Financës dhe i Shërbimeve Mbështetëse | - Mbështetje e Sektorit të Planifikimit, Përballimit të Emergjencave Civile dhe Krizave, për sa i takon llogaritjeve të cështjeve financiare dhe sigurimit të fondeve.<br>- Pjesëmarrje në grupe pune për vlerësimin e nevojave<br>- Mbështetje e QOECQ me stafin e nevojshëm. |
| Inspektoriati Rajonal Shtetëror Shëndetësor Fier | **Monitorimi dhe inspektimi i emergjencave shëndetësore**<br>• Kryerja e inspektimeve të jashtëzakonshme për të garantuar respekimin e masave të mbrojtjes shëndetësore pas një emergjence.<br>• Verifikimi i kushteve higjieno-sanitare në qendrat e evakuimit, institucionet shëndetësore dhe objektet e prekura nga emergjenca.<br>**Sigurimi i zbatimit të protokolleve të mbrojtjes shëndetësore**<br>• Mbikëqyrja e zbatimit të masave për kontrollin e sëmundjeve infektive dhe ndotjes mjedisore.<br>• Marrja e masave urgjente për të parandaluar përhapjen e epidemive dhe ndotjes së ujit dhe ajrit.<br>**Inspektimi i sigurisë së ujit dhe ushqimit**<br>• Kontrolli i cilësisë së ujit të pijshëm për të parandaluar përhapjen e sëmundjeve me origjinë ujore.<br>• Verifikimi i kushteve të ruajtjes dhe shpërndarjes së ushqimeve në zonat e prekura.<br>**Bashkëpunimi me institucionet dhe koordinimi i masave**<br>• Koordinimi me Ministrinë e Shëndetësisë dhe strukturat emergjente për implementimin e masave të përgjigjes.<br>• Mbështetja teknike për autoritetet vendore dhe kombëtare në zbatimin e politikave të emergjencave shëndetësore.<br>**Vlerësimi i rreziqeve shëndetësore dhe raportimi**<br>• Identifikimi dhe raportimi i rreziqeve shëndetësore që mund të ndikojnë popullatën pas emergjencës.<br>• Përgatitja e raporteve të inspektimit dhe rekomandimeve për përmirësimin e situatës shëndetësore. |
| Njësitë Vendore të Kujdesit Shëndetësor<br><br>Drejtoria e Spitalit Rajonal Qendrat Shëndetësore<br><br>Ambulanca | **Mobilizimi i burimeve shëndetësore:** Mbajtja në gatishmëri e dhomave të urgjencës, laboratorëve dhe mjekëve dhe infermierëve specialistë për t'u përgjigjur emergjencave .<br>**Ndihma e parë dhe kujdesi emergjent:** Ofrimi i ndihmës së parë dhe kujdesit mjekësor emergjent për të lënduarit në zonat e prekura.<br>**Kujdesi shëndetësor gjithëpërfshirës:** Ofrimi i kujdesit shëndetësor në të gjitha nivelet për qytetarët e lënduar.<br>**Aktivizimi i ekipeve shëndetësore të urgjencës:** Aktivizimi i ekipeve shëndetësore të urgjencës për t'iu përgjigjur situatave kritike. |

| | |
|---|---|
| | **Rezerva farmaceutike:** Sigurimi i një rezerve farmaceutike dhe një shërbimi farmaceutik rezervë për rastet e emergjencave masive.<br>**Parandalimi i sëmundjeve infektive:** Marrja e masave për kontrollin dhe parandalimin e sëmundjeve epidemike dhe infeksioneve.<br>**Trajtimi i kontaminimeve radioaktive dhe kimike:** Trajtimi i rasteve të kontaminimit me materiale të rrezikshme dhe të kontaminuara.<br>**Karantina shëndetësore:** Shpallja e gjendjes së karantinës shëndetësore nëse është e nevojshme.<br>**Evakuimi i pacientëve:** Menaxhimi i operacioneve të evakuimit të pacientëve nga spitalet e dëmtuara në spitale të tjera.<br>**Transporti i të lënduarve:** Sigurimi i transportit tokësor dhe ajror për personat e lënduar në zonat e prekura.<br>**Rezervimi i pajisjeve shtesë shëndetësore dhe gjakut:** Aktivizimi i pajisjeve shtesë shëndetësore dhe rezervimi i gjakut për të përmbushur nevojat urgjente.<br>**Kontrolli i cilësisë së ujit:** Monitorimi i cilësisë së ujit të pijshëm dhe ujërave për përdorim shtëpiak.<br>**Kontrolli i higjienës:** Monitorimi dhe sigurimi i i higjienës shëndetësore në zonat e emergjencës dhe në vendet e akomodimit dhe strehimit të përkohshëm.<br>**Trajtimi i zonave të kontaminuara:** Ofrimi i mbështetjes për trajtimin e zonave të prekura nga materiale të rrezikshme, nëse është e nevojshme.<br>**Mbështetja për strehimoret kolektive:** Dhënia e ndihmës për strukturat që trajtojnë popullsinë e strehuar në strehimore kolektive të përkohshme.<br>**Shpërndarja e barnave:** Organizimi i shpërndarjes së barnave mjekësore për pacientët dhe këshillimi për përdorimin e tyre. |
| Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror | **Evakuimi dhe strehimi**<br>• Evakuimi i personave nga qendrat e përkujdesjes (azile, qendra për persona me aftësi të kufizuara) dhe sigurimi i strehimit të përkohshëm.<br>• Monitorimi dhe mbështetja e fëmijëve pa kujdes prindëror dhe grupeve të cenueshme në qendrat e strehimit emergjent.<br>**Ndihma sociale dhe kujdesi psikologjik**<br>• Ofrimi i ndihmës së parë sociale dhe psikologjike për të prekurit.<br>• Sigurimi i shërbimeve bazike dhe asistencës për personat në nevojë në qendrat e strehimit emergjent.<br>**Pjesëmarrja në kërkim-shpëtim**<br>• Bashkëpunimi me strukturat e emergjencave për operacionet e kërkim-shpëtimit në qendrat e përkujdesjes sociale.<br>• Ofrimi i ndihmës dhe riintegrimit për personat e shpëtuar. |

| | |
|---|---|
| | **Koordinimi dhe menaxhimi i asistencës**<br>• Bashkëpunimi me OJF-të dhe organizatat humanitare për shpërndarjen e ndihmave.<br>• Monitorimi i nevojave dhe raportimi për sigurimin e ndihmës sociale në nivel qarku. |
| Përfaqësues të Forcave të Armatosura në territorin e Qarkut (Rep.Usht. Poshnje- Berat) | • Mobilizimi dhe aktivizimi i burimeve për evakuimin e popullatës civile.<br>• Asistencë për procesin e strehimit (të përkohshëm)/akomodimin e popullsisë së evakuuar gjatë emergjencës.<br>• Asistencë gjatë procesit të shpërndarjes të ndihmës ushqimore dhe ndihmës tjetër gjatë emergjencës.<br>• Bashkëpunim dhe koordinim me strukturat e tjera operacionale që veprojnë në territor.<br>• Në rastin e vërshimeve të lumenjve, asistencë për vendosjen e digave mbrojtëse dhe për punimet mbrojtëse në argjinatura.<br>• Asistencë për operacionet e mbrojtjes nga zjarret.<br>• Mbron infrastrukturën kritike dhe ndihmon në riparimet dhe pastrimin e mbeturinave gjatë emergjencave.<br>• Siguron rendin publik, menaxhoni turmat dhe ruani asetet strategjike gjatë emergjencave. |
| Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare Durrës | **Mobilizimi dhe aktivizimi i strukturave**<br>• Aktivizimi i menjëhershëm të grupeve përgjegjëse për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore në zonat e prekura.<br>• Koordinimi me strukturat operacionale të qarkut dhe qeverisjen vendore për ndërhyrje emergjente.<br>**Mbrojtja e vlerave të trashëgimisët kulturore**<br>• Organizimi i evakuimit, sistemimin dhe ruajtjes së materialeve të rëndësishme nga institucionet e trashëgimisë kulturore, muzeumet dhe objektet monumentale.<br>• Sigurimi i masave mbrojtëse për parandalimin e dëmtimeve të mëtejshme në objektet e trashëgimisë kulturore.<br>**Mbështetja e komunitetit**<br>Organizimi i aktiviteteve kulturore dhe ndërhyrjeve psikosociale për lehtësimin e stresit të komunitetit të prekur nga fatkeqësia.<br>**Vlerësimi i dëmeve**<br>• Vlerësimi i dëmeve të shkaktuara në objektet e trashëgimisë kulturore dhe institucionet muzeale.<br>• Hartimi i raporteve mbi dëmet dhe nevojat për restaurim dhe mbështetje. |

<table>
<tr><td>Drejtoria Rajonale e OSHEE-se</td><td>Menaxhimi i ndërprerjeve dhe riparimi i rrjetit<br>• Menaxhimi i situatave të shkaktuara nga dëmtimet ose aksidentet në rrjetin e shpërndarjes së energjisë energjetike.<br>• Organizimi i ekipeve të emergjencës për riparimin e defekteve dhe rikthimin e furnizimit me energji në zonat e prekura.<br>Koordinimi dhe reagimi operativ<br>• Organizimi i sistemit të njoftimit dhe ndërhyrjes emergjente në bashkëpunim me autoritetet përkatëse dhe strukturat e emergjencave civile.<br>• Sigurimi i furnizimit të qëndrueshëm për infrastrukturën kritike dhe publike si spitalet, institucionet publike dhe qendrat e emergjencës.<br>Informimi dhe komunikimi me publikun<br>• Njoftimi i publikut mbi ndërprerjet e energjisë dhe afatet e rikuperimit.<br>• Bashkëpunimi me institucionet vendore për të siguruar transparencë dhe koordinim efektiv gjatë emergjencave.<br>Ruajtja e funksionimit të infrastrukturës kritike<br>• Monitorimi i vazhdueshëm i rrjetit të shpërndarjes dhe parandalimi i mbingarkesave që mund të çojnë në dështime sistemike.<br>• Aktivizimi i mekanizmave alternativë për furnizim të energjisë në rast të ndërprerjeve të gjata.</td></tr>
<tr><td>Operatori i Sistemit të Trasmetimit OST</td><td>Menaxhimi i emergjencave dhe rikthimi i funksionalitetit<br>• Menaxhimi i situatave të shkaktuara nga dëmtimet në rrjetin e transmetimit të energjisë elektrike.<br>• Organizimi i ekipeve të emergjencës për riparimin e linjave të transmetimit dhe rikthimin e furnizimit me energji.<br>Koordinimi dhe reagimi operacional<br>• Koordinimi me autoritetet vendore dhe institucionet qendrore për ndërhyrjet në infrastrukturën e transmetimit.<br>• Sigurimi i furnizimit të vazhdueshëm me energji për objektet strategjike dhe kritike, si spitalet dhe qendrat e emergjencës.<br>Monitorimi dhe stabilizimi i rrjetit<br>• Monitorimi i gjendjes së rrjetit të transmetimit për të shmangur kolapsin sistemik.<br>• Zbatimi i masave emergjente për të balancuar ngarkesën në sistemin e transmetimit dhe shmangur ndërprerjet masive.<br>Komunikimi dhe informimi<br>• Informimi i autoriteteve dhe institucioneve për situatën dhe masat e marra për stabilizimin e furnizimit me energji.<br>• Bashkëpunimi me OSHEE për koordinimin e veprimeve të përbashkëta për rimëkëmbjen e rrjetit.</td></tr>
</table>

| | |
|---|---|
| Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Fier | **Menaxhimi i emergjencës dhe mobilizimi i burimeve**<br>• Mobilizimi dhe aktivizimi i burimeve për menaxhimin e situatave emergjente, në veçanti për ujitjen dhe kullimin.<br>• Zbatimi i masave emergjente të menaxhimit të ujit gjatë fatkeqësive (p.sh. çlirimet e kontrolluara të ujit për të shmangur përmbytjet dhe dëmtimet e infrastrukturës).<br>**Monitorimi dhe vlerësimi i dëmeve**<br>• Vlerësimi i dëmeve dhe nevojave në bujqësi, në infrastrukturën e ujitjes dhe kullimit në zonat e prekura nga fatkeqësia dhe identifikimi i ndërhyrjeve të menjëhershme për stabilizimin e rrjetit.<br>• Raportimi i dëmeve në sektorin e bujqësisë dhe ndikimit në prodhimin bujqësor në zonat e prekura.<br>**Ndihma dhe mbështetja emergjente**<br>• Sigurimi i funksionalitetit të rrjetit të kullimit për të shmangur përkeqësimin e situatës në zonat bujqësore.<br>• Koordinimi me autoritetet vendore dhe fermerët për menaxhimin e emergjencës në furnizimin me ujë. |
| Drejtoria Rajonale Arsimit Parauniversitar Fier | **Koordinimi dhe komunikimi në Emergjenca:**<br>Bashkëpunimi me bashkitë, Prefektin e qarkut, Ministrinë e Arsimit, strukturat e planifikimit dhe të mbrojtjes civile për të siguruar një përgjigje të koordinuar ndaj emergjencave dhe fatkeqësive.<br>Shkëmbimi i informacionit rreth situatës dhe nevojave të shkollave të prekura, duke përfshirë transportin dhe shërbimet e emergjencës<br>Krijimi i linjave të qarta të komunikimit ndërmjet shkollave, mësuesve, prindërve për të ofruar përditësime dhe udhëzime për situatën.<br>**Vlerësimi dëmeve dhe nevojave:**<br>• Vlerësimi i ndikimit të emergjencës në shkolla, duke përfshirë dëmet në infrastrukturë dhe ndërprerjet e mësimit.<br>• Identifikimi i nevojave emergjente të nxënësve dhe stafit (ushqim, ujë, mbështetje psikologjike).<br>• Sigurimi i mbështetjes mjekësore dhe këshillimit psikologjik për nxënësit dhe stafin e prekur.<br>**Garantimi i sigurisë së nxënësve dhe personelit dhe evakuuimi:**<br>• Zbatimi i protokolleve të sigurisë për nxënësit, stafin dhe ndërtesat e shkollave, duke u siguruar që ato të jenë të sigurta nga dëmtimet e mëtejshme.<br>• Mbështetja e evakuimit të shkollave të rrezikuara dhe sigurimi i transportit emergjent për nxënësit në zona të sigurta.<br>• Ofrimi i mbështetjes mjekësore, ndihmës së parë dhe këshillimit psikologjik për nxënësit dhe stafin e prekur.<br>•Mbështetje për popullatat e cenueshme (p.sh., fëmijët me aftësi të kufizuara ose ata në rrethana të veçanta). |

| | |
|---|---|
| | **Sigurimi i vazhdimësisë së edukimit:**<br>• Vlerësimi i shkollave që mund të rifillojnë funksionimin dhe përcaktimi i afateve për rikthimin në mësim.<br>• Përdorimi i metodave alternative të ofrimit të arsimit, si mësimi nëpërmjet programeve në internet, objektet e përkohshme shkollore ose metoda të tjera të mësimit në distancë, në rast të mbylljes së shkollave ose dëmtimit të infrastrukturës fizike.<br>• Koordinimi me personelin arsimor për të siguruar që mësimdhënia dhe të nxënit mund të vazhdojnë edhe në mjedise të përkohshme ose të ndërprera. |
| Drejtoria Rajonale e Autoritetit Kombëtar i Ushqimit, Fier | **Monitorimi dhe Inspektimi në Emergjenca**<br>• Kryerja e kontrolleve emergjente për produktet ushqimore dhe bujqësore në tregti, magazinim dhe shpërndarje, për të garantuar sigurinë ushqimore.<br>• Monitorimi i sigurisë ushqimore në zonat e prekura për të identifikuar rreziqet që lidhen me ndotjen ose dëmtimin e ushqimeve gjatë emergjencave civile.<br>• Inspektimi i pikave të furnizimit, për të siguruar se produktet ushqimore të shpërndara në ndihmat humanitare janë të sigurta për konsum.<br>**Informimi dhe Ndërgjegjësimi i Publikut**<br>• Dhënia e udhëzimeve për ruajtjen dhe përdorimin e sigurt të ushqimit gjatë emergjencave për të parandaluar helmimet dhe sëmundjet që lidhen me konsumimin e produkteve të kontaminuara.<br>• Informimi i popullatës mbi masat e nevojshme për mbrojtjen e sigurisë ushqimore gjatë emergjencave civile.<br>**Bashkëpunimi dhe Koordinimi në Menaxhimin e Emergjencave**<br>• Koordinimi me autoritetet qeveritare dhe ndërkombëtare, për të siguruar menaxhimin e duhur të emergjencave që prekin sigurinë ushqimore.<br>• Përcaktimi i nevojave për mbështetje ushqimore në qark, duke ndihmuar në shpërndarjen e ndihmave humanitare me produkte të sigurta.<br>• Bashkëpunimi me strukturat shëndetësore për të identifikuar dhe menaxhuar raste të helmimeve nga ushqimi ose sëmundjeve të shkaktuara nga produktet e pasigurta. |

| | |
|---|---|
| Zyra Agjencisë, Baseni Ujor Shkumbin.-Seman | **Monitorimi dhe raportimi i situatës:**<br>• Monitorimi në mënyrë të vazhdueshme i nivelit të ujit, rrjedhjes së lumenjve, rezervuarëve dhe ujërave nëntokësore dhe kushteve të motit për të identifikuar përkeqësime kritike që mund të shkaktojnë përmbytje ose thatësira.<br>• Kryen inspektime të menjëhershme për të vlerësuar ndikimin e emergjencës mbi burimet ujore dhe harton raporte për autoritetet përgjegjëse.<br>• Informon Këshillin e Basenit Lumor dhe Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMB) mbi problematikat emergjente dhe kërkesën për masa urgjente.<br>**Koordinimi i përgjigjes emergjente:**<br>• Koordinimi me autoritetet lokale, bashkitë, prefekturën, degët e tjera territoriale dhe ato në nivel qendror për menaxhimin e situatës së emergjencës.<br>• Sigurimi i të dhënave dhe analizave në kohë reale për të mbështetur vendimmarrjen për rastet emergjente.<br>• Identifikon përdoruesit kryesorë të burimeve ujore që preken nga situata emergjente dhe koordinon me ta për menaxhimin e konsumit të ujit.<br>**Sigurimi i Cilësisë dhe Sasisë së Ujit**<br>• Vlerësimi i cilësisë dhe sasisë së burimeve ujore në rajon, duke përfshirë lumenjtë, liqenet dhe rezervuarët.<br>• Kryrja e monitorimeve të menjëhershme për cilësinë dhe ndotjen e ujit në zonat e prekura, duke raportuar për situatat me rrezik për shëndetin publik.<br>• Identifikimi i dëmtimeve në infrastrukturën e burimeve ujore (p.sh., kanale ujitëse, diga, rezervuarë) dhe sinjalizimi i autoriteteve për masat e riparimit emergjent.<br>**Komunikimi dhe ndërgjegjësimi publik:**<br>• Lëshon njoftime emergjente për përdorimin dhe kursimin e ujit përmes kanaleve të informimit publik.<br>• Siguron informacion dhe udhëzime për qytetarët dhe bizneset për reduktimin e rreziqeve që lidhen me krizën e ujit.<br>• Koordinon me institucionet përgjegjëse për informimin e komuniteteve të prekura mbi situatën dhe masat mbrojtëse. |
| ARRSH Gjirokastër për Rajonin Jugor (Gjirokastër) | **Aktivizimi i mekanizmave të menaxhimit të emergjencave**<br>• Ngritja e shtabeve të emergjencave në bashkëpunim me Prefekturën dhe Policinë e Shtetit për menaxhimin e situatave emergjente që prekin infrastrukturën rrugore.<br>• Organizimi dhe mobilizimi i strukturave të mirëmbajtjes dhe ndërhyrjes emergjente për garantimin e qarkullimit të sigurt në rrugët e prekura. |

| | |
|---|---|
| | **Sigurimi i lëvizshmërisë dhe ndërhyrjeve emergjente**<br>• Vendosja e sinjalistikës emergjente dhe masave të sigurisë për menaxhimin e trafikut në zonat e prekura nga fatkeqësia.<br>• Angazhimi i mjeteve dhe burimeve teknike për pastrimin dhe riparimin emergjent të akseve rrugore për të siguruar kalueshmërinë për shërbimet e emergjencës.<br>• Organizimi i ndërhyrjeve për hapjen e rrugëve të bllokuara nga reshjet, rrëshqitjet e dheut ose dëmtimet strukturore.<br>**Koordinimi me autoritetet dhe strukturat e emergjencës**<br>• Komunikimi dhe koordinimi i veprimeve me Prefekturën, bashkitë, Policinë e Shtetit dhe strukturat e tjera për të siguruar aksesin në zonat e prekura.<br>• Informimi dhe raportimi mbi gjendjen e infrastrukturës rrugore dhe nevojat për ndërhyrje shtesë.<br>• Bashkëpunimi me shërbimet e emergjencës dhe forcat e sigurisë për të mundësuar evakuimin dhe lëvizjen e personave të prekur nga fatkeqësia. |
| IKMT Fier | **Koordinimi dhe bashkëpunimi institucional**<br>• Bashkëpunimi dhe koordinimi me Prefekturën, bashkitë dhe institucionet qendrore për të siguruar zbatimin e ligjshmërisë në territorin e prekur nga fatkeqësia.<br>• Angazhimi në shtabet e emergjencës për menaxhimin e situatës dhe koordinimin e ndërhyrjeve për ndërtimet e paligjshme që mund të ndikojnë në përkeqësimin e situatës.<br>• Sigurimi i integritetit të infrastrukturës, duke ndërmarrë masa për të shmangur rreziqet nga ndërtimet e paautorizuara që mund të përkeqësojnë pasojat e fatkeqësisë.<br>**Ndërhyrja në zonat e prekura nga fatkeqësitë**<br>• Vlerësimi i dëmeve në ndërtimet e paligjshme, të cilat mund të përbëjnë rrezik për jetën dhe sigurinë e banorëve.<br>• Ndihmesa në identifikimin dhe vlerësimin e infrastrukturës së dëmtuar, duke bashkëpunuar me autoritetet përkatëse për ndërhyrjet emergjente.<br>• Monitorimi i territoreve të prekura nga fatkeqësitë për të parandaluar ndërtime të paligjshme ose veprime të tjera që mund të përkeqësojnë situatën pas emergjencës.<br>**Kontrolli dhe masat emergjente**<br>• Mbikëqyrja e situatës mjedisore dhe e ndikimeve të ndërtimeve të paligjshme që mund të rrezikojnë stabilitetin e territorit.<br>• Kontributi në vendimmarrje për ndërhyrjet emergjente lidhur me territorin dhe menaxhimin e infrastrukturës.<br>• Ndjekja dhe raportimi i problematikave të konstatuara tek autoritetet qendrore për veprime të mëtejshme. |

| | |
|---|---|
| Administrata e Zonave të Mbrojtura Pyjore qarku Fier, Divjakë | **Monitorimi dhe vlerësimi i situatës**<br>• Monitorimi i ndikimeve të emergjencës në zonat e mbrojtura, përfshirë dëmet në biodiversitet, florën dhe faunën, ekosistemet dhe habitateve natyrore.<br>• Raportimi dhe informimi i institucioneve përgjegjëse për dëmet e shkaktuara në zonat e mbrojtura dhe ndikimet e tyre në mjedis.<br>• Bashkëpunimi me institucionet e tjera për të vlerësuar rreziqet e vazhdueshme dhe për të siguruar mbrojtjen e biodiversitetit dhe ekosistemeve të prekura.<br>**Masat e menaxhimit të emergjencës**<br>• Koordinimi me autoritetet lokale, bashkitë, prefekturat dhe strukturat e mbrojtjes civile për përballimin e emergjencës ose fatkeqësisë.<br>• Sigurimi i mbrojtjes së biodiversitetit dhe ekosistemeve duke ndërmarrë masa të menjëhershme për të kufizuar dëmet dhe për të parandaluar degradimin e mëtejshëm të mjedisit.<br>• Angazhimi i stafit dhe burimeve për përgjigjen ndaj emergjencës, përfshirë mbikëqyrjen e ndërhyrjeve të paligjshme në zonat e mbrojtura.<br>• Zbatimi i masave për të kufizuar ndikimet e emergjencës në florën dhe faunën, përfshirë evakuimin ose mbrojtjen e specieve të rrezikuara nëse është e nevojshme.<br>**Komunikimi dhe ndërgjegjësimi**<br>• Dhënia e udhëzimeve dhe paralajmërimeve për publikun dhe vizitorët për të shmangur rreziqet dhe për të siguruar respektimin e rregullave gjatë emergjencës.<br>• Njoftimi i organeve kompetente për shkeljet ligjore të konstatuara në zonat e mbrojtura gjatë emergjencës dhe mbështetja për zbatimin e masave të menjëhershme ligjore. |
| Agjencia Rajonale Ekstensionit Bujqësor Lushnjë | **Vlerësimi i Situatës dhe Ndikimit në Bujqësi**<br>• Mbledhja dhe raportimi i të dhënave për dëmet në sektorin bujqësor, përfshirë dëmet në kultura bujqësore, blegtori dhe infrastrukturën bujqësore.<br>• Koordinimi me institucionet qendrore dhe vendore për vlerësimin e ndikimit të emergjencës dhe përcaktimin e nevojave për ndërhyrje emergjente.<br>**Mbështetja për Fermerët në Zonat e Prekura**<br>• Dhënia e informacionit dhe udhëzimeve urgjente për fermerët mbi masat e menjëhershme për mbrojtjen e prodhimit bujqësor dhe blegtorisë.<br>• Sigurimi i mbështetjes logjistike për furnizimin e ushqimit të blegtorisë dhe farave emergjente, në bashkëpunim me autoritetet përkatëse. |

| | |
|---|---|
| | **Koordinimi dhe Mbështetja Institucionale**<br>• Bashkëpunimi me bashkitë, prefekturën dhe Ministrinë e Bujqësisë për të siguruar një përgjigje të koordinuar ndaj emergjencës.<br>• Pjesëmarrja në vlerësimin e nevojave për ndihmë emergjente për fermerët dhe sigurimi i inputeve bujqësore thelbësore (farëra, ushqim për bagëtinë, plehra emergjente) për fermerët e prekur.<br>**Informimi dhe Ndërgjegjësimi Publik**<br>• Informimi i fermerëve mbi masat emergjente dhe ndihmën e disponueshme nga qeveria dhe organizatat ndërkombëtare për sektorin bujqësor.<br>• Komunikimi i vazhdueshëm me institucionet përgjegjëse për përditësimin e të dhënave mbi nevojat emergjente dhe monitorimin e situatës. |
| Drejtoria Rajonale e Veterinarisë dhe Mbrojtjes së bimëve Vlorë, Sektori Veterinar Qarku Fier | **Kontrolli dhe menaxhimi i sëmundjeve infektive në kafshë**<br>• Zbatimi i masave të kontrollit për sëmundjet infektive në kafshë dhe ndalimi i lëvizjes së kafshëve të infektuara për të parandaluar përhapjen e sëmundjeve zoonotike dhe epizootike.<br>• Evidentimi dhe raportimi i gjendjes epizootike në zonat e prekura nga fatkeqësia dhe komunikimi me institucionet përkatëse.<br>• Kryerja e veprimeve të menjëhershme sanitare dhe epidemiologjike, duke përfshirë izolimin e kafshëve të infektuara dhe zbatimin e masave të dezinfektimit.<br>**Menaxhimi i situatës emergjente në blegtori**<br>• Koordinimi me autoritetet vendore dhe qendrore për menaxhimin e emergjencave në sektorin blegtoral, përfshirë Ministrinë e Bujqësisë, bashkitë dhe prefekturat.<br>• Vlerësimi i dëmeve në blegtori, duke përcaktuar shkallën e humbjeve dhe nevojat për mbështetje emergjente për fermerët e prekur.<br>• Zbatimi i masave të sigurisë ushqimore për produktet me origjinë shtazore, duke garantuar cilësinë e konsumit në kushtet e emergjencës.<br>**Eliminimi dhe dëmshpërblimi për kafshët e ngordhura**<br>• Zbatimi i procedurave për eliminimin e kafshëve të ngordhura nga sëmundjet infektive ose nga ndikimi i fatkeqësive natyrore.<br>• Bashkëpunimi me institucionet për sigurimin e kompensimeve për fermerët, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.<br>**Mbrojtja e bimëve dhe vlerësimi i dëmeve në sektorin bujqësor**<br>• Identifikimi dhe raportimi i dëmeve në kulturat bujqësore dhe produktet bimore në zonat e prekura nga fatkeqësia.<br>• Koordinimi me njësitë vendore dhe institucionet për mbështetje emergjente për fermerët, përfshirë masat për mbrojtjen e bimëve dhe përdorimin e pesticideve emergjente në rast të përhapjes së sëmundjeve bimore. |

| | |
|---|---|
| | **Koordinimi dhe mbështetja institucionale**<br>• Bashkëpunimi me bashkitë, prefekturën dhe Ministrinë e Bujqësisë për të siguruar një përgjigje të koordinuar ndaj emergjencës.<br>• Përcjellja e informacionit mbi gjendjen epizootike dhe fitosanitare tek institucionet përgjegjëse, për të mundësuar një reagim më të shpejtë dhe efikas. |
| Albpetrol | **Menaxhimi i sigurisë në operacionet hidrokarbure**<br>• Zbatimi i masave emergjente për mbrojtjen e jetës së punonjësve dhe sigurisë së mjedisit gjatë emergjencave që prekin operacionet e kërkimit, prodhimit dhe transportit të hidrokarbureve.<br>• Aktivizimi i planit të emergjencës për incidente të hidrokarbureve (si rrjedhje nafte, shpërthime, zjarre ose ndotje).<br>• Koordinimi me institucionet shtetërore dhe partnerët për zbutjen e pasojave të emergjencës në përputhje me legjislacionin për hidrokarburet dhe sigurinë mjedisore.<br>**Koordinimi institucional dhe raportimi**<br>• Komunikimi i menjëhershëm me Ministrinë përgjegjëse për hidrokarburet, Agjencinë Shtetërore të Hidrokarbureve dhe autoritetet qendrore për informimin dhe menaxhimin e situatës.<br>• Pjesëmarrja në struktura ndërinstitucionale të reagimit ndaj emergjencave, përfshirë koordinimin me prefekturat, bashkitë dhe autoritetet e mbrojtjes civile.<br>**Menaxhimi i infrastrukturës kritike**<br>• Sigurimi i vazhdimësisë së operacioneve të sigurisë në rafineritë, tubacionet dhe sistemet e prodhimit të hidrokarbureve në kushtet e një emergjence.<br>• Marrja e masave parandaluese për të shmangur përhapjen e ndotjeve dhe dëmeve mjedisore në zonat e prekura nga fatkeqësia.<br>**Monitorimi dhe përgjigja teknike**<br>• Kryerja e vlerësimit të ndikimit të emergjencës mbi operacionet hidrokarbure dhe infrastrukturën energjetike.<br>• Propozimi i masave të menjëhershme teknike dhe operative për të minimizuar dëmet dhe për të rikthyer operacionet në gjendjen normale.<br>**Përmbushja e detyrimeve ligjore në kushtet e emergjencës**<br>• Zbatimi i detyrimeve të përcaktuara në ligjin për hidrokarburet lidhur me sigurinë operacionale, ruajtjen e mjedisit dhe menaxhimin e krizave.<br>• Marrja e masave për minimizimin e rreziqeve të ndotjes hidrokarbure dhe rehabilitimin e zonave të prekura nga incidentet. |

| | |
|---|---|
| Dega e Doganës Fier | **Lehtësimi i procedurave për ndihmat ndërkombëtare**<br>• Përpunimi i menjëhershëm i procedurave doganore për ndihmat humanitare ndërkombëtare që hyjnë në Shqipëri për përballimin e emergjencave.<br>• Krijimi i një korridori të shpejtë doganor për ndihmat e emergjencës, duke shmangur vonesat burokratike.<br>• Sigurimi që të gjitha ndihmat e importuara për situatat emergjente të trajtohen në përputhje me përjashtimet dhe lehtësirat doganore të parashikuara në legjislacion.<br>**Koordinimi me autoritetet e mbrojtjes civile**<br>• Bashkëpunimi me strukturat kombëtare të mbrojtjes civile, përfshirë AKMC dhe autoritetet vendore, për menaxhimin e ndihmave që kalojnë kufirin.<br>• Informimi dhe raportimi në kohë reale mbi situatën e ndihmave që hyjnë në vend dhe procedurat doganore të lidhura me to.<br>**Zbatimi i rregullave për Mbështetjen e Vendit Pritës (MVP) ose Host Nation Support (HNS)**<br>• Përcaktimi i masave të veçanta doganore për pranimin e ndihmave dhe personelit ndërkombëtar që vjen për të ndihmuar në emergjenca.<br>• Zbatimi i procedurave të veçanta për hyrjen dhe përdorimin e pajisjeve teknike e logjistike që transportohen për operacionet e emergjencës.<br>**Monitorimi dhe mbikëqyrja e produkteve të ndihmave**<br>• Kontrolli i përputhshmërisë së ndihmave me rregullat doganore për të shmangur abuzimet.<br>• Mbajtja e një regjistri të ndihmave të importuara dhe raportimi mbi përdorimin e tyre. |
| Drejtoria Rajonale e Shërbimit Kombëtar të Punësimit dhe Aftesive | • Koordinimi me institucionet për të mbështetur punëkërkuesit e prekur nga fatkeqësia dhe për të siguruar mundësi punësimi emergjent.<br>• Evidentimi i punëkërkuesve të prekur dhe lehtësimi i ndërmjetësimit për punësim në sektorët me nevoja emergjente.<br>• Mbështetja për punësim të përkohshëm në sektorë kritikë si ndërtimi, pastrimi dhe infrastrukturat emergjente.<br>• Ofrimi i trajnimeve të shpejta për punëkërkuesit e prekur nga fatkeqësia dhe mbështetja për vetëpunësim. |
| Drejtoria Rajonale e Entit Kombëtar të Banesave | • **Vlerësimi i nevojave për strehim emergjent** – Identifikimi i individëve dhe familjeve të pastreha pas fatkeqësive ose emergjencave.<br>• **Bashkëpunimi me autoritetet vendore** – Koordinimi me bashkitë, prefekturat dhe institucionet qendrore për të siguruar strehim emergjent ose alternativa të përkohshme për personat e prekur.<br>• **Monitorimi i gjendjes së banesave** – Identifikimi i dëmeve strukturore të banesave sociale dhe rekomandimi i ndërhyrjeve të nevojshme.<br>• **Zbatimi i programeve të strehimit emergjent** – Lehtësimi i procedurave për aksesin në banesa sociale për familjet e prekura nga emergjenca. |

| | |
|---|---|
| | • **Sigurimi i informacionit për qytetarët e prekur** – Informimi i popullatës mbi mundësitë e strehimit emergjent dhe procedurat për përfitimin e ndihmës për strehim. |
| Agjencia Rajonale e Mjedisit | **Mobilizimi dhe aktivizimi**<br>• Mobilizimi dhe aktivizimi i burimeve për adresimin e emergjencave që ndikojnë në mjedis.<br>• Monitorimi dhe menaxhimi i ndotjeve të shkaktuara nga fatkeqësitë, duke identifikuar zonat me risk të lartë.<br>**Vlerësimi i dëmeve dhe ndikimit mjedisor**<br>• Pjesëmarrja në bashkëpunim me strukturat e tjera për vlerësimin e dëmeve në mjedis.<br>• Identifikimi i rreziqeve mjedisore shtesë të shkaktuara nga emergjenca dhe propozimi i masave mbrojtëse.<br>**Komunikimi dhe Koordinimi**<br>Shkëmbimi i informacionit me institucionet përgjegjëse për menaxhimin e emergjencës dhe autoritetet vendore.<br>Ofrimi i udhëzimeve teknike për minimizimin e pasojave mjedisore dhe zbutjen e ndotjes në zonat e prekura. |
| Shoqëria e Ujësjellës Kanalizimeve Sh.a. | • Mobilizimi dhe aktivizimi i burimeve për furnizimin e vazhdueshëm me ujë në zonat e prekura.<br>• Sigurimi i furnizimit të qëndrueshëm me ujë të pijshëm për popullatën dhe objektet kritike në zonat e prekura nga emergjenca.<br>• Ndërhyrja dhe riparimi i avarive në rrjetin e ujësjellësit për të rikthyer funksionalitetin sa më shpejt të jetë e mundur.<br>Informimi i publikut për ndërprerjet, masat e ndërmarra, dhe këshilla për ruajtjen e higjienës në kushte emergjence.<br>Koordinimi me strukturat e emergjencës për shpërndarjen alternative të ujit dhe asistencën në transportin e ujit në zonat e prekura. |
| Kryqi i Kuq Shqiptar/Degët e Kryqit të Kuq që veprojnë në qark | • Mobilizimi dhe grumbullimi i ekipeve që ndërhyjnë në raste fatkeqësish.<br>• Vlerësimi paraprak i situatës dhe prioritizimi i ndërhyrjeve në zonën më problematike në bashkëpunim me strukturat përkatëse.<br>• Sigurimi i masave të menjëhershme mbrojtëse dhe jetë-shpëtuese për zonat e prekura nga fatkeqësitë duke ofruar ndihmën e parë dhe mbështetje për strehimin emergjent.<br>• Mbledhja dhe raportimi i të dhënave mbi dëmet dhe nevojat e komunitetit, duke bashkëpunuar me autoritetet përkatëse.<br>• Shpërndarja e ndihmave humanitare për grupet më të cenueshme.<br>• Informimi i popullatës për masat e higjienës dhe shëndetit publik në kushte emergjente. |

| | |
|---|---|
| | • Vepron në përputhje me rolin e shoqatës dhe standardet ndërkombëtare në përgjigjen ndaj fatkeqësive.<br>• Ofrimi i mbështetjes psikologjike për të prekurit nga fatkeqësia.<br>• Dega rajonale koordinon punën me KMCB për çdo ndërhyrje gjatë emergjencave |
| Drejtoria Vendore e Policisë Fier/ Komisariatet/Stacionet e Policisë | 1. Mobilizimi i burimeve për operacionet e kërkim-shpëtimit;<br>2. Asistencë në ofrimin e ndihmës së parë në bashkëpunim me strukturat shëndetësore.<br>3. Sigurimi dhe mbikëqyrja e evakuimeve në zonat e rrezikuara.<br>4. Identifikimi dhe dokumentimi i personave të lënduar dhe viktimave në bashkëpunim me shëndetësore dhe autoritetet përkatëse.<br>5. Sigurimi i zonës së emergjencës duke parandaluar hyrjet e paautorizuara dhe shmangur ndërhyrjet që mund të pengojnë operacionet e shpëtimit.<br>6. Ruajtja e rendit dhe qetësisë publike në zonën e emergjencës;<br>7. Menaxhimi i trafikut dhe devijimi i qarkullimit sipas nevojës për të siguruar akses për shërbimet e emergjencës.<br>8. Bashkëpunimi me autoritetet përkatëse për hetimin e shkaqeve të fatkeqësisë dhe vlerësimin e përgjegjësive, nëse është e nevojshme.<br>9. Shoqërimi i automjeteve të emergjencës dhe ndihmës humanitare për të garantuar shpërndarjen e sigurt të ndihmave.<br>10. Angazhimi i burimeve të policisë (automjete, pajisje dhe personel) në mbështetje të operacioneve të emergjencës dhe evakuimit, sipas nevojës dhe kapacitetit.<br>11. Sigurimi i komunikimit të vazhdueshëm me strukturat operacionale përmes radiofonisë dhe kanaleve të tjera të emergjencës, për të garantuar koordinimin efektiv të operacioneve.<br>12. Forcimi i masave të sigurisë në objektet kritike (spitale, qendra qeveritare, infrastrukturë jetike) për të parandaluar incidente shtesë gjatë emergjencës.<br>13. Garantimi i kushteve normale për ekipet e ndihmës ndërkombëtare dhe mediat që raportojnë nga zonat e emergjencës.<br>14. Sigurimi i rendit dhe mbrojtja e zonave të strehimit të përkohshëm për familjet e evakuuara, duke parandaluar hyrjet e paautorizuara dhe garantuar sigurinë e banorëve.<br>15. Monitorimi i situatës dhe mbledhja e informacionit mbi situatën dhe nevojat emergjente.<br>16. Vigjilenca për përballimin e emergjencave të mundshme sekondare dhe gatishmëria për ndërhyrje të menjëhershme. |

## 6.5 / Funksionet e Përgjigjes

### 1. Organizimi, drejtimi dhe koordinimi

- *Në nivel bashkie*: KMCB kryesohet nga kryetari i bashkisë. Ajo është struktura kryesore përgjegjëse për marrjen e masave për menaxhimin gjithëpërfshirës dhe drejtimin e menaxhimit të emergjencave për bashkinë.
- *Në nivel qarku*: KMCQ kryesohet nga prefekti. Ajo është struktura kryesore që merr masa për menaxhimin dhe drejtimin gjithëpërfshirës të menaxhimit të emergjencave për qarkun.
- Për emergjencat kombëtare, kur nuk është shpallur gjendja e fatkeqësisë natyrore, AKMC/MM dhe KMC janë përgjegjëse për organizimin, drejtimin dhe koordinimin.
- Për emergjencat kombëtare, kur është shpallur gjendja e fatkeqësisë natyrore, KNEC është përgjegjëse për organizimin, drejtimin dhe koordinimin.
- Në rast të shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore, për të drejtuar strukturat operacionale caktohen drejtuesit e mëposhtëm të operacioneve:
- DQO në nivel qendror, i cili emërohet nga KNEC;
- DOQ, i cili emërohet nga prefekti;
- DOB, i cili emërohet nga kryetari i bashkisë.

### 2. Aktivizimi dhe koordinimi i strukturave operacionale në nivel qarku.

Aktivizimi i forcave operacionale në nivel qarku, kryhet nga Prefekti i qarkut, ndërsa bashkërendimi i strukturave të Policisë së Shtetit (PSH), Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit (MZSH), Forcave të Armatosura (FA) dhe Shërbimit të Urgjencës Mjekësore (SHUM) në nivel qarku dhe i strukturave që vijnë në ndihmë, janë përgjegjësi e Prefektit, i cili këshillohet nga KMCQ.

### 3. Evakuimi

Evakuimi është një proces i planifikuar për zhvendosjen e popullsisë nga një zonë e rrezikuar ose me një kërcënim të afërt drejt një vendndodhjeje të sigurt. Ky proces mund të jetë i paracaktuar, bazuar në analiza të riskut dhe skenarët e identifikuar të rrezikut, ose i menjëhershëm, kur situata përkeqësohet papritur dhe kërkohet reagim urgjent.

Duke qenë një masë thelbësore për mbrojtjen e jetës dhe pronës, evakuimi kërkon një qasje të koordinuar midis strukturave shtetërore, autoriteteve vendore dhe komunitetit. Një zbatim efektiv siguron që popullsia të zhvendoset në mënyrë të sigurt dhe të organizuar, ndërsa rikthimi në zonat e prekura ndodh vetëm pas vlerësimit dhe garantimit të sigurisë nga autoritetet përgjegjëse.

**Përgjegjësitë institucionale për evakuimin**

- Në nivel bashkiak, përgjegjësia kryesore për planifikimin dhe ekzekutimin e evakuimit i takon kryetarit të bashkisë, duke përfshirë identifikimin e zonave të mundshme të evakuimit në mjediset urbane dhe rurale, bazuar në Vlerësimin e Riskut nga Fatkeqësitë në Nivel Vendor dhe analizat e territorit në kohë reale.
- Në nivel qarku, evakuimi është përgjegjësi e Prefektit të Qarkut, i cili koordinon me bashkitë për të siguruar mbështetje shtesë, burime dhe menaxhimin e evakuimit masiv në situata të gjera emergjente.
- Forcat operacionale në terren, duke përfshirë Forcat e Armatosura, Policinë e Shtetit, Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit, si dhe struktura të tjera, mund të urdhërojnë evakuim të menjëhershëm në territore të kufizuara kur identifikohen kërcënime të menjëhershme për jetën dhe sigurinë publike.

**Prioritetet dhe menaxhimi i evakuimit**

- Evakuimi prioritizon popullsinë në rrezik, duke nisur me individët më të cenueshëm, si të miturit, të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara, gratë shtatzëna dhe të sëmurët.
- Pas popullsisë, evakuohet gjëja e gjallë dhe më pas sendet e domosdoshme shtëpiake, nëse situata e lejon.
- Në rastet kur mundësitë për transport të menjëhershëm janë të kufizuara, evakuimi kryhet në fazat e përparësisë, duke siguruar fillimisht largimin e grupeve më të rrezikuara.

**Zbatimi i evakuimit dhe kthimi në zonën e evakuuar**

- Strukturat përgjegjëse për zbatimin e evakuimit përfshijnë strukturat bashkiake, Policinë e Shtetit, Forcat e Armatosura, institucionet publike dhe operatorët privatë, duke siguruar mbështetje logjistike dhe operacionale.
- Rikthimi i popullsisë në zonën e evakuuar bëhet vetëm pas vlerësimit dhe deklarimit të sigurisë nga autoritetet përgjegjëse.
- Policia e Shtetit merr masa për kontrollin e aksesit në zonën e evakuuar dhe monitoron territorin për të parandaluar hyrjet e paautorizuara dhe veprimtaritë e paligjshme pas emergjencës.
- Për kryerjen e procesit të evakuimit do të angazhohen njësitë e vetëqeverisjes vendore, strukturat e Policisë së Shtetit, të Policisë bashkiake, të shërbimit zjarrfikës, vullnetarë, deri dhe anëtarë të komunitetit.

## 4. Kërkim shpëtimi

Qëllimi i kërkim-shpëtimit është gjetja e vendndodhjes së të lënduarve dhe shpëtimi i atyre që janë ende në rrezik. Ekipet Kombëtare të Kërkimit dhe Shpëtimit (EKKSH) sigurohen nga FA e MM, MB, strukturat e shërbimit zjarrfikës, grupet vullnetare etj. Në rastet e emergjencave civile kombëtare, Operacionet e Kërkimit dhe Shpëtimit (OKSH) mbështeten nga EKKSH dhe strukturat e shërbimit zjarrfikës, PSH, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe grupet ndërkombëtare të kërkim-shpëtimit kur thirren për të ndihmuar.

Në qarkun Fier strukturat që mund të angazhohen në operacionet e kërkim shpëtimit janë strukturat e shërbimit të MZSH-së, të Policisë së Shtetit, si dhe struktura të tjera të kërkim shpëtimit që mund të vijnë ngë institucionet qendrore, si dhe ekipe ndërkombëtare në raste kur ato janë thirrur për ndihmë.

## 5. Ndihma e parë në situata emergjente

Ndihma e parë do të jepet nga SHUM, ekipet e urgjencës, autoambulancat, qendrat shëndetësore dhe nga spitali rajonal në bashkinë ose qarkun përkatës. Të gjitha këto njësi dhe shërbime do të mbështeten nga Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor (NJVKSH).

## 6. Mirëmbajtja e infrastrukturës publike në situata emergjente

Fatkeqësitë mund të dëmtojnë ose shkatërrojnë infrastrukturën publike dhe kritike, si rrjetin rrugor, ujësjellësin, kanalizimet, rrjetin elektrik, telekomunikacionin, etj. Këto shkatërrime kanë pasoja negative për funksionimin ekonomik dhe social të komunitetit. Prefekti në bashkëpunim me bashkitë punojnë me ofruesit e shërbimeve për mbrojtjen, menaxhimin dhe riparimin e infrastrukturës publike gjatë emergjencave dhe fatkeqësive.

Në rastet e shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore, për punimet emergjente për riparimin dhe rikuperimin e infrastrukturës publike dhe kritike, zbatohen dispozitat e ligjit nr. 97/2019 “Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësive natyrore”. Bashkitë duhet të identifikojë strukturat kryesore me përgjegjësi në fushën e rehabilitimit të infrastrukturës publike dhe kritike për të cilat duhet të informojnë dhe prefektin e qarkut.

## 7. Vlerësimi i Nevojave

Koordinimi për vlerësimin e nevojave për emergjenca civile vendore ose rajonale, është nën përgjegjësinë e bashkisë të prekur, të mbështetur nga Prefekti i Qarkut që koordinon degët territoriale dhe kapacitete të tjera në qark, sipas nevojës.

Koordinimi kombëtar i emergjencave civile për vlerësimin e nevojave është nën përgjegjësinë e KNEC kur është shpallur gjendja e fatkeqësisë natyrore, përmes Grupeve të Vlerësimit Ndërinstitucional. Këto grupe mbështeten drejtpërdrejt nga AKMC dhe përmbajnë specialistë nga ministritë e linjës dhe institucione të tjera në varësi.

## 8. Vlerësimi i dëmeve (në aspektin e dëmtimeve të infrastrukturës dhe objekteve të ndërtimit)

Vlerësimi i dëmeve në infrastrukturë dhe ndërtesa për emergjencat shkallës së ulët, sipas rastit, është përgjegjësi e bashkisë në koordinim me Prefektin e Qarkut.

Për infrastrukturën dhe asetet në administrim të ministrive, institucioneve të tjera qendrore dhe subjekteve private, ato janë vetë përgjegjëse kryesore për vlerësimin e dëmeve.
Në rastet e emergjencave të shkallës më të lartë, përgjegjësia kryesore për vlerësimin e dëmeve në infrastrukturë dhe objektet e ndërtimit është e pronarëve apo administratorëve të tyre të cilët do të mbështeten, sipas nevojës, nga grupet e përbashkëta të vlerësimit.

## 9. Identifikimi dhe sigurimi i strehimeve të përkohshme

Vlerësimi i nevojave për strehim dhe identifikimi paraprak i objekteve dhe zonave për sigurimin e vendstrehimeve të përkohshme të sigurta është përgjegjësi e bashkisë e mbështetur nga Prefekti i qarkut. Menaxhimi i strehimit të të evakuuarve gjatë emergjencës është përgjegjësi e bashkisë e mbështetur nga Prefekti i qarkut, të mbështetur nga AKMC/ DQO në nivel qendror.

Duhet të sigurohet që grupet më të cenueshme të mos diskriminohen në planifikimin, hartimin ose caktimin e strehimit të përkohshëm pas fatkeqësisë, i cili duhet të jetë i arritshëm dhe funksional në përputhje me nevojat e tyre. Ata nuk duhet të diskriminohen as në caktimin e strehimeve të përkohshme dhe as në banesat e përhershme.

## 10. Sigurimi dhe shpërndarja e ndihmës

*Emergjencat civile vendore dhe rajonale*

Dhënia e ndihmës së parë ushqimore dhe ndihmave të tjera gjatë një situate emergjente kryhet nga bashkia nëpërmjet mobilizimit të kapaciteteve të saj, bazuar në PVEC. Bashkia mund të kërkojë edhe angazhimin e kapaciteteve të subjekteve të tjera qeveritare dhe jo-qeveritare si dhe të bizneseve. Nëse është e nevojshme, për këtë qëllim kërkon edhe mbështetjen e prefektit të qarkut.

*Emergjencat civile kombëtare për të cilat shpallet gjendja e fatkeqësisë natyrore*

Koordinimi për sigurimin, furnizimin, magazinimin dhe shpërndarjen e artikujve të ndihmës kombëtare kryhet nga DOQ/AKMC në bashkëpunim me DPRMSH, prefektin dhe bashkinë. Në nivel kombëtar shpërndarja e ndihmave koordinohet nga AKMC. Në nivel vendor nga prefekti dhe organet e qeverisjes vendore, në bashkëpunim të ngushtë me strukturat e MSH (për asistencën me barnat), vullnetarët dhe Kryqin e Kuq.

## 11. Shëndeti publik

Shërbimi shëndetësor përbëhet nga shërbimi shëndetësor parësor ku futen qendrat shëndetësore, ambulancat, klinikat etj, si dhe shërbimi shëndetësor dytësor (spitalor). NJVKSH është përgjegjëse për Ndihmën e Parë Shëndetësore në nivel bashkie/qarku. Ajo është përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve emergjente dhe kujdesit parësor shëndetësor përmes qendrave/ klinikave shëndetësore.

NJVKSH dhe Inspektorati Shtetëror Shëndetësor (ISHSH) janë përgjegjës për monitorimin e cilësisë së ujit të pijshëm dhe higjienës, si dhe për zbatimin e programit të vaksinimit të popullatës. Në qarkun Fier, ushtrojnë veprimtarinë e tyre Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Fier (NJVKSH), e cila mbulon 18 qendra shëndetësore, NJVKSH Lushnjë e cila mbulon 17 qendra shëndetësore dhe NJVKSH Mallakastër e cila mbulon 5 qendra shëndetësore. Funksionojnë 4 spitale, Spitali Memorial Fier, Spitali Rajonal Fier, Spitali Lushnjë dhe Spitali Mallakastër.

## 12. Shërbimet e Ndihmës Sociale, mbështetja psikosociale/zvogëlimi i panikut

Mbështetja psiko-sociale në emergjenca është thelbësore për të ndihmuar individët dhe komunitetet të përballen me ndikimet psikologjike dhe sociale të krizave, të tilla si fatkeqësitë natyrore, konfliktet e armatosura ose ndërprerjet e rëndësishme të jetës. Ky PQEC fokusohet në elementët kryesorë të mbështetjes shëndetësore mendore, si:

- Mbështetje emocionale e menjëhershme
- Sigurimi i një ndjenje sigurie dhe qetësie. Kjo mund të përfshijë ndihmën e parë psikologjike, e cila përfshin dëgjimin aktiv, sigurinë dhe ndihmën e njerëzve për të rivendosur njëfarë ndjenje të normalitetit.
- Nevojat dhe shërbimet bazë
- Sigurimi i aksesit në ushqim, strehim, kujdes mjekësor dhe nevoja të tjera bazë, pasi mungesa e tyre mund të përkeqësojë stresin dhe traumën.
- Rrjetet e mobilizimit dhe mbështetjes së komunitetit
- Forcimi ose rindërtimi i rrjeteve të komunitetit për të ofruar lidhje dhe mbështetje sociale, të cilat mund të jenë një mbrojtës jetik kundër stresit.
- Qasja në shërbimet e shëndetit mendor
- Ofrimi i këshillimit, terapisë ose grupeve të organizuara mbështetëse për individët ose familjet, duke i ndihmuar ata të përpunojnë emocionet dhe përvojat.
- Edukimi dhe hapësira miqësore për fëmijët
- Krijimi i mjediseve ku fëmijët mund të luajnë, të mësojnë dhe të rifitojnë ndjenjën e rutinës, stabilitetit dhe normalitetit. Drejtoria e Shërbimeve Sociale në Bashki ka rolin drejtues në këtë funksion.
- Mbështetja psikosociale për forcat e reagimit ndaj emergjencave.

Zjarrfikësit, policia, personeli mjekësor dhe punonjësit e ndihmës hasin në situata stresuese dhe traumatike gjatë përgjigjes në raste emergjencash apo fatkeqësish.
Mbështetja psikosociale për forcat e përgjigjes pas emergjencave është thelbësore për mirëqenien dhe efektivitetin e tyre. Një qasje gjithëpërfshirëse që përfshin diskutimin, mbështetjen e kolegëve, këshillimin, menaxhimin e stresit, mbështetjen organizative i ndihmon forcat e përgjigjes që të menaxhojnë sfidat emocionale dhe psikologjike me të cilat përballen në mjediset me stres të lartë.

### 13. Logjistika (transport, magazinim, etj.)

Në rastet e emergjencave civile ne nivel qarku, nevojat për shërbime transporti dhe ruajtjeje në përgjithësi plotësohen nga vetë kapacitetet e qarkut. Kur qarku nuk ka kapacitetet e nevojshme, i drejtohet qarqeve fqinjë për të koordinuar sigurimin e kapaciteteve shtesë. Prefekti mund të kërkojë, në sigurimin e kapaciteteve të caktuara të subjekteve private ose OJF-ve sipas deklaratave të tyre të marra zyrtarisht në periudhën para fatkeqësisë. Gjithashtu, nëse dhe me këto kapacitete nuk është e mundur përballimi i situatës së emergjencës civile, Prefekti i drejtohet AKMC-së.

### 14. Bashkimi familjar

Kur ndodh një fatkeqësi, ndodh shpesh që familjarët apo të afërmit të ndahen dhe të humbasin lidhjet me njëri-tjetrin dhe për rrjedhojë, bëhet e nevojshme rivendosja e lidhjeve familjare. Shërbimet e ribashkimit ofrojnë ndihmë për fëmijët e ndarë nga prindi/kujdestari ligjor, si dhe të rriturit nga familjet e tyre, për shkak të fatkeqësisë, si dhe mbështesin përpjekjet e ribashkimit në nivel lokal ose më gjerë me asistencë teknike.

Rolin kryesor në këtë funksion e ka Drejtoria e Shërbimit Social në Bashki, Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror, të cilat punojnë në bashkëpunim të ngushtë me NJVKSH për vlerësimin e këtyre nevojave.

### 15. Rendi dhe siguria publike

Për situata të jashtëzakonshme, çështjet e sigurisë drejtohen nga Presidenti i Republikës, këshillohen nga Këshilli i Sigurisë Kombëtare dhe mbështeten nga MM, Shërbimi Informativ Shtetëror dhe prefekti i qarkut dhe kryetari i bashkisë. Në rastet e emergjencës kombëtare, kur është shpallur gjendja e fatkeqësisë natyrore, përgjegjësia e përgjithshme për sigurinë dhe rendin publik i përket KNEC nëpërmjet strukturave të PSH, FA dhe autoriteteve në nivel qarku e bashkie nëpërmjet strukturave së tyre.

Në nivel qarku masat e sigurisë, ruajtja e rendit publik dhe kontrolli i qarkullimit sigurohen përkatësisht nëpërmjet strukturave të Drejtorisë Vendore të Policisë Fier, Komisariatëve të Policisë dhe stacioneve të Policisë në bashki, të cilat do të mbështeten dhe nga strukturat e Policisë Bashkiake.

Në të gjitha rastet e emergjencave, në nivel bashkie, rolin kryesor në zbatimin e ligjit dhe masat e ruajtjes së rendit do ta ketë Komisariati/stacioni i Policisë i mbështetur nga Policia Bashkiake. Në raste të veçanta do të mbështeten edhe nga FA. E rëndësishme në rastet e evakuimeve është si mbrojtja e vendbanimeve të braktisura për shkak të emergjencës ndaj autorëve, ashtu edhe mbrojtja e qendrave të pritjes dhe strehimit.

# 7. Rimëkëmbja

## 7.1 / Parimet e rimëkëmbjes dhe zbatimi i tyre në Qarkun Fier

Rimëkëmbja është faza që pason Përgjigjen emergjente dhe ka si qëllim rivendosjen e funksioneve kritike dhe ndihmën për komunitetet e prekura. Për të garantuar një rimëkëmbje efektive, është e nevojshme një qasje e koordinuar mes bashkive të Qarkut Fier dhe Institucionit të Prefektit, duke u mbështetur në Planin Vendor për Emergjencat Civile (PVEC), në Planin e Qarkut për Emergjencat Civile (PQEC) dhe Planin Kombëtar për Emergjencat Civile (PKEC).

Në këtë kuadër, planifikimi i zonave të emergjencës dhe strukturave për pritjen e popullsisë së zhvendosur është thelbësor. Këto zona duhet të jenë të sigurta dhe të mos preken nga rreziqe të mundshme, duke siguruar strehim të përkohshëm, qasje në shërbime bazë dhe ndihmë sociale gjatë periudhës së rimëkëmbjes. Gjithashtu, menaxhimi i mbetjeve dhe rrënojave nga fatkeqësitë duhet të realizohet në përputhje me standardet kombëtare dhe mjedisore për të shmangur rreziqe të mëtejshme.

Në nivel programor, faza e rimëkëmbjes në Qarkun Fier duhet të ndjekë parimet e PKEC, duke përfshirë masa afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, të cilat synojnë:

- Rivendosjen e shërbimeve thelbësore dhe infrastrukturës kritike;
- Sigurimin e mbështetjes sociale dhe ekonomike për komunitetet e prekura;
- Forcimin e kapaciteteve vendore për përballimin e emergjencave të ardhshme.

Në raste emergjencash rajonale dhe kombëtare, Prefekti i Qarkut Fier dhe KMCQsigurojnë monitorimin dhe mbështetjen teknike për procesin e rimëkëmbjes, duke u koordinuar me institucionet qendrore dhe organizatat humanitare për ndihmën e nevojshme.

| Masat afatshkurtra (ditë) | Masat afatmesme (javore, mujore) | Masat afatgjata (muaj, vite) |
|---|---|---|
| • **Strehimi dhe kujdesi emergjent**– Ofrimi i strehimit të përkohshëm dhe shërbimeve të emergjencës për popullsinë e prekur.<br>• **Mbetjet/Infrastruktura** – Pastrimi i akseve kryesore të transportit.<br>• **Sektori tregtar** – Krijimi i infrastrukturës së përkohshme për mbështetjen e rihapjes së bizneseve<br>• **Aspektet psikosociale** – Identifikimi i të rriturve dhe fëmijëve që kanë nevojë për këshillim psikosocial dhe fillimi i trajtimit të përshtatshëm shëndetësor.<br>• **Shëndeti Publik dhe Kujdesi Shëndetësor** – Sigurimi i kujdesit mjekësor urgjent dhe të përkohshëm, si dhe krijimi i protokolleve të përshtatshme të mbikëqyrjes.<br>• **Aktivitetet lehtësuese/zbutëse** – Vlerësimi i risqeve dhe cenueshmërive | • **Strehimi dhe kujdesi emergjent** – Sigurimi i zgjidhjeve të aksesueshme dhe të qëndrueshme për strehimin.<br>• **Mbetjet/Infrastruktura** - Fillimi i largimit të mbetjeve dhe rrënojave, si edhe planifikimi i riparimeve dhe restaurimit të menjëhershëm të infrastrukturës së dëmtuar.<br>• **Sektori tregtar** – Mbështetja e rimëkëmbjes dhe rifillimit të bizneseve aty ku është e realizueshme.<br>• **Aspektet psikosociale** – Angazhimi i rrjeteve mbështetëse për ofrimin e kujdesit dhe mbështetjes së vazhdueshme.<br>• **Shëndeti Publik dhe Kujdesi Shëndetësor** – Sigurimi i vazhdimësisë së shërbimeve shëndetësore përmes strukturave të përkohshme, sipas nevojës.<br>• **Aktivitetet lehtësuese/zbutëse** – Informimi i komunitetit mbi mundësitë për një rindërtim më të qëndrueshëm dhe të sigurt. | • **Strehimi dhe kujdesi emergjent** – zgjidhje të përhershme strehimi<br>• **Mbetjet/Infrastruktura** – Rindërtimi i infrastrukturës në funksion të nevojave të ardhshme të komunitetit.<br>• **Sektori tregtar** – Zbatimi i strategjive të rigjallërimit ekonomik.<br>• **Aspekte psikosociale** – Vijimi i programeve të këshillimit psikosocial dhe mbështetjes shëndetësore për komunitetin e prekur.<br>• **Shëndeti publik dhe kujdesi shëndetësor** – Rimëkëmbja dhe rehabilitimi i objekteve të dëmtuara të kujdesit shëndetësor.<br>• **Aktivitetet lehtësuese/zbutëse** – Zbatimi i strategjive dhe masave të lehtësimit/zbutjes. |

Në çdo qark, aktivitetet duhet të zhvillohen sipas madhësisë dhe karakteristikave të tij, duke u integruar në qasjen e përgjithshme rajonale/kombëtare të rimëkëmbjes.

## 7.2 / Aktivitetet afatshkurtra

### 1. Ndihma për popullatën

Në rast emergjencash, Prefekti i Qarkut Fier dhe KMCQ koordinojnë me bashkitë e qarkut dhe Qendrat Operacionale të Emergjencave Civile (QOEC) për të siguruar ndihmën e menjëhershme për popullatën e prekur.

Në masat e menjëhershme përfshihen:

- Hapja dhe pajisja e qendrave emergjente të strehimit me dyshekë, batanije, çarçafë dhe furnizime bazë.
- Koordinimi i ekipeve humanitare për të mbështetur popullatën në qendrat e strehimit.
- Organizimi i ekipeve të ndihmës dhe shërbimeve shëndetësore për të ofruar ndihmën e parë dhe regjistrimin e të prekurve.
- Sigurimi dhe shpërndarja e furnizimeve bazë ushqimore dhe përgatitja e vakteve për personat e evakuuar.

Në këtë kuadër, Prefekti i qarkut Fier dhe KMCQ mbështesin bashkitë në menaxhimin dhe shpërndarjen e ndihmave, duke bashkërenduar veprimet me institucionet kombëtare dhe organizatat ndërkombëtare të ndihmës humanitare.

### 2. Rivendosja e infrastrukturës dhe shërbimeve

Gjatë periudhës afatshkurtër strukturat operacionale në nivel qarku janë përgjegjëse për rehabilitimin e infrastrukturave të zëna nga mbeturinat, rrënojat, mbetjet e përmbytjeve, mbetjet e grumbulluara nga popullata e prekur nga ngjarja. Punime tepër urgjente duhet të kryhen për rehabilitimin e rrugëve dhe infrastrukturës teknologjike që mund të jenë dëmtuar.

## 7.3 / Aktivitetet afatmesme

### 1. Ndihma për popullatën

Në periudhën afatmesme të rimëkëmbjes, Prefekti i Qarkut Fier dhe KMCQ koordinojnë me bashkitë e qarkut për të mundësuar kthimin e popullatës në banesat e tyre dhe për të siguruar zgjidhje alternative për familjet me shtëpi të pabanueshme.

Në masat kryesore përfshihen:

- Verifikimi i kushteve të strehimit dhe vlerësimi i sigurisë së banesave për rikthimin e banorëve.
- Sigurimi i opsioneve të përkohshme të strehimit, përfshirë marrëveshjet me sektorin e hotelerisë për akomodimin e familjeve të prekura, me afat maksimal prej 30-60 ditësh.
- Koordinimi me AKMC dhe organizatat humanitare për financimin dhe mbështetjen e familjeve të prekura.

Në këtë kuadër, Prefekti i qarkut Fier dhe KMCQ ndihmojnë në negociatat dhe nënshkrimin e marrëveshjeve ndërmjet shoqatave të hotelerisë dhe institucioneve vendore, duke përcaktuar kostot dhe mekanizmat e mbulimit të shpenzimeve për akomodim dhe ushqim.

**2. Rivendosja e infrastrukturës dhe shërbimeve**

Në periudhën afatmesme, Prefekti i Qarkut Fier dhe KMCQ udhëheqin përpjekjet për vlerësimin dhe restaurimin e infrastrukturës së dëmtuar, duke mbështetur bashkitë për mobilizimin e fondeve dhe burimeve.

Prioritetet kryesore përfshijnë:

- Hartimin e një vlerësimi të plotë të dëmtimeve infrastrukturore nga ekipet teknike dhe ekspertët.
- Rindërtimin e rrjetit të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe gaz për të siguruar kthimin e kushteve normale të jetesës.
- Riparimin e rrugëve, urave dhe shërbimeve kritike për të lehtësuar lëvizjen dhe aktivitetet ekonomike.
- Koordinimin me institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare për mbështetje financiare dhe asistencë teknike.

Prefekti i qarkut siguron bashkërendimin midis bashkive dhe qeverisë qendrore, duke kanalizuar burimet financiare për përmirësimin e infrastrukturës rajonale.

**3. Kujdesi shëndetësor**

Në periudhën afatmesme, fokusi zhvendoset nga menaxhimi i emergjencës tek shërbimet e qëndrueshme shëndetësore për komunitetin.

Masat kryesore përfshijnë:

- Sigurimin e vijueshmërisë së shërbimeve shëndetësore për të prekurit nga emergjenca.
- Monitorimin e shëndetit publik për të parandaluar përhapjen e sëmundjeve infektive.
- Trajtimin e pacientëve me nevoja të vazhdueshme mjekësore, përfshirë shërbime psiko-sociale për të prekurit.
- Koordinimin me spitale rajonale dhe qendrat shëndetësore për të garantuar kapacitete të mjaftueshme trajtimi.

Prefekti i Qarkut Fier mobilizon mbështetjen mjekësore në nivel qarku, duke përfshirë ndihmën nga organizatat shëndetësore dhe donatorët ndërkombëtarë.

**4. Aktivitete prodhuese**

Në periudhën afatmesme, përpjekjet për rimëkëmbjen ekonomike shtrihen përtej ndihmës humanitare dhe synojnë rikthimin e aktivitetit normal ekonomik në Qarkun Fier.

Masat kryesore përfshijnë:

- Identifikimin e dëmeve të biznesit dhe industrisë lokale për të përcaktuar nevojat financiare dhe logjistike.
- Pastrimin e zonave industriale dhe komerciale nga rrënojat dhe mbetjet e përmbytjeve.
- Zhvillimin e një plani mbështetës për bizneset e dëmtuara, duke përfshirë akses në fonde emergjente dhe kredi të buta për rigjallërimin e ekonomisë vendore.
- Mbështetjen e fermerëve dhe sektorit bujqësor për të rivendosur prodhimin dhe për të parandaluar humbjet e mëtejshme.
- Angazhimin e sektorit privat dhe donatorëve ndërkombëtarë për investime në rimëkëmbjen ekonomike dhe krijimin e vendeve të punës.

Prefekti i qarkut Fier koordinon këto aktivitete me ministritë përkatëse dhe donatorët ndërkombëtarë, duke garantuar një qasje të organizuar dhe të qëndrueshme për rigjallërimin ekonomik.

## 7.4 / Aktivitetet Afatgjata

Periudha afatgjatë e rimëkëmbjes mund të zgjasë me muaj apo vite dhe kërkon bashkërendimin e institucioneve kombëtare dhe vendore për të siguruar zgjidhje të qëndrueshme për popullatën dhe rimëkëmbjen e infrastrukturës.

Në këtë kuadër, Prefekti i Qarkut Fier bashkëpunon me qeverinë qendrore dhe organizatat ndërkombëtare për të kanalizuar fondet dhe burimet drejt aktiviteteve rimëkëmbëse.

**Ndihma për popullatën**

Në periudhën afatgjatë, fokusi kryesor është sigurimi i zgjidhjeve të qëndrueshme për familjet që kanë humbur banesat e tyre si pasojë e fatkeqësive.
Opsionet kryesore përfshijnë:

- Ndërtimi i zgjidhjeve të përkohshme të banimit, si komplekse strehimi rezistente ndaj fatkeqësive.
- Sigurimi i kontributeve për qira, duke mbështetur familjet e prekura me ndihma financiare për strehim.

- Mbështetje për rikonstruksionin e shtëpive, përmes fondeve të rindërtimit dhe lehtësive financiare për individët dhe familjet e prekura.
- Koordinimi me programet qeveritare të strehimit, për të garantuar që familjet në nevojë të kenë qasje në programe të qëndrueshme banimi.

  Në këtë proces, Prefekti i Qarkut Fier luan një rol kyç në monitorimin dhe mbikëqyrjen e shpërndarjes së fondeve, duke u siguruar që prioritetet të jenë të përcaktuara qartë dhe të ndjekin parimet e zhvillimit të qëndrueshëm.

### 1. Rimëkëmbja e infrastrukturës dhe shërbimeve

Në periudhën afatgjatë, qëllimi kryesor është rikonstruksioni i plotë i infrastrukturës kritike, duke përfshirë masa të reja për zvogëlimin e riskut dhe përmirësimin e kapaciteteve mbrojtëse ndaj fatkeqësive të ardhshme.

Prioritetet kryesore përfshijnë:

- Planifikimi i projekteve të mëdha për rindërtimin e rrugëve, urave dhe infrastrukturës kritike për të rritur sigurinë dhe funksionalitetin e tyre.
- Zhvillimi i planeve të urbanizimit dhe planifikimit hapësinor për të siguruar ndërtim të qëndrueshëm dhe më të sigurt.
- Investimi në sisteme të reja të kanalizimeve dhe menaxhimit të ujërave të shiut, për të zvogëluar riskun nga përmbytjet.
- Përforcimi i rrjetit të shpërndarjes së energjisë dhe furnizimit me ujë, duke përdorur standarde moderne për të rritur sigurinë dhe aftësinë ripërtëritëse ndaj fatkeqësive.
- Përdorimi i teknologjive të reja për monitorimin dhe parandalimin e emergjencave, përmes sistemeve të avancuara të paralajmërimit të hershëm dhe vlerësimit të riskut.

Në periudhën afatgjatë, Prefekti i Qarkut Fier luajnë një rol kyç në sigurimin e burimeve financiare dhe mbikëqyrjen e projekteve të rindërtimit, duke bashkëpunuar me ministritë përkatëse dhe partnerët ndërkombëtarë.

### 2. Kujdesi shëndetësor

Në periudhën afatgjatë, kujdesi shëndetësor zhvendoset nga ndihma emergjente në përmirësimin e qëndrueshëm të sistemit shëndetësor dhe shërbimeve sociale.

Masat kryesore përfshijnë:

- Rivendosja e plotë e kapaciteteve të spitaleve dhe qendrave shëndetësore të dëmtuara nga fatkeqësitë.
- Zhvillimi i një sistemi të integruar të monitorimit shëndetësor, për të garantuar ndjekjen e të prekurve në periudhën afatgjatë.

- Rritja e kapaciteteve për shërbimet psiko-sociale, për të ndihmuar individët dhe komunitetet që kanë pësuar trauma nga fatkeqësia.
- Forcimi i sistemit shëndetësor në qark, duke përfshirë investime në infrastrukturën shëndetësore dhe trajnime për personelin mjekësor.

Në periudhën afatgjatë, Prefekti i Qarkut Fier siguron mobilizimin e fondeve dhe asistencës teknike, duke punuar me institucionet shëndetësore kombëtare dhe ndërkombëtare për të përmirësuar sistemin shëndetësor dhe garantuar një përgjigje të qëndrueshme ndaj krizave të ardhshme.

## 7.5 / Roli i institucioneve, strukturave dhe aktorëve të tjerë institucionalë gjatë rimëkëmbjes

**Tabela 9:** Strukturat dhe përgjegjësitë e tyre në fazën e rimëkëmbjes – Qarku Fier

| **Institucionet dhe palët e përfshira** | **Përgjegjësitë kryesore në fazën e rimëkëmbjes** |
|---|---|
| | **Përgjegjësitë në fazën e rimëkëmbjes** |
| **Prefekti i Qarkut Fier**<br>Sektori i Planifikimit, Përballimit të Emergjencave Civile dhe Krizave | • Vepron si autoriteti qendror për koordinimin e përpjekjeve të rimëkëmbjes midis shumë institucioneve, strukturave brenda qarkut.<br>• Krijon një strukturë të unifikuar komanduese për të përmirësuar komunikimin dhe vendimmarrjen ndërmjet aktorëve institucionalë.<br>• Zhvillon një plan rimëkëmbjeje që prioritizon nevojat kritike si strehimi, shërbimet komunale dhe transporti. Identifikon dhe shpërndan burime, përfshirë personelin dhe pajisjet, për të mbështetur përpjekjet vendore të rimëkëmbjes.<br>• Bashkëpunon me organizatat kombëtare dhe ndërkombëtare për sigurimin e mbështetjes teknike dhe fondeve.<br>• Siguron koordinimin e veprimtarive të rimëkëmbjes për infrastrukturën kritike si rrugët, urat, shërbimet komunale dhe ndërtesat publike.<br>• Raporton rregullisht mbi progresin dhe sfidat e rimëkëmbjes. |
| Sektori Juridik | • Verifikon ligjshmërinë e akteve ligjore që kanë lidhje me cështje të emergjencave civile të nxjerra nga njësitë e vetëqeverisjes vendore në kuadër të rimëkëmbjes.<br>• Jep asistencë Sektorit të Planifikimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile dhe Krizave pranë Administratës së Prefektit për interpretim të ndryshëm ligjor dhe për hartimin e akteve të ndryshme ligjore. |

| | |
|---|---|
| Sektori i Monitorimit të Kompetencave Vendore dhe Funksioneve té Deleguara | • Bashkërendon punën me organet e njësive të vetëqeverisjes vendore në fushën e gjatë procesit të rimëkëmjes, duke mbajtur parasysh vlerësimin e riskut të fatkeqësive në nivel qarku, në mënyrë që mos të krijohen risqe të reja të fatkeqësive.<br>• Ndjek problemet në lidhje me higjenën, problemet shëndetësorë, të emergjencave civile etj gjatë procesit të rimëkëmbjes.,<br>• Koordinon punën me intsituticionet në nivel qarku për konsultimet me njësitë e vetëqeverisjes vendore për politikat dhe legjislacionin në kuadrin e rimëkëmbjes |
| Sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse | Mbështet Sektorin e Planifikimit, Përballimit të Emergjencave Civile dhe Krizave për sa i takon nevojës për të grumbulluar të dhëna dhe për të hartuar evidenca në lidhje me cështjet financiare që kanë lidhje me procesin e rimëkëmbjes. |
| Sektori i Zhvillimit Urban | • Monitoron njësitë e vetëqeverisjes vendore lidhur me masat që marrin për mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm.<br>• Përgatit raporte dhe informacione në mënyrë të vazhdueshme në lidhje me mbledhjen dhe largimin e mbetjeve shtëpiake dhe të ngurta.<br>• Mbledh informacione në lidhje me problematikat e rrugëve rurale dhe urbane në nivel qarku dhe sipas rastit informon prefektin. |
| Regjimenti i Këmbësorisë së Jugut<br>Reparti Ushtarak i Poshnjes | • Mbështesin rehabilitimin e infrastrukturës kritike, si rrugët dhe urat, kur autoritetet civile nuk disponojnë kapacitete të mjaftueshme.<br>• Sigurojnë pajisje të rënda dhe personel për heqjen e mbeturinave, pastrimin e rrugëve dhe ndërtimin e strehimoreve emergjente.<br>• Mbështesin logjistikën dhe ruajtjen e integritetit të pikave të shpërndarjes së ndihmës.<br>• Sigurojnë asistencë mjekësore dhe mbështetje evakuimi për individët e lënduar në rastet kur spitalet janë të mbingarkuara. |
| Operatori i Sistemit të Transmetimit OST Fier | • **Vlerësimi i infrastrukturës**. Kryerja e një vlerësimi gjithëpërfshirës të infrastrukturës energjetike, duke përfshirë nënstacionet dhe linjat e transmetimit, në bashkëpunim me autoritetet vendore dhe qendrore.<br>• **Prioritet për objektet kritike** – Identifikimi dhe restaurimi i menjëhershëm i energjisë në objektet kritike si spitalet, qendrat e emergjencës dhe furnizimet me ujë.<br>• **Rikthimi gradual i energjisë** – Koordinimi për të siguruar furnizimin e qëndrueshëm me energji elektrike, duke përdorur zgjidhje të përkohshme si gjeneratorët në zonat ku riparimet kërkojnë kohë.<br>• **Siguria e komunitetit** – Informimi i popullsisë për përdorimin e sigurt të energjisë dhe kufizimet e mundshme gjatë fazës së rimëkëmbjes. |

| | |
|---|---|
| | • **Modernizimi i rrjetit –** Integrimi i masave për rritjen e aftësisë ripërtëritëse ndaj fatkeqësive, përfshirë përdorimin e teknologjive të avancuara si kabllot nëntokësore.<br>• **Monitorimi dhe masa parandaluese –**Vëzhgimi i vazhdueshëm i rrjetit për të parandaluar ndërprerjet dytësore dhe rreziqet si zjarret apo mbingarkesat elektrike.<br>• **Mbështetja për investime afatgjata –** Promovimi i investimeve në sistemet e ruajtjes së energjisë dhe burimet alternative për të forcuar qëndrueshmërinë e rrjetit pas fatkeqësive. |
| Drejtoria Rajonale e OSHEE-së | • **Vlerësimi i dëmeve –** Kryerja e një vlerësimi të hollësishëm të dëmeve në rrjetin e shpërndarjes, kabinat elektrike dhe transformatorët për të përcaktuar nevojat për riparim dhe restaurim.<br>• **Restaurimi i furnizimit me energji –** Rikthimi gradual i energjisë për konsumatorët, duke i dhënë përparësi objekteve kritike si spitalet, qendrat e emergjencës dhe infrastrukturës publike.<br>• **Zbatimi i zgjidhjeve të përkohshme –** Vendosja e zgjidhjeve të përkohshme si gjeneratorët për zonat ku rikuperimi i plotë kërkon më shumë kohë.<br>• **Siguria e rrjetit –** Monitorimi i rrjetit të shpërndarjes për të parandaluar mbingarkesat dhe rreziqet elektrike gjatë fazës së rimëkëmbjes.<br>• **Informimi i komunitetit –** Komunikimi i qartë me qytetarët për ndërprerjet e planifikuara, përdorimin e sigurt të energjisë dhe kufizimet e furnizimit.<br>• **Riparimi dhe modernizimi –** Restaurimi dhe përmirësimi i rrjetit të shpërndarjes duke integruar masa për rritjen e qëndrueshmërisë ndaj fatkeqësive në të ardhmen.<br>• **Koordinimi me institucionet –** Bashkëpunimi me autoritetet vendore dhe qendrore për të siguruar burimet dhe mbështetjen e nevojshme për rimëkëmbjen e rrjetit të shpërndarjes. |
| Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare Durrës | • **Vlerësimi i dëmeve –** Kryerja e një vlerësimi gjithëpërfshirës të dëmeve të vendeve të trashëgimisë kulturore, muzeve, bibliotekave, arkivave dhe pasurive të tjera kulturore.<br>• **Dokumentimi dhe planifikimi –** Identifikimi dhe dokumentimi i dëmeve dhe humbjeve ndaj objekteve kulturore dhe trashëgimisë jo-materiale, të tilla si traditat ose praktikat e prekura nga fatkeqësia, duke siguruar një bazë për prioritetet e rimëkëmbjes.<br>• **Stabilizimi dhe mbrojtja –** Zbatimi i masave për stabilizimin dhe mbrojtjen e vendeve dhe objekteve kulturore të dëmtuara nga përkeqësimi ose humbja e mëtejshme.<br>• **Restaurimi dhe ruajtja –** Bashkëpunimi me ekspertë të restaurimit për mbrojtjen dhe rikthimin e objekteve kulturore sipas standardeve ndërkombëtare. |

| | |
|---|---|
| | • **Vlerësimi i dëmeve –** Kryerja e një vlerësimi gjithëpërfshirës të dëmeve të vendeve të trashëgimisë kulturore, muzeve, bibliotekave, arkivave dhe pasurive të tjera kulturore.<br>• **Dokumentimi dhe planifikimi –** Identifikimi dhe dokumentimi i dëmeve dhe humbjeve ndaj objekteve kulturore dhe trashëgimisë jo-materiale, të tilla si traditat ose praktikat e prekura nga fatkeqësia, duke siguruar një bazë për prioritetet e rimëkëmbjes.<br>• **Stabilizimi dhe mbrojtja –** Zbatimi i masave për stabilizimin dhe mbrojtjen e vendeve dhe objekteve kulturore të dëmtuara nga përkeqësimi ose humbja e mëtejshme.<br>• **Restaurimi dhe ruajtj**a –Bashkëpunimi me ekspertë të restaurimit për mbrojtjen dhe rikthimin e objekteve kulturore sipas standardeve ndërkombëtare.<br>• **Mbështetja institucionale dhe financiare –** Koordinimi me qeveritë lokale, organizatat ndërkombëtare (p.sh. UNESCO) dhe institucionet kulturore, për të siguruar mbështetje teknike dhe financiare për restaurimin dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore.<br>• **Rifillimi i aktiviteteve kulturore**: Lehtësimi i rikthimit të festivaleve, ekspozitave dhe aktiviteteve të tjera kulturore për të rivendosur angazhimin e komunitetit.<br>• **Ndërgjegjësimi dhe edukimi –** Promovimi i fushatave për sensibilizimin e komunitetit mbi rëndësinë e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore.<br>• **Përfshirja e komunitetit –** Angazhimi i komunitetit në përpjekjet për ruajtjen dhe restaurimin e trashëgimisë kulturore.<br>• **Dixhitalizimi dhe arkivimi –** Krijimi i kopjeve dixhitale të pasurive kulturore për t'i mbrojtur nga dëmtimet e mundshme në fatkeqësi të ardhshme.<br>• **Përfshirja e komunitetit –** Angazhimi i komunitetit në përpjekjet për ruajtjen dhe restaurimin e trashëgimisë kulturore.<br>• **Dixhitalizimi dhe arkivimi –** Krijimi i kopjeve dixhitale të pasurive kulturore për t'i mbrojtur nga dëmtimet e mundshme në fatkeqësi të ardhshme. |
| Agjencia Rajonale e Mjedisit | **Vlerësimi dhe Monitorimi i Dëmeve Mjedisore**<br>• Kryerja e vlerësimeve gjithëpërfshirës të ndikimeve mjedisore të shkaktuara nga fatkeqësia, duke përfshirë ndikimet në tokë, ujë, cilësinë e ajrit dhe biodiversitetin, në bashkëpunim me institucione përkatëse dhe ekspertë të fushës.<br>• Identifikimi dhe prioritizimi i zonave që kërkojnë rehabilitim të menjëhershëm mjedisor, duke i adresuar ato në koordinim me autoritetet lokale dhe qendrore.<br>• Monitorimi i rreziqeve dytësore mjedisore, si rrëshqitjet e dheut, përmbytjet ose ndotja nga materialet e rrezikshme, dhe zbatimi i masave parandaluese për të shmangur dëme të mëtejshme. |

| | |
|---|---|
| | **Rehabilitimi i Mjedisit dhe Ekosistemeve**<br>• Zbatimi i programeve për restaurimin e ekosistemeve të dëmtuara, të tilla si ripyllëzimi, restaurimi i ligatinave dhe restaurimi i habitateve të specieve të egra, në përputhje me standardet e ruajtjes së mjedisit.<br>• Trajtimi i efekteve të fatkeqësisë mbi mjedisin, si erozioni i tokës, ndotja e ujit dhe ajrit, për të rivendosur ekuilibrin ekologjik.<br>• Bashkëpunimi me agjenci të tjera për të siguruar asgjësim të sigurt të mbetjeve dhe materialeve të rrezikshme nga fatkeqësia në përputhje me rregulloret mjedisore.<br>• Promovon përfshirjen e masave të përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike në përpjekjet për rimëkëmbje, të tilla si ndërtimi i barrierave natyrore ose rehabilitimi i ekosistemeve që ndihmojnë në zbutjen e ndikimeve të ardhshme mjedisore.<br>**Ndërgjegjësimi dhe Angazhimi i Komunitetit**<br>• Kryerja e fushatave ndërgjegjësuese për të informuar komunitetet për rreziqet mjedisore dhe rëndësinë e praktikave të qëndrueshme të rimëkëmbjes.<br>• Inkurajimi i pjesëmarrjes së komunitetit në projektet e rehabilitimit mjedisor, të tilla si mbjellja e pemëve ose pastrimi i zonave, për të forcuar angazhimin dhe ndërgjegjësimin publik.<br>• Mbështetja e politikave që promovojnë standarde të qëndrueshmërisë në përpjekjet për rimëkëmbje dhe zhvillim afatgjatë.<br>**Sigurimi i burimeve për rimëkëmbjen**<br>• Mbështetja e projekteve që forcojnë aftësinë ripërtëritëse ekologjike dhe përmirësojnë infrastrukturën natyrore për të përballuar fatkeqësitë e ardhshme.<br>• Siguron fonde nga qeveritë kombëtare, organizatat ndërkombëtare dhe donatorët për iniciativat për rimëkëmbjen e mjedisit. |
| Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Fier | **Vlerësimi dhe Prioritizimi i Ndërhyrjeve**<br>• Kryerja e vlerësimeve gjithëpërfshirëse të dëmeve në kanale, rezervuarë, stacione të pompimit dhe rrjetet e kullimit për të përcaktuar masat e nevojshme të rikuperimit.<br>• Identifikimi i zonave ku dëmtimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit ka ndikuar në bujqësi, furnizim me ujë ose sigurinë publike.<br>• Prioritizimi i riparimeve dhe rehabilitimit të infrastrukturës së ujitjes për të mundësuar rifillimin e aktiviteteve bujqësore dhe përdorimeve të tjera jetike.<br>**Rikuperimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit**<br>• Rivendosja e funksionalitetit të rezervuarëve, digave dhe kanaleve të ujit për të siguruar shpërndarjen e ujit në mënyrë të qëndrueshme për bujqësi dhe përdorime të tjera komunitare.<br>• Zbatimi i zgjidhjeve të tjera të përkohshme, si sistemet portative të pompimit për të siguruar funksionalitetin deri në zgjidhjen përfundimtare. |

| | |
|---|---|
| | • Pastrimi i kanaleve të kullimit nga bllokimet për të shmangur përmbytjet dhe për të zvogëluar riskun e përmbytjeve në zonat e prekura.<br>• Riparimi dhe përforcimi i sistemeve të kullimit për të garantuar rrjedhje efikase të ujit dhe për të mbrojtur infrastrukturën dhe komunitetet përreth.<br>**Monitorimi dhe zbatimi i masave për parandalimin e rreziqeve**<br>• Monitorimi i sistemeve të kullimit për të parandaluar rreziqet dytësore, të tilla si rrëshqitjet e dheut ose përmbytjet e mëtejshme.<br>• Zbatimi i masave të kontrollit të erozionit përgjatë rrjedhave ujore dhe në zonat me risk të lartë, për të zvogëluar ndikimin në tokat bujqësore dhe mjedis.<br>• Promovimi i metodave të qëndrueshme të përdorimit të ujit dhe teknikave efikase të ujitjes për të optimizuar përdorimin e burimeve gjatë fazës së rimëkëmbjes.<br>• Monitorimi i sistemeve të restauruara të ujitjes dhe kullimit për të garantuar që ato funksionojnë me efikasitet dhe qëndrueshmëri afatgjatë.<br>**Mësime të nxjerra dhe planifikimi për të ardhmen**<br>• Vlerësimi i ndikimit të përpjekjeve për rimëkëmbje dhe dokumentimi i mësimeve të nxjerra për të përmirësuar gatishmërinë ndaj fatkeqësive në të ardhmen.<br>• Mbështetja e projekteve të qëndrueshmërisë mjedisore, që ndihmojnë në përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike dhe rrisin aftësinë e qarkut për të menaxhuar burimet ujore në mënyrë efektive. |
| Shoqëria Ujësjellës-kanalizimet Sh.a | **Vlerësimi dhe prioritizimi i ndërhyrjeve**<br>• Kryerja e vlerësimeve gjithëpërfshirëse të dëmeve të rrjeteve të furnizimit me ujë, impianteve të trajtimit, stacioneve të pompimit dhe sistemeve kanalizimeve.<br>• Identifikimi i zonave më kritike për ndërhyrje dhe vendosja e prioriteteve për rikuperimin e shpejtë të furnizimit me ujë dhe shërbimeve të kanalizimeve.<br>• Zbatimi i zgjidhjeve të përkohshme, të tilla si rezervuarët e ujit ose njësitë e lëvizshme të trajtimit, për t'u shërbyer komuniteteve të prekura.<br>**Rikuperimi i infrastrukturës së ujit dhe kanalizimeve**<br>• Riparimi i rrjedhjeve dhe plasaritjeve në tubacione për të minimizuar humbjet e ujit dhe për të parandaluar rreziqet e ndotjes.<br>• Pastrimi dhe rehabilitimi i sistemeve të kanalizimeve dhe ujërave të zeza për të parandaluar ndotjen dhe rreziqet shëndetësore.<br>• Monitorimi dhe garantimi i funksionimit të impianteve të trajtimit të ujit dhe kanalizimeve për të shmangur ndotjen mjedisore.<br>• Zbatimi i masave për reduktimin e ndikimit të fatkeqësive të ardhshme, si përforcimi i tubacioneve dhe rritja e rezistencës së impianteve të trajtimit të ujit ndaj përmbytjeve. |

| | |
|---|---|
| | **Sigurimi i higjienës dhe informimi i publikut**<br>• Kryerja e testimeve të rregullta të cilësisë së ujit për të siguruar që furnizimet e restauruara të ujit janë të sigurta për konsum.<br>• Ofrimi i përditësimeve të vazhdueshme për publikun, mbi ecurinë e rimëkëmbjes dhe afatet kohore për restaurimin e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve.<br>• Edukimi i komuniteteve të prekura për rëndësinë e ruajtjes së ujit dhe praktikave të sigurta të higjienës gjatë rimëkëmbjes. |
| Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Fier | **Vlerësimi i dëmeve në infrastrukturën arsimore**<br>• Kryen vlerësime të dëmeve në shkolla dhe objekte arsimore.<br>**Sigurimi i vazhdimësisë së procesit arsimor**<br>• Organizimi i mësimit alternativ, përfshirë përdorimin e objekteve të përkohshme ose mësimit online në rastet kur shkollat janë të papërdorshme.<br>• Sigurimi i teksteve dhe materialeve mësimore për nxënësit e prekur nga fatkeqësia.<br>**Mbështetje psiko-sociale për nxënësit dhe mësuesit**<br>• Ofron mbështetje psiko-sociale për nxënësit dhe mësuesit për të lehtësuar rikthimin në shkollë.<br>• Ofrimi i ndihmës psikologjike dhe mbështetjes sociale për nxënësit dhe mësuesit e prekur<br>• Bashkëpunimi me strukturat psikosociale për të adresuar nevojat e grupeve të ndjeshme.<br>**Koordinimi për rimëkëmbjen e sektorit arsimor**<br>• Bashkëpunimi me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit dhe strukturat qeveritare për zbatimin e masave të rimëkëmbjes.<br>• Përgatitja e raporteve mbi situatën arsimore pas fatkeqësisë dhe rekomandime për përmirësim. |
| Përfaqësues të Kompanive të Telekomunikacionit (Vodafone & One) | **Vlerësimi dhe rivendosja e infrastrukturës**<br>• Kryerja e një vlerësimi të dëmtimeve në infrastrukturën e telekomunikacionit, duke përfshirë kullat celulare, linjat e transmetimit dhe pajisjet e rrjetit.<br>• Prioritizimi dhe zbatimi i riparimeve për të rivendosur kanalet kritike të komunikimit në përputhje me kërkesat e autoriteteve civile dhe planifikimin e përgjithshëm të rimëkëmbjes.<br>• Vendosja e njësive të përkohshme të komunikimit celular për të siguruar lidhje të menjëhershme në zonat e prekura.<br>**Mbështetja e komunikimit për publikun dhe institucionet**<br>• Ofrimi i informacionit të rregullt për publikun mbi statusin e , ndërprerjet e shërbimit dhe përparimin e restaurimit. |

| | |
|---|---|
| | • Sigurimi i linjave të dedikuara të komunikimit për qendrat e operacioneve emergjente dhe ekipet në terren, për të mbështetur përpjekjet e koordinuara të përgjigjes dhe rimëkëmbjes.<br>• Ofrimi i shërbimeve të veçanta për klientët, si ofrimi i telefonatave falas ose internet të limituar pa pagesë, për të ndihmuar popullatën e prekur të komunikojë gjatë periudhës së rimëkëmbjes.<br>• Vendosja e stacioneve të karikimit dhe pikave të Ëi-Fi në qendrat e strehimit dhe ato komunitare për të mbështetur individët e zhvendosur dhe komunitetet e prekura..<br>**Rritja e aftësisë ripërtëritëse të rrjetit**<br>• Investimi në teknologji dhe sisteme që përmirësojnë aftësinë ripërtëritëse të rrjetit për të përballuar risqet e fatkeqësive të ardhshme.<br>• Monitorimi i performancës së rrjetit gjatë dhe pas rimëkëmbjes për të identifikuar cenueshmëritë dhe për të përmirësuar aftësinë ripërtëritëse ndaj ndërprerjeve të ardhshme. |
| Spitalet Rajonale dhe Shërbimi i Urgjencës Mjekësore | **Sigurimi i kujdesit shëndetësor pas fatkeqësisë**<br>• Ofrimi i trajtimeve për dëmtime të lidhura me fatkeqësitë, të tilla si djegiet, lëndimet, infeksionet dhe traumat e tjera.<br>• Prioritizimi i kujdesit për grupet më të cenueshme, si fëmijët, të moshuarit, gratë shtatzëna dhe personat me aftësi të kufizuara.<br>• Zbatimi i fushatave të vaksinimit për të parandaluar shpërthimet e sëmundjeve të tilla si kolera, fruthi ose gripi në zonat e prekura.<br>• Bashkëpunimi me autoritetet e shëndetit publik për të monitoruar dhe adresuar rreziqet epidemiologjike që mund të shfaqen pas fatkeqësisë.<br>**Riorganizimi i infrastrukturës dhe shërbimeve mjekësore**<br>• Vlerësimi i dëmeve në objektet spitalore dhe implementimi i riparimeve për të siguruar funksionalitetin e plotë.<br>• Krijimi i objekteve të përkohshme mjekësore ose njësive të lëvizshme në zonat ku strukturat e përhershme nuk janë ende funksionale.<br>• Sigurimi i një furnizimi adekuat të pajisjeve mjekësore dhe medikamenteve për të përmbushur kërkesat e rritura të kujdesit shëndetësor gjatë rimëkëmbjes.<br>**Mbështetja psikosociale dhe informimi i publikut**<br>• Adreson nevojat psikologjike dhe emocionale përmes këshillimit dhe shërbimeve të shëndetit mendor për pacientët, për punonjësit e kujdesit shëndetësor, për forcat operacionale dhe stafin tjetër të përfshirë në fazën e rimëkëmbjes.<br>• **Informon publikun p**ër shërbimet e disponueshme të kujdesit shëndetësor, masat e vaksinimit dhe masat për dhe masat për parandalimin e sëmundjeve |

| | |
|---|---|
| Inspektoriati Rajonal Shtetëror Shëndetësor | **Vlerësimi dhe monitorimi i kushteve shëndetësore**<br>• Monitorimi dhe inspektimi i institucioneve shëndetësore për të garantuar rifillimin e shërbimeve bazë pas fatkeqësisë.<br>• Vlerësimi i ndikimit të emergjencës në shëndetin publik, përfshirë monitorimin e sëmundjeve të lidhura me fatkeqësinë.<br>• Inspektimi i kushteve higjieno-sanitare në objektet e riparimit dhe vendstrehimit të përkohshëm për të parandaluar përhapjen e sëmundjeve.<br>**Mbështetja për rivendosjen e sigurisë shëndetësore**<br>• Kontrolli i cilësisë së ujit dhe ushqimit në zonat e prekura nga fatkeqësia për të shmangur ndotjet dhe infeksionet.<br>• Monitorimi i shëndetit të popullsisë dhe ambientit për të identifikuar faktorët e rrezikut të shëndetit pas fatkeqësisë.<br>• Koordinimi me institucionet e tjera shëndetësore për zbatimin e masave parandaluese kundër epidemive dhe për të siguruar trajtim mjekësor për grupet e cenueshme.<br>**Koordinimi dhe mbështetja institucionale**<br>• Bashkëpunimi me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe organizatat ndërkombëtare për të siguruar ndihmë teknike dhe burime për rimëkëmbjen e sistemit shëndetësor.<br>• Dhënia e udhëzimeve për masat e rimëkëmbjes sanitare për institucionet publike dhe private.<br>• Përcaktimi i prioriteteve për inspektime urgjente dhe rishikimi i planeve të emergjencave shëndetësore në përputhje me përvojën e fituar nga fatkeqësia. |
| ARRSH Gjirokastër për Rajonin Jugor (Gjirokastër) | • **Rikonstruksioni dhe rehabilitimi i rrugëve –** Hartimi dhe zbatimi i planeve për rindërtimin dhe rehabilitimin e rrugëve dhe urave të dëmtuara, sipas përparësive të dokumenteve strategjike.<br>• **Menaxhimi i prokurimeve dhe kontratave –** Realizimi i procedurave të prokurimit dhe monitorimi i zbatimit të kontratave për ndërhyrjet në infrastrukturën rrugore.<br>• **Sigurimi i aksesit dhe sigurisë rrugore –** Vendosja e sinjalistikës dhe masave mbrojtëse për të garantuar sigurinë e përdoruesve deri në përfundimin e ndërhyrjeve.<br>• **Administrimi dhe monitorimi i procesit të rimëkëmbjes –** Mbikëqyrja e punimeve për të siguruar respektimin e standardeve dhe ruajtja e pronës shtetërore rrugore.<br>• **Bashkëpunimi institucional –** Koordinimi me Prefekturën, Policinë e Shtetit dhe institucionet e tjera për zbatimin efikas të planit të rimëkëmbjes. |

| | |
|---|---|
| Drejtoria Vendore e Policisë Fier/Komisariatet/Stacionet e Policisë | **Siguria publike dhe ruajtja e rendit**<br>• Sigurimi i rendit në zonat e prekura dhe parandalimi i krimeve si vjedhja, vandalizmi dhe aktivitete të tjera kriminale.<br>• Monitorimi dhe mbrojtja e ndërtesave dhe objekteve publike të dëmtuara për të parandaluar aksesin e paautorizuar dhe dëmtimet e mëtejshme.<br>• Parandalimi i tensioneve sociale dhe konflikteve të lidhura me ndarjen e burimeve apo pronësinë.<br>• Hetimi dhe parandalimi i incidenteve e mashtrimve ose korrupsionit që lidhen me rimëkëmbjen, duke siguruar llogaridhënie, drejtësi dhe transparencë.<br>**Menaxhimi i lëvizjes dhe mbështetja logjistike**<br>• Rregullimi i trafikut për të lehtësuar lëvizjen e automjeteve, pajisjeve dhe personelit duke prioritizuar automjetet dhe pajisjet që marrin pjesë në përpjekjet për rimëkëmbje.<br>• Ofrimi i sigurisë dhe mbështetjes logjistike për qendrat e shpërndarjes së ndihmës dhe strehimoret e komunitetit.<br>• Mbështetja e ekipeve të emergjencës dhe koordinimi me autoritetet lokale për të optimizuar operacionet e rimëkëmbjes.<br>**Mbrojtja e grupeve të cenueshme**<br>• Ofrimi i sigurisë për grupet e cenueshme, përfshirë fëmijët, të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara.<br>• Monitorimi dhe ndërhyrja për të parandaluar incidentet e shfrytëzimit, trafikimit të qenieve njerëzore ose abuzimeve të tjera në zonat e prekura nga fatkeqësitë.<br>**Komunikimi dhe ndërgjegjësimi publik**<br>• Shpërndarja e informacionit për publikun në lidhje me masat e sigurisë, afatet kohore të rikuperimit dhe burimet e disponueshme për komunitetin.<br>• Inkurajimi i qytetarëve të raportojnë aktivitete të dyshimta duke përfshirë shqetësime sigurie ose aktivitetet kriminale në zonat e prekura.<br>**Mbështetja për personelin e policisë**<br>• Ofrimi i mbështetjes operacionale dhe emocionale për oficerët e policisë dhe stafin e prekur nga fatkeqësia.<br>• Koordinimi me profesionistët e shëndetit mendor për të ofruar këshillim për stafin e prekur ndaj stresit dhe traumës pas fatkeqësisë. |
| Kryqi i Kuq Shqiptar/Degët e Kryqit të Kuq që veprojnë në qark | **Sigurimi i nevojave themelore për popullsinë e prekur**<br>• Ofrimi i artikujve thelbësorë, si ushqimi, ujë i pastër, veshjet dhe kompletet e higjienës, për komunitetet e prekur.<br>• Mbështetja e përpjekjeve për strehim të përkohshëm për individët dhe familjet e zhvendosura nga fatkeqësitë.<br>• Lehtësimi i aksesit në shërbimet e kujdesit shëndetësor dhe barnat për komunitetet e prekura në bashkëpunim me autoritetet shëndetësore vendore. |

| | |
|---|---|
| | **Mbështetja psikosociale dhe shëndeti mendor**<br>• Ofrimi i ndihmës së parë psikologjike dhe mbështetjes afatgjatë të shëndetit mendor për individët e prekur nga fatkeqësia  si dhe për forcat operacionale dhe stafin e përfshirë në rimëkëmbje.<br>• Organizimi i seancave të këshillimit dhe programeve mbështetëse emocionale për individët që përballen me trauma pas fatkeqësisë.<br>• Promovimi i higjienës dhe parandalimi i sëmundjeveve përmes fushatave ndërgjegjësuese dhe shpërndarjes së materialeve sanitare.<br>**Rimëkëmbja e komunitetit dhe zhvillimi i aftësive**<br>• Ofrimi i mbështetje për familjet më të prekura për një periudhë deri në një vit, duke përfshirë ndihmën materiale, asistencën psikosociale dhe promovimin e shëndetit dhe higjienës.<br>• Angazhimi dhe trajnimi i vullnetarëve për të ndihmuar në aktivitetet e rimëkëmbjes, si shpërndarja e ndihmave dhe mbështetja e komunitetit.<br>• Trajnimi i komuniteteve për aftësi të veçanta rimëkëmjeje, si ndihma e parë dhe mbështetja psikosociale.<br>**Menaxhimi i burimeve dhe monitorimi i rimëkëmbjes**<br>• Mobilizimi i fondeve dhe burimeve nga donatorët kombëtarë dhe ndërkombëtarë për të mbështetur përpjekjet e rimëkëmbjes.<br>• Monitorimi i ndikimit të aktiviteteve të rimëkëmbjes për t'u siguruar që ato plotësojnë nevojat e komuniteteve të prekura.<br>• Sigurimi i aksesit të barabartë në burimet dhe shërbimet e rimëkëmbjes për të gjitha grupet e prekura. |

## 7.6 / Roli i grupeve jo-institucionale të interesit në rimëkëmbje

Palët e interesuara joqeveritare dhe joinstitucionale luajnë një rol kritik në fazën e rimëkëmbjes, duke mbështetur institucionet shtetërore dhe vendore me ndihma humanitare, burime logjistike dhe ekspertizë teknike.

Plani Kombëtar për Emergjencat Civile (PKEC) identifikon palët kryesore të interesit të OJQ-ve dhe aktorëve të tjerë jofitimprurës, të cilët përfshijnë:

- Organizatat e bazuara në besim – Mbështesin ndihmën humanitare dhe ofrojnë ndihmë sociale për të prekurit.
- Organizatat komunitare – Ndihmojnë në rindërtimin e komunitetit, rehabilitimin dhe ndërgjegjësimin e popullsisë.
- Organizatat për mirëqenien e kafshëve – Ndihmojnë në shpëtimin dhe kujdesin ndaj kafshëve të braktisura pas fatkeqësisë.
- Organizatat e biznesit – Ofrimin e ndihmave, mbështetjen me fonde dhe rikuperimin e ekonomisë vendore.
- Organizatat mjedisore – Përcaktojnë masat për ripyllëzim, pastrimin e mbetjeve dhe rikuperimin e tokave të ndotura.
- Organizatat kulturore – Mbrojnë dhe restaurojnë trashëgiminë kulturore të dëmtuar.
- Organizatat profesionale – Mbështesin rindërtimin dhe zhvillimin e kapaciteteve teknike në sektorë të ndryshëm.
- Universitetet dhe institutet kërkimore – Ofrimi i analizave të rrezikut, planifikimi strategjik dhe mbështetje akademike për rimëkëmbjen.

### 7.6.1 / Roli i Donatorëve dhe kontributi i sektorit privat

Një element i rëndësishëm në fazën e rimëkëmbjes është roli i donatorëve dhe i sektorit privat. Sipas përvojave të mëparshme:

- Kompanitë e sektorit privat shpesh ofrojnë ndihma ushqimore, mallra të domosdoshme dhe shërbime emergjente për të ndihmuar popullatën e prekur.
- Organizatat humanitare ndërkombëtare mund të mbështesin rindërtimin me fonde dhe ekspertizë teknike.
- Kompanitë e ndërtimit dhe infrastrukturës mund të ofrojnë ndihmë në stabilizimin e ndërtesave dhe rindërtimin e zonave të prekura.
- Bashkëpunimi me hoteleritë dhe akomodimin privat është thelbësor për të strehuar familjet e pastreha pas fatkeqësive.

Në këtë drejtim, Prefekti i Qarkut duhet të krijojë marrëveshje paraprake me sektorin privat dhe donatorët për të siguruar reagim të organizuar dhe të barabartë për të gjithë qytetarët.

Në nivel qarku, Prefekti i Qarkut Fier luan një rol kyç në:

- Identifikimin dhe koordinimin e ndihmave nga sektorët privatë dhe OJQ-të për të shmangur mbivendosjet dhe boshllëqet.
- Sigurimin e logjistikës për shpërndarjen e donacioneve, duke përcaktuar pikat strategjike për grumbullimin dhe shpërndarjen e ndihmave.
- Nënshkrimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit me shoqatat e hotelerisë dhe sektorët e tjerë, për të garantuar strehim të organizuar për të prekurit.
- Lehtësimin e partneriteteve me institucionet ndërkombëtare për të mobilizuar fonde të qëndrueshme për rimëkëmbje.

### 7.6.2 / Roli i individëve dhe komuniteteve në rimëkëmbje

Rimëkëmbja nuk është vetëm një proces institucional, por edhe një përpjekje komunitare. Sipas PKEC, përgatitja për rimëkëmbje duhet të përfshijë edhe individët dhe familjet, duke i inkurajuar ata të:

- Ndërgjegjësohen mbi hapat që duhet të ndërmarrin pas një fatkeqësie.
- Ruajnë rezerva ushqimore dhe mjete emergjente për një periudhë të caktuar.
- Angazhohen në aktivitete komunitare për ndihmën e ndërsjellë.
- Bashkëpunojnë me organizatat vendore për të ndihmuar në procesin e rimëkëmbjes.

Prefekti i Qarkut Fier/Sektori i Planifikimit, Përballimit të Emergjencave Civile dhe Krizave mund të ndërmarrë fushata ndërgjegjësimi për të përgatitur familjet dhe komunitetet që të jenë më rezistente dhe të gatshme për një proces rimëkëmbjeje sa më efektiv.

# 8. Skenarët

## 8.1 / Skenari i Riskut nga Përmbytjet

1. **Analiza e Kontekstit dhe Skenarit të Riskut**

Shqipëria është një vend i prirur ndaj fatkeqësive. Katër risqet kryesore që prekin vendin janë përmbytjet, tërmetet, zjarret dhe rrëshqitjet e dheut. Sipas bazës ndërkombëtare të të dhënave të fatkeqësive (EM-DAT), nga viti 1979 deri në vitin 2019, përmbytjet përbënin shumicën e ngjarjeve të fatkeqësive (38%), të ndjekura nga tërmetet (15%).
Përmbytjet janë një fenomen natyror që, përveçse ndodhin si pasojë e ngjarjeve ekstreme të motit, shkaktojnë një sërë pasojash të ndërlidhura në sektorët mjedisorë, ekonomikë, socialë dhe shëndetësorë. Kompleksiteti i këtyre ndikimeve kërkon një qasje të integruar menaxhimi që përfshin jo vetëm parandalimin dhe mbrojtjen civile, por edhe planet e rindërtimit dhe ndërhyrjet e synuara për të mbështetur komunitetet e prekura.

Vlerësimi i riskut nga përmbytjet kërkon një qasje gjithëpërfshirëse që merr parasysh karakteristikat natyrore të territorit, ndikimin e aktiviteteve njerëzore dhe masat zbutëse të miratuara. Menaxhimi efektiv i riskut mund të zvogëlojë ndjeshëm dëmet ekonomike dhe humbjet e jetës.

Qarku i Fierit është shumë i pasur me burime ujore, sepse tre lumenj të mëdhenj—Shkumbini, Semani dhe Vjosa—kalojnë nëpër territorin e tij.

Më poshtë është një listë e ngjarjeve më të rëndësishme të përmbytjeve:

- **Shkurt 2015 - Fier:** Përmbytjet prekën zonat jugore dhe juglindore të Shqipërisë. Gjithsej u prekën 53 bashki, me gjithsej 397,316 persona të prekur në zonat e përmbytura. Rreth 12,225 hektarë tokë të kultivuar dhe të mbjellë u përmbytën, duke rrezikuar të mbjellat në faza të ndryshme të zhvillimit. U prekën rreth 15,000 familje bujqësore dhe u dëmtuan 9,992.6 hektarë tokë bujqësore. Për më tepër, 2000 njerëz u evakuuan.
- **Janar 2016 – Divjakë:** Në zonën e Çermës ndodhi një çarje me një gjatësi rreth 30 metra në argjinaturën e majtë të lumit Shkumbin, duke përmbytur disa dhjetëra banesa të fshatit dhe mbi 300 hektarë tokë.
- **Dhjetor 2017 – Fier dhe Vlorë:** Gati 5,000 familje u prekën nga përmbytjet në Shqipëri pas shirave të rrëmbyeshëm të datës 1 dhjetor 2017. Më shumë se 15,000 hektarë tokë u përmbytën dhe u dëmtuan, duke rezultuar në ndikimet e mëposhtme: 4,715 ndërtesa, 41 biznese, 127 seksione rrugësh 177 shkolla, 78 ura, 30 stacione furnizimi me ujë, 11 diga, 26 stacione elektrikë, 29 argjinatura dhe një hidrovor. Përmbytjet ndodhën përgjatë lumenjve Shkumbin, Ishëm, Erzen dhe Vjosë.

Në drejtim të zbutjes, menaxhimit dhe parandalimit të përmbytjeve, qarku i Fierit duhet të ketë:

- Infrastruktura e përmirësuar: Forcimi i argjinaturave, mirëmbajtja e sistemeve të kullimit, kontrollimi i digave bujqësore pas çdo situate shiu të dendur dhe ndërtimi i baseneve të mbajtjes së përmbytjeve.
- Sistemet e paralajmërimit të hershëm: Zbatimi i sistemeve të monitorimit dhe alarmit në kohë reale për të ofruar paralajmërime në kohë për banorët.
- Menaxhimi i Qëndrueshëm i Tokës: Rregullimi i zgjerimit urban, promovimi i ripyllëzimit dhe mbrojtja e ligatinave për të përmirësuar mbrojtjen natyrore nga përmbytjet.
- Gatishmëria e komunitetit: Edukimi i komuniteteve lokale mbi rreziqet nga përmbytjet, planet e reagimit ndaj emergjencave dhe procedurat e evakuimit.
- Planet e Koordinuara të Reagimit: Rritja e bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve lokale, shërbimeve të urgjencës dhe agjencive kombëtare për të siguruar një përgjigje të shpejtë dhe efektive.

Skenari referencë bazohet në ngjarjen e përmbytjes së dhjetorit 2017, ku:

- Reshjet intensive: variojnë nga 160 deri në 200 mm gjatë tre ditëve (ekuivalente me një reshje mesatare mujore), të paraprira nga reshje mesatare në ditët e mëparshme.
- Shkarjet e brigjeve të lumit: Disa argjinatura lumore çahen për shkak të presionit të lartë të ujit.
- Rreziqet e shkaktuara nga moti: Ngopja e tokës dhe erozioni i sipërfaqes nga reshjet e dendura shkaktojnë rrëshqitje të shumta të dheut brenda dy ditëve.

- Zonat e prekura: Rrëshqitjet e dheut prekin zonat e banuara, tokën bujqësore dhe rrjetet rrugore kryesore dhe lokale.

## 2. Ndikimet e një përmbytjeje në territorin e Qarkut Fier

Rreziku i përmbytjeve në qarkun e Fierit është i lidhur me karakteristikat hidraulike dhe ngjarjet e mundshme që ndodhin në basenet e lumenjve kryesorë të tij.

Prej tre ditëve të fundit reshje intensive kanë përfshirë të gjithë territorin e qarkut, duke shkaktuar përmbytje në zonat jugore dhe juglindore të Shqipërisë. Niveli i ujit të të gjithë lumenjve kryesorë (Vjosë, Seman, Drinos, Osum dhe Gjanica) ka filluar të rritet, duke arritur në nivele kritike dhe duke kërcënuar disa bashki.

Autoritetet janë veçanërisht të shqetësuara për gjendjen e digave brenda juridiksionit të tyre për shkak të rritjes së shpejtë të niveleve të ujit në hyrje. Për këtë arsye, rrjedha e shkarkimit në kanalin sipërfaqësor duhet të monitorohet vazhdimisht për të parandaluar tejkalimin e digave, gjë që mund të çojë në një dëmtim të shkarkuesit katastrofik dhe shkarkimin e një vëllimi masiv uji në një periudhë të shkurtër.

Gjithashtu, brenda 48 orëve, rrëshqitje të shumta të dheut prekin godinat e banimit dhe pjesët e infrastrukturës rrugore në zonat kodrinore. Raportohet për ndërprerje të pjesshme të energjisë elektrike për shkak të rrëzimit/rënies së disa linjave të energjisë. Ndërprerjet e shumta të rrugëve krijojnë shqetësime të konsiderueshme për banorët që shkojnë në punë. Në orët e para situata mbetet e paqartë për shkak të numrit të lartë të fshatrave të prekur.

## 3. Nevojat humanitare të popullsisë së prekur

Bazuar në skenarin e propozuar, një numër njerëzish mund të preken nga përmbytjet (referenca është dokumenti Raporti i Vlerësimit të Riskut nga fatkeqësitë në Qarkun Fier, që nxjerr në pah se në këtë qark, më shumë se 10.000 persona janë prekur nga një përmbytje me një periudhë kthimi 1 herë në 100 vjet). Këta njerëz duhet të ndihmohen me sigurimin e strehimoreve të sigurta (në rast se shtëpitë e tyre janë përmbytur dhe dëmtuar rëndë) dhe ushqim. Ndihma, në rast përmbytjeje, në të shumtën e rasteve zgjat nga ditë deri në një muaj. Gjithashtu, ardhja e ndihmave private duhet të menaxhohet në detaje, në mënyrë që të jetë efikase.

Është reale që në rast emergjence informacioni i disponueshëm, në orët e para, shpesh të jetë i paplotë, i pasaktë ose i paqartë, pjesërisht për shkak të shpërndarjes territoriale të popullsisë, e cila në këtë rajon është shumë e fragmentuar. Kjo e bën të vështirë për përfaqësuesit e njësive administrative që të ofrojnë përditësime në kohë për autoritetet bashkiake të menaxhimit të emergjencave dhe për prefektin dhe autoritetet kombëtare. Ky fragmentim është kryesisht për shkak të sistemit bujqësor, i cili mbulon pothuajse të gjithë Qarkun e Fierit dhe përbëhet nga ferma të vogla, të shpërndara, të varura shumë nga bujqësia me bazë familjare.

Duke pasur parasysh se ekonomia shqiptare ende mbështetet shumë në sektorin e bujqësisë, i cili punëson gati gjysmën e popullsisë, është thelbësore të ofrohet mbështetje për ata që merren me blegtori. Përvoja në këtë fushë ka treguar se, edhe kur shtëpitë e tyre janë të dëmtuara, këta individë shpesh hezitojnë të evakuohen, pasi preferojnë të qëndrojnë pranë pronave të tyre për t'u kujdesur për kafshët e tyre.

Një çështje tjetër kritike mund të jetë ndotja bakteriale e rrjetit të furnizimit me ujë. Kjo ka të bëjë me ndotjen e mundshme mikrobiologjike të ujit të pijshëm të shkaktuar nga infiltrimi i tokës, veçanërisht në rastet kur sistemet e ujërave të zeza janë dëmtuar ose shkatërruar.

Për më tepër, ekziston rreziku i ndotjes së ujërave nëntokësore, veçanërisht në akuiferët e cekët, të cilët në vendbanimet e vogla urbane shpesh përshkohen pa iu nënshtruar pastrimit të duhur. (Gjatë një përmbytjeje, ndotës të tillë si kimikatet, mbetjet industriale dhe mbetjet bujqësore mund të lëshohen në mjedis. Këto substanca ndotin lumenjtë, liqenet dhe tokën, duke e bërë ujin të pasigurt për konsum dhe duke paraqitur rreziqe serioze për shëndetin e popullsisë së prekur).

48 orë pas ngjarjes, si pasojë e ndërprerjes së reshjeve dhe ndërhyrjes nëpërmjet pompimit me kapacitet të lartë, të ngritura/krijuara në kuadër të Projektit IPA Floods (High Capacity Pumping) ose kapacitetet të tjera të pompimit me kapacitet të lartë sic janë ato të Ministrisë së Mbrojtjes, ujërat nisin të tërhiqen nga zonat e përmbytura duke lënë shkatërrime dhe një sasi të madhe balte të zhvendosur gjithandej. Njerëzit nxjerrin mobiljet dhe materialet e përmbytura nga shtëpitë e tyre dhe i vendosin përgjatë rrugëve të mbushura me materiale dhe baltë.

Në këtë fazë, është thelbësore për menaxhimin e të gjithë procesit të emergjencës që të organizohet mirë grumbullimi dhe asgjësimi i mbetjeve, duke pasur parasysh se kjo përbën një pengesë për kalimin e mjeteve përgjatë rrugëve. Pas disa ditësh mund të shfaqen probleme shëndetësore edhe për shkak të kalbjes së mbetjeve organike të cilat tërheqin dhe përcakton ardhjen e minjve.

Krahas ndihmës për popullsinë që ndodhet jashtë banesave, nevojiten edhe shumë punime rehabilituese në të gjitha njësitë administrative. Operacionet e para që do të kryhen janë:

1. Riparimi i argjinaturave të dëmtuara nga AKMC, MM dhe MBZHR.
2. Heqja e mobiljeve, materialeve të tjera të përmbytura, mbeturinave dhe baltës nga rrugët.

Në nivel vendor, pasi rrugët dhe ndërtesat janë plotësisht të lira nga ujërat, nisin punimet rehabilituese. Drejtori i strukturës së Planifikimit dhe Mbrojtjes Civile informon kryetarin e bashkisë për situatën, i cili pas konsultimeve vendos kalimin në etapën IV – Dalja nga situata. Ndërsa aktivitetet janë duke vazhduar, më pas përgatitet një raport fillestar teknik dhe ekonomik dhe ndahet me autoritetet dhe strukturat operacionale të përfshira. Ky raport është i nevojshëm për vlerësimin e një buxheti paraprak për menaxhimin e emergjencës.

Në përfundim të kësaj faze do të nisë procesi i rimëkëmbjes, duke u fokusuar në riparimin e plotë të dëmeve të shkaktuara nga ngjarja dhe zhvendosjen afatgjatë të individëve të evakuuar.

Skenari i propozuar tejkalon kapacitetin e reagimit të strukturave vendore të Mbrojtjes Civile. Prandaj, strukturat e koordinuara nga Prefekti do të jenë thelbësore në ofrimin e mbështetjes së nevojshme për bashkitë për sa i përket personelit, pajisjeve dhe materialeve.

Për një reagim efektiv emergjent, bashkitë duhet të ofrojnë menjëherë dhe në mënyrë të vazhdueshme përditësime të sakta, duke i mundësuar Prefektit të shpërndajë shpejt burimet e duhura në zonat e prekura.

## 4. Funksionet operacionale për menaxhimin e emergjencës,

Skenari i propozuar (i cili, siç u përmend, tejkalon kapacitetet e strukturave vendore të Mbrojtjes Civile) do të përfshijë domosdoshmërisht organizata të shumta, me gjasa nga sektori publik, privat dhe vullnetar. Çdo ent do të ketë përgjegjësitë, aftësitë dhe prioritetet e veta, që kërkojnë një koordinim efektiv – nga niveli vendor në nivel qarku dhe deri në nivel kombëtar.

Sipas ligjit 45/2019, Sistemi i Mbrojtjes Civile të Shqipërisë përbëhet nga një rrjet institucionesh dhe strukturash qendrore, në nivel qarku dhe vendore dhe bazohet në parimin e subsidiaritetit.

Në veçanti:

- Autoritetet vendore: Janë reaguesit e parë në menaxhimin e emergjencave brenda juridiksionit të tyre. Ata janë përgjegjës për përpjekjet fillestare të reagimit, vlerësimet e dëmeve dhe kërkesat për burime.
- Nëse kapaciteti i bashkisë është i pamjaftueshëm për të përballuar fatkeqësinë, kërkohen burime dhe ndihmë shtesë nga bashkitë fqinje.
- Nëse kapaciteti i bashkisë së prekur dhe ai i bashkive fqinje është i pamjaftueshëm për të menaxhuar fatkeqësinë, do të kërkohet mobilizimi i burimeve shtesë shtetërore, përfshirë Policinë e Shtetit dhe Forcat e Armatosura.

Në Planin Kombëtar për Emergjencat Civile, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 807, datë 28.12.2023, faza e përgjigjes ndaj emergjencave përbëhet nga katër etapa.
Aktivitetet e qarkut në fazën e përgjigjes janë të trajtuara tek seksioni 6.4 i këtij plani, aktivitetetet e bashkisë në fazën e përgjigjes janë të parashikuara në seksionin 7.4 të planit vendor të emergjencave civile të bashkisë përkatëse, kurse aktivitetet e përgjigjes në PKEC janë të trajtuara në seksionin 4.3. Aktivizimi i përgjigjes në Shqipëri.

## 5. Strukturat dhe institucionet përgjegjëse për gatishmërinë në nivele të ndryshme

Ngjarja emergjente në shqyrtim kërkon aktivizimin e aktorëve të shumtë, në varësi të progresit dhe evoluimit të ngjarjeve të përmbytjeve dhe rrëshqitjeve të dheut.

a) **Bashkia:** (Ato kryejnë funksionet e përcaktuara në seksionin 6.5 të Planit vendor për Emergjencat Civile)

Struktura përgjegjegjëse për:

- Emergjencat civile;
- Shërbimin zjarrfikës;

- Policinë Bashkiake;
- Shërbimet Publike;
- Shërbimin Social;
- Planifikimin e Territorit;
- Menaxhimin dhe Mbrojtjen e Territorit;
- Mjedisin;
- Pyjet/Kullotat;
- Bujqësinë.
- Etj.,

**b) Qarku i Fierit:** (Ato kryejnë funksionet e përcaktuara në seksionin 5.5 të Planit të Qarkut të Emergjencave Civile)

- Sektori i Planifikimit, Përballimit të Emergjencave Civile dhe Krizave;
- Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror;
- Përfaqësues të FA në nivel qarku;
- (Regjimenti i Këmbësorisë së Jugut, Reparti Ushtarak i Poshnjes);
- Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare Durrës;
- Drejtoria Rajonale e OSSHE-së dhe OST
- Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Fier;
- Drejtoria Rajonale e Arsimit Para-Universitar Fier;
- Drejtoria Rajonale e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, Fier;
- Përfaqësues të kompanive të telekomunikacionit (Vodafone & One);
- Zyra e Administrimit të Basenit Ujor Shkumbin – Seman;
- ARRSH Gjirokastër për Rajonin Jugor (Gjirokastër);
- IKMT Fier;
- Administrata e Zonave të Mbrojtura Pyjore qarku Fier;
- Agjencia Rajonale Ekstensionit Bujqësor;
- Drejtoria Rajonale e Veterinarisë dhe Mbrojtjes së bimëve Vlorë, Sektori Veterinar Qarku Fier;
- Albpetrol;
- Dega e Doganës Fier;
- Drejtoria Rajonale e Shërbimit Kombëtar të Punësimit;
- Drejtoria Rajonale e Entit Kombëtar të Banesave;
- Agjencia Rajonale e Mjedisit;
- Shoqëria e Ujësjellës Kanalizimeve SH.a;

- Kryqi i Kuq Shqiptar, Dega Fier, Patos, Mallakastër, Lushnjë
- Drejtoria Vendore e Policisë Fier/Komisariatet/Stacionet e Policisë

## 6. Institucionet, agjencitë, strukturat dhe organizatat e përfshira në përgjigjen ndaj përmbytjes në nivel qarku

• **Drejtoria e strukturës së Planifikimit dhe Mbrojtjes Civile në bashki**

Koordinon menaxhimin e përgjithshëm të emergjencës dhe të gjitha strukturave operacionale të përfshira, siç është përcaktuar në plan. Mban kontakt me të gjitha njësitë administrative, në koordinim me kryetarin e bashkisë, dhe dërgon periodikisht raporte për situatën tek Prefekti i Qarkut Fier;

- **Shërbimet Sociale në bashki**

Përgjegjëse kryesore për ndihmën ndaj popullsisë, duke përfshirë sigurimin e strehimit dhe mbështetjes për të evakuuarit.

- **Shërbimet Publike në bashki**

Asiston popullsinë në organizimin e strehimit të përkohshëm dhe ofron furnizime ushqimore dhe vakte ushqimi.

- **Policia Bashkiake**

Aktivizon burimet për menaxhimin e emergjencave. Koordinon dhe bashkëpunon me Drejtorinë Vendore të Policisë/komisariatet dhe stacionet e policisë dhe struktura të tjera për:

- Zbatimin e procesit të evakuimit të popullsisë civile.
- Garantimin e sigurisë gjatë shpërndarjes së ndihmave ushqimore dhe ndihmës gjatë emergjencës.
- Zbatimin e masave të sigurisë dhe ruajtjen e rendit publik, sigurisë dhe kontrollit të trafikut.

- **Struktura e Planifikimit të Territorit në bashki**

Shërben si shërbimi teknik përgjegjës për vlerësimin fillestar të dëmeve dhe rikthimin e rrjetit rrugor të prekur nga rrëshqitjet e dheut.

• **Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit në bashki**

Trajton komunikimin me popullsinë dhe mbështet vlerësimin fillestar të dëmeve dhe përpjekjet për njohjen e situatës.

• **Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Fier**

Ofron ndihmë shëndetësore sipas nevojës, duke siguruar mbështetje mjekësore për individët e prekur.

• **Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Fier:**

Riparon dhe rehabiliton sistemet e ujitjes për të rivendosur furnizimin me ujë në zonat bujqësore. Pastron dhe rihap kanalet e kullimit për të shmangur përmbytjet. Merr pjesë në vlerësimin e dëmeve.

Monitoron funksionimin e rezervuarëve dhe digave për të minimizuar rreziqet e ardhshme.

• **Agjencia Rajonale Ekstensionit Bujqësor Lushnjë**

Aktivizon të gjitha burimet për përgjigjen ndaj emergjencës. Vlerësimi i dëmeve dhe nevojave në bujqësi, në zonat e prekura nga fatkeqësia.

• **Shoqëria e Ujësjellës Kanalizimeve sh.a.**

Sigurimi i furnizimit të qëndrueshëm me ujë të pijshëm për popullatën dhe objektet kritike në zonat e prekura nga emergjenca. Informimi i publikut për ndërprerjet, masat e ndërmarra, dhe këshilla për ruajtjen e higjienës në kushte emergjence. Reagimi ndaj defekteve dhe dëmtimeve të mundshme në infrastrukturën e furnizimit me ujë.

• **Drejtoria Rajonale e Veterinarisë dhe Mbrojtjes së bimëve Vlorë, Sektori Veterinar Qarku Fier**

Aktivizimin e të gjitha burimeve për përgjigjen ndaj emergjencës. Mbrojtjen e shëndetit të kafshëve, marrja e masave të tjera veterinare kryerjen e vaksinimeve. Gjurmimin e  sëmundjeve në gjedh. Ndalimin e lëvizjes së kafshëve me sëmundje infektive. Eleminimi dhe dëmshpërblimi i fermerëve për kafshët e ngordhura. Monitorimi i mbetjeve.Vlerësimi i dëmeve dhe nevojave në fushën e blegtorisë dhe të bimëve, në zonat e prekura nga fatkeqësia.

- **Policia e shtetit**

Policia e Shtetit organizohet dhe ushtron detyrat e saj në operacionet e shpëtimit dhe të ndihmës në raste emergjente, duke ndjekur plane operacionale të paracaktuara dhe duke u koordinuar me agjencitë e tjera të mbrojtjes civile.

- **Drejtoria Vendore e Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike dhe Sistemit të Transmetimit**

Trajtimi i emergjencave civile të shkaktuara nga aksidentet në sistemin energjetik.
Organizon sistemin e njoftimit dhe ndërhyrjen e strukturave të gatshme në aksidente në sistemin energjetik dhe bashkëpunon në rastet e emergjencave civile.

Menaxhon sistemin e shpërndarjes së energjisë elektrike dhe organizon mirëmbajtjen e objekteve të veçanta.
Garanton furnizimin e pandërprerë me energji elektrike, veçanërisht në zonat e prekura nga fatkeqësitë.

- **Sektori i Planifikimit, Përballimit të Emergjencave Civile dhe Krizave– Prefekti i Qarkut Fier**

Koordinon aktivitetet rajonale dhe mban komunikimin me bashkinë dhe AKMC-në, duke informuar veçanërisht nivelin kombëtar dhe duke kanalizuar kërkesat lokale për ndihmë.

- **Përfaqësuesit e Forcave të Armatosura**

Forcat e Armatosura kontribuojnë në mënyrë aktive në menaxhimin e emergjencave civile duke vënë në dispozicion aftësitë e tyre operacionale për të adresuar situatat e emergjencës ose fatkeqësisë. Njësitë e tyre kryesore funksionojnë në koordinim të ngushtë me autoritetet vendore dhe agjencitë përgjegjëse për mbrojtjen civile.

- **Dega e Kryqit të Kuq**

Mbështet evakuimin dhe menaxhimin e popullsisë së prekur.

***Në Nivel Qendror:***

**Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile:**

Koordinon aktivitetet në nivel shtetëror dhe ofron mbështetje për Ministrinë përgjegjëse për Mbrojtjen Civile, si dhe në nivelet e prefekturës dhe bashkisë.

**Ministria e Mbrojtjes:**

Koordinon aktivitetet e Forcave të Armatosura dhe kontribuon në marrjen e vendimeve për menaxhimin e emergjencave.

**Instituti i Gjeoshkencave:**

Është përgjegjës për lëshimin e paralajmërimeve për motin dhe kryerjen e funksioneve të monitorimit hidrologjik dhe hidraulik të ngjarjes.

**Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural**

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural është përgjegjëse për qëndrueshmërinë e argjinaturave monitorimin gjatë ngajrjeve dhe punimet riparuese.

Skenari i propozuar përshkruan një përmbytje me karakteristikat e një emergjence në nivel kombëtar dhe per te cilën shpallet gjendja e fatkeqësisë natyrore. Prandaj, në nivelin kombëtar, referenca është Plani Kombëtar për Emergjencat Civile, i cili përfshin aktivizimin e të gjitha strukturave të mëposhtme sipas Figurës 2.

## 8.2 / Skenari i Riskut të Zjarreve

1. **Premisa**

Sipas dokumentit të "Vlerësimit të Riskut nga Fatkeqësitë në qarkun Fier" të hartuar në vitin 2023 nëpërmjet projektit RESEAL të UNPD-së, ky qark ka në territorin e tij një sipërfaqe pyjore prej 16079.9 ha dhe sipërfaqe jopyjore prej 220.4 ha. Sipërfaqja pyjore dominohet nga shkurret që mbulojnë rreth 6633.2 ha, pyje të lartë që zënë 3910.2 ha dhe 3778.5 ha të mbuluara nga cungishtet. Në territorin e qarkut Fier ka rreth 564,4 ha kullota, 206,5 ha tokë joproduktive, 351,5 ha tokë të zhveshur dhe 635,3 ha tokë me bimësi të rrallë. Në këtë qark, zjarret në pyje kanë një frekuencë të larmishme midis bashkive duke filluar nga 1 rast zjarri çdo 3 vjet (Divjakë, Lushnje, Patos) deri në 6 raste zjarresh në vit (Mallakastra dhe Fier). Në fondin pyjor, më të rrezikuarit ishin pyjet halore mesdhetare, ndërsa më pak të prekshme janë shkurret dhe kullotat. Në tokat bujqësore, më të rrezikuara janë ullishtat dhe pemët frutore, dhe më pak të rrezikuara janë kulturat bujqësore si fasulet, gruri dhe foragjeret për bagëtinë.

Në analizën e territorit vërehet se sipërfaqet e pyllëzuara dhe ato bujqësore krijojnë sipërfaqe të gjera me vazhdimësi të materialit djegës, të ndërprera vetëm herë pas here nga qendra të banuara. Kjo situatë krijon kushtet në të cilat një zjarr i vegjetacionit mund të shndërrohet në zjarr pylli (dhe anasjelltas) dhe të gjitha zjarret e vogla, nëse nuk shuhen shpejt, mund të kthehen në një zjarr të madh.

Në zjarret në pyje, një nga faktorët kryesorë që ndikon në shpejtësinë e përhapjes dhe në vështirësinë e shuarjes është prania e erës. Kodrat e shumta dhe pellgu ujëmbledhës që karakterizojnë territorin dhe afërsia e detit ndikojnë në shpejtësinë e erës që përgjithësisht në verë merr karakterin e flladit lokal dhe priret të rrotullohet në drejtim të akrepave të orës gjatë ditës. Përveç kësaj, në luginat më të ngushta dhe më të brendshme, vërehet një ndryshim i qarkullimit ndërmjet natës (flladet zbritës) dhe ditës (flladet rritës).

Zjarret në pyje nuk janë të parashikueshme, por konsultimi i buletineve të motit dhe "parashikimi i rrezikut nga zjarri" na lejon të identifikojmë zonat dhe ditët më të rrezikshme, çfarë lloj zjarri mund të presim dhe çfarë vështirësish do të hasen në shuarjen e tij. Variablat orografikë të territorit, vegjetacionit, shpejtësisë dhe drejtimit të erës, indekset e tharjes së lëndës djegëse dhe koha e mundshme e ndezjes nuk lejojnë të identifikohet në hartë zona që mund të digjet, por kjo nuk është e rëndësishme deri në fund të hartimit të planit bashkiak të mbrojtjes civile, pasi në dokument është e mundur të identifikohen veprimet të cilave duhet t'u kushtohet vëmendje dhe të aktivizohen.

Objektivi është të identifikohet aftësia e bashkisë për të menaxhuar këtë lloj emergjence, ngjarje që nga natyra e tyre janë shumë të shpejta dhe kërkojnë një planifikim jashtëzakonisht sintetik në shkrimin e saj edhe po aq të detajuar në përmbajtje.
Përfundon duke ju rikthyer dokumentit “Vlerësimi i riskut nga fatkeqësitë” në të cilin tregohet se forma kryesore e shuarjes së zjarreve në pyje kalon përmes edukimit të qytetarëve dhe zbatimit të formave të mbrojtjes pasive (prerja e linjave të zjarrit, menaxhimi i bimësisë në pika strategjike, etj.), veprime që duhen kryer gjatë periudhave me rrezik të ulët zjarri.

## 2. Ndikimi i Zjarreve pyjore masive në Njësinë Administrative Karbunarë

Skenari i supozuar është bashkëshoqërimi, në territorin e qarkut Fier, i zjarreve të shumta në pyje dhe vegjetacion, gjatë një periudhe të karakterizuar nga indekse shumë të larta të thatësisë që favorizojnë zjarret në të gjithë territorin Shqiptar.

Në tabelë indekset e ditës së ngjarjes:

| Treguesi | Të dhënat |
|---|---|
| Era | Erëra lokale me shpejtësi deri në 30 km/orë (në orët e pasdites) veçanërisht në bregdet dhe kreshta. Drejtimi i përgjithshëm i erës tenton të rrotullohet në drejtim të akrepave të orës gjatë ditës (gjatë natës nga lindja, mëngjesi nga jugu, pasditja nga perëndimi). Natën, në pellgun ujëmbledhës krijohen erëra lokale me drejtim të kundërt. |
| Temperatura | 35° (Lushnje) |
| Lagështia e ajrit | 21% (Lushnje) |
| Indeksi atmosferik i zjarreve FWI | > 35 në të gjithë vendin |
| Indeksi i lagështisë së karburantit të imët FFMC | > 94 në të gjithë vendin |
| Indeksi i thatësirës DC | > 850 në të gjithë vendin |

Në skenarin e propozuar, në qarkun e Fierit janë 14 ngjarje:

| | Bashkia | Gjendja | Sipërfaqja e zonës | Të dhëna |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Mallakastër | Aktive | ~ 15 ha | Zjarri po avancon drejt rafinerisë. Nëse situata nuk ndryshon brenda rreth 2 orësh, zjarri do të arrijë në impiantin industrial |
| 2 | Fier | Aktive | ~ 25 ha | Zjarri po përparon me shpejtësi rreth 10 m/min dhe ka pasur disa vatra të shpërndara |
| 3 | Lushnjë | Kufizuar | 6 ha | Terren i pjerrët |
| 4 | Fier | Shuar nën kontroll | Nuk raportohet | Zjarri i bimësisë në tokë bujqësore |
| 5 | Lushnjë | Kufizuar | 8 ha | Zjarri i bimësisë në tokë bujqësore dhe ullishte |
| 6 | Divjakë | Shuar nën kontroll | ~ 80 ha | Prania e një kampingu. Operacione të ndërlikuara për bonifikim |
| 7 | Lushnjë | Aktive | ~ 5 ha | Zjarri i bimësisë në tokë bujqësore. Pylli ndodhet vetëm në zonat me pjerrësi më të madhe dhe në pellgun ujëmbledhës |
| 8 | Patos | Aktive | ~ 5 ha | Zjarri i bimësisë në tokë bujqësore. Ka shumë shtëpi në zonë |
| 9 | Fier | Kufizuar | Nuk raportohet | Nuk raportohet |
| 10 | Divjakë | Shuar nën kontroll | ~ 3 ha | Nuk raportohet |
| 11 | Roskovec | Shuar nën kontroll | Nuk raportohet | Nuk raportohet |
| 12 | Patos | Aktive | ~ 11 ha | Zjarr i bimësisë në tokë bujqësore. Ka shumë shtëpi |
| 13 | Divjakë | Aktive | ~ 3 ha | Rezervat natyror. Ka ambiente akomodimi |
| 14 | Mallakastër | Aktive | Nuk raportohet | Nuk raportohet |




## 3. Nevojat humanitare të popullsisë së prekur

Bashkëkohësia e ngjarjeve është një nga aspektet më të vështira për t'u menaxhuar në rrezikun e zjarrit, sepse duhen bërë zgjedhje se si të mbrohet popullsia dhe të menaxhohen burimet (të cilat në këto raste bëhen të pakta për të plotësuar nevojat).

Zjarret ndodhin në një kontekst natyror dhe për këtë arsye ndikohen nga variabla të pafund, si terreni, karburanti, prania e elementeve në rrezik dhe aspektet meteorologjike. Për këtë arsye nuk ekziston një sistem ndërkombëtar i përzgjedhjes dhe prioritizimit të ndërhyrjeve siç ndodh, për shembull, në fushën e emergjencave shëndetësore. Skenari i propozuar kërkon që autoriteti koordinues rajonal të bëjë zgjedhje për të menaxhuar burimet në mënyrën më të mirë dhe për të shmangur një zhvillim negativ të situatës.

Më poshtë janë indikacionet e përgjithshme që mund të jenë të dobishme në përmbushjen e këtij funksioni:

- Prioritet është mbrojtja e njerëzve, prandaj është e nevojshme të kryhet dhe të rritet aktiviteti i evakuimit parandalues të njerëzve dhe transferimi i tyre në zonat e ndihmës;
- Të identifikojë se cilat zjarre mund të prekin zonat e rrezikshme industriale (p.sh. rafineritë) ose strukturat strategjike (p.sh. spitalet);
- Për marrjen e vendimeve, është e nevojshme të disponohen informacione dhe të dhëna reale për situatën në çdo moment. Për këtë arsye, është thelbësore që QOECQ të përditësohet vazhdimisht për situatën e çdo zjarri individual;
- Vendimet e marra duhet të rishikohen dhe të ndryshojnë me kalimin e kohës, nëse situata në terren ndryshon ose nëse nuk arrihen objektivat e përcaktuara;Të identifikohen ngjarjet që nuk mund të menaxhohen me burimet e vendosura dhe të disponueshme. Shpesh është më e efektshme përqendrimi i burimeve në zjarre të vogla, për të parandaluar përhapjen e tyre në vatra të mëdha dhe të pakontrollueshme;
- Ata që janë ndodhen në terren shpesh e perceptojnë ngjarjen e tyre si prioritetin kryesor. Në situata me ngjarje të shumta njëkohësisht, është e rëndësishme të dialogohet me kryetarët e bashkive për të paraqitur situatën e përgjithshme të rajonit dhe për t'i nxitur ata të marrin masa parandaluese për sigurinë e popullatës;
- Të analizohen ngjarjet duke përdorur të dhëna teknike dhe hartën bashkangjitur dokumentit "Vlerësimi i riskut nga fatkeqësitë".

Si përfundim, duhet pasur parasysh se zjarret janë ngjarje dinamike që evoluojnë në kohë dhe hapësirë. Për këtë arsye, mospërcaktimi i ngjarjeve prioritare dhe mënyra e menaxhimit të burimeve përfaqësojnë gjithsesi një zgjedhje operacionale, e cila do të ndikojë në rezultatin përfundimtar.

## 4. Funksionet operacionale për menaxhimin e emergjencës

Zjarret në pyje janë ngjarje shumë dinamike, prandaj është e domosdoshme të sigurohet një shkëmbim i vazhdueshëm informacioni midis strukturave të ndryshme operacionale dhe niveleve të ndryshme të koordinimit (Bashkia, Prefekti dhe AKMC). Ky shkëmbim informacioni është thelbësor edhe për aktivizimin e burimeve optimale në menaxhimin e emergjencave dhe për mbështetjen e popullsisë.

### *a) Në nivel qendror:*

Qendra Kombëtare Operacionale e Emergjencave Civile, siç parashikohet nga Plani Kombëtar për Emergjencat Civile do të monitorojë zhvillimin e situatës, në bashkërendim si me bashkinë ashtu edhe me Prefektin e Fierit.
Nëse gjykohet e nevojshme, do të mbështesë Prefektin për të identifikuar burime shtesë që do të dërgohen në vendin e ngjarjes.

Nëse zjarri nuk vihet nën kontroll dhe forcat rajonale janë të pamjaftueshme, Prefekti mund t'i drejtojë kërkesë AKMC-së për shpalljen e "gjendjes së fatkeqësisë natyrore".

Në vijim:

- Drejtori i Përgjithshëm i AKMC-së pas analizës dhe vlerësimit të situatës do të njoftojë menjëherë Ministrin e Mbrojtjes, në lidhje me kërkesën e Prefektit. Ministri i Mbrojtjes pas analizës dhe vlerësimit të situatës njofton Këshillin e Ministrave mbi situatën i cili nëse përmbushen kriteret mund të shpallë "gjendjen e fatkeqësisë natyrore". Me vendim të Këshillit të Ministrave shpallet gjendja e fatkeqësisë natyrore dhe ngrihet Komiteti Ndërministror i Emergjencave Civile. Në mbledhjen e tij të parë, Komiteti Ndërministror i Emergjencave Civile do të caktojë Drejtuesin Qendror të Operacionit, i cili do të marrë drejtimin e përgjithshëm të përgjigjes dhe ndihmën ndërkombëtare sipas nevojës.
- Siç parashikohet në Planin Kombëtar për Emergjencat Civile, faza e përgjigjes përfshin katër etapa aktivizimi. Ministri përgjegjës për mbrojtjen civile është Autoriteti i cili shpall fillimin e "Etapës III – Aktivizimi", duke përfshirë menjëherë strukturat e përhershme që kanë detyra të mbrojtjes civile në misionin e tyre.
- Me aktivizimin e "Etapës III – Aktivizimi" për emergjencat e menjëhershme, Drejtori i Përgjithshëm i AKMC-së mbledh në Qendrën Kombëtare të Emergjencave Civile anëtarët e Komisionit Teknik Këshillimor (Komisioni i drejtuar nga Drejtori i Përgjithshëm i AKMC, ngritur në zbatim të VKM nr. 1020, datë 16.12.2020 dhe ka si funksion kryesor këshillues).
- Nësë është e nevojshme për ndihmë ndërkombëtare sipas përcaktimeve të ligjit nr. 45/2019, neni 53, pika 2. Apeli për asistencë, drejtuar organizmave ndërkombëtarë dhe shteteve të tjera, në rastet e shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore, bëhet nga ministria përgjegjëse për punët e jashtme dhe për rastet e tjera bëhet nga ministria.
- Me shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore mblidhet Ekipi i Menaxhimit të Emergjencave Civile, anëtarë të të cilit janë përfaqësues të ministrive dhe institucioneve qendrore. Ata takohen dhe punojnë në Qendrën Kombëtare Operacionale të Emergjencave Civile, në varësi të situatës dhe nevojave.

**_b) Në nivel qarku:_**

Sipas kuadrit ligjor aktual, Prefekti ka një rol udhëheqës në menaxhimin e emergjencave në nivel qarku.

Në vijim të skenarit të propozuar, Prefekti i qarkut Fier, sipas përcaktimeve të nenit 28 të ligjit nr.45/2019, do të koordinojë përdorimin e të gjitha kapacitetet brenda Qarkut për të përballuar situatat e krijuara nga fatkeqësia. Në veçanti:

- Mban kontakt të vazhdueshëm me strukturat qendrore.
- Aktivizon burimet e nevojshme që disponon Qarku për të lehtësuar shuarjen e zjarrit dhe ndihmën për popullatën.
- Informon prefektët e Qarkut që mund të përfshihen nëse zjarri nuk shuhet (për skenarin e propozuar - Prefektët e Tiranës, Elbasanit, Beratit dhe Gjirokastrës).

- Koordinon me Prefektët e tjerë të Qarqeve të tjera të vendit për të marrë ndihmë në aspektin e personelit dhe mjeteve (siç parashikohet në "Planin Kombëtar për Emergjencat civile").
- Nëse i konsideron të pamjaftueshme forcat operacionale të disponueshme për të luftuar zjarrin, i propozon Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile “shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore” (Etapa III).
- Në rast se u është kërkuar ndihmë shteteve të tjera, koordinon dislokimin e ekipeve ndërkombëtare.
- Kërkon ndërhyrjen e mjeteve ajrore kundër zjarrit.
- Kërkon mbështetjen e Forcave të Armatosura.
- Kërkon ndërhyrjen e mjeteve detare për evakuimin nga deti të popullsisë dhe të koordinojë këtë aktivitet duke identifikuar një vend për zbarkimin e qytetarëve dhe rrjedhimisht transferimin dhe pritjen në strukturat e përkohshme.
- Nxit kryetarët e bashkive që të aktivizojnë procedura specifike për emergjencat që mund të shkaktohen nga zjarri (p.sh. rreziku teknologjik).

Në skenarin aktual, Prefekti, përveç kryerjes së veprimeve të mësipërme, është përgjegjës për përcaktimin e prioriteteve për shpërndarjen e burimeve dhe dialogun me kryetarët e bashkive për të mbrojtur sigurinë e njerëzve, si dhe nëpërmjet evakuimit të popullsisë. Prefekti mund ta kryejë këtë operacion strategjik dhe të ndjeshëm vetëm nëse merr informacion të vazhdueshëm për situatën e çdo ngjarjeje individuale.

***c) Në nivel bashkie:***

Indekset e thatësisë së lëndës djegëse (veçanërisht indeksi DC) tregojnë se bimësia në zonë është nën stres ujor dhe nuk ka rënë shi për shumë javë.

Kjo situatë e kombinuar me indekset e motit ka sjellë, në tre ditët e fundit, një vlerë FWI mbi 30 (buletini i disponueshëm për konsultim https://forestfire.emergency.copernicus.eu/apps/effis_current_situation/index.html), duke rezultuar në aktivizimin e "Etapës I - Alarmi për rritjen e gjendjes së gatishmërisë".

Gjatë kësaj etape kryhen kontrolle funksionale dhe operacionale në bashki dhe vihet stafi në gjendje gatishmërie. Qytetarët njoftohen për kushtet e rrezikut të mundshëm të ndezjes dhe përhapjes së zjarreve në pyje, duke rikujtuar rregullat për të shmangur ndezjen aksidentale të zjarreve.

Për skenarët e rrezikut të zjarrit, aktivizohet nga bashkia "Etapa II - Vendosja e gjendjes së gatishmërisë" vetëm nëse zjarri është në një bashki fqinje dhe mund të ndikojë potencialisht në juridiksionin e saj, përndryshe, nëse ngjarja fillon nga territori i saj, ai kalon direkt në "Etapën III - Aktivizimi".

Nisur nga informacioni mbi zjarrin dhe duke konsideruar potencialin e rrezikshmërisë për qytetarët, Kryetari i Bashkisë kontakton me Prefektin, Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile për të vlerësuar kalimin në “Etapën III – Aktivizimi në nivel kombëtar”. Në të njëjtën kohë, "Etapa III - Aktivizimi" aktivizohet në nivel vendor.

Skenari i propozuar parashikon, siç tregohet në paragrafin 4.3.2, që Komisioni i Mbrojtjes Civile i kryesuar nga Kryetari i Bashkisë është struktura kryesore përgjegjëse për miratimin e masave për menaxhimin e përgjithshëm dhe udhëzimet për menaxhimin vendor të emergjencës.

Në veçanti, vendimi për evakuimin duhet të merret vetëm pas një analize të kujdesshme të parametrave të mëposhtëm:

o koha e nevojshme për të kryer operacionin e evakuimit

o prania e tymit

o shpejtësia e avancimit të zjarrit

o siguria e rrugëve të evakuimit.

Drejtuesi i Operacionit në nivel Bashkie, për të patur vazhdimisht informacione të përditësuara dërgon në vendngjarje një përfaqësues, i cili përveç bisedës me strukturat operacionale, mund të vëzhgojë zjarrin nga një zonë vëzhgimi dhe të dërgojë foto në KMCB. Në veçanti, do të kryejë detyrat e përcaktuara në këtë plan në kapitullin 4.3.2:

Vlerësimi i menjëhershëm i ndikimit:

- Perimetri i zjarrit dhe drejtimi përpara;
- Zona e prekur nga tymi;
- Popullsia e rrezikuar (prania e grupeve më të cenueshme);
- Infrastruktura e prekur dhe dëmet e pësuara.

Vlerësimi i nevojave:

- Identifikimi i nevojave të qytetarëve dhe ekipeve të shpëtimit;
- Kontrolli i disponueshmërisë së ujit dhe energjisë elektrike.

Vlerësimi logjistik:

- Analiza e aksesueshmërisë;
- Disponueshmëria e zonave të uljes për helikopterët (nëse nuk janë përcaktuar në planin vendor për Emergjencat Civile të bashkisë.)
- Prania e linjave të energjisë elektrike dhe pengesave për fluturim;
- Funksionaliteti i pellgjeve dhe rezervuarëve të ujit.

Për të lehtësuar aktivitetin, përmblidhen aktivitetet kryesore që duhet të kryejë bashkia në Etapën III (kapitulli 7.3.3), në këtë etapë është gjithashtu e nevojshme të kryhen disa veprime të parashikuara në Etapën II (kapitulli 7.3.2):

1. Sigurimi i aktivizimit të të gjitha strukturave operacionale dhe mbështetëse dhe kapaciteteve të reagimit në nivel bashkie, si dhe vënia në punë e Komisionit të Mbrojtjes Civile në nivel bashkie dhe aktivizimi i QOECB-së (Etapa III).
2. Mbledh KMCB për të mbështetur vendimmarrjen dhe aktivitetet e përballimit të emergjencës (Etapa III). Aktorët e ndryshëm të përfshirë në aktivitet janë renditur në kapitullin vijues (Institucionet, agjencitë, strukturat dhe organizatat e përfshira në reagimin ndaj zjarrit).

3. Përgatit raportin e parë të gjendjes dhe e dërgon periodikisht tek Prefekti dhe AKMC.
4. Kontrollon nëse mjetet e transportit dhe burimet e planit janë të disponueshme dhe të gatshme për operim (Etapa II).
5. Kontrollon funksionimin e mediave të komunikimit (Etapa II).
6. Informon popullatën për situatën dhe nevojën e zbatimit të masave vetëmbrojtëse (Etapa II).
7. Kontrollon disponueshmërinë/funksionalitetin e zonave të emergjencës, objekteve për pritjen e popullsisë dhe rrugëve të evakuimit (Etapa II).
8. Vlerëson nëse situata kërkon aktivizimin e veprimeve të planifikuara edhe për fatkeqësitë e mëdha:

- Sigurohet aktivizimi i të gjitha strukturave operacionale aktive dhe mbështetëse dhe kapaciteteve të reagimit në nivel bashkie, si dhe vënia në punë e KMCB-së dhe aktivizimi i Qendrës Operacionale të Emergjencave Civile në nivel bashkie.
- Harton raporte të situatës për prefektin, Qendrën Operacionale të Emergjencave Civile në nivel qarku ose drejtpërdrejt për Qendrën Kombëtare Operacionale të Emergjencave Civile.
- Koordinimi i strukturave vendore në nivel vendor, si dhe strukturave të tjera qendrore apo ndërkombëtare që vijnë në ndihmë.
- Mban kontakte të rregullta dhe të vazhdueshme me drejtues të tjerë të forcave operacionale në nivel qarku dhe në bashkitë fqinje, informon dhe kërkon ndihmë nga Drejtuesi i Operacionit në nivel qarku.

Me shuarjen e zjarrit dhe rregullimin e perimetrit të zonave potencialisht më të rrezikshme në rast të riaktivizimit të zjarrit, që mund të kërcënojnë banesat, përfundon Etapa III. Përgjegjësit e QOECB-së do t'i raportojnë situatën Kryetarit të Bashkisë, i cili do të njoftojë aktivizimin e Etapës IV " Dalja nga situata ".

Në këtë Etapë do të kërkohen veprimet e mëposhtme:

- Informimi i të gjitha strukturave, institucioneve dhe subjekteve të tjera që operojnë në territorin e bashkisë për aktivizimin e Etapës IV.
- Kthimi i të evakuuarve në shtëpitë e tyre dhe rifillimi i aktiviteteve të pezulluara.
- Vlerësimi i pasojave të mundshme të zjarrit, duke përfshirë:
  - o Dëmtimet e ndërtesave dhe objekteve të kafshëve.
  - o Dëmtimet e linjave të energjisë elektrike dhe rrugëve.
  - o Rrezikun nga rënia e mundshme e pemëve të djegura dhe gurëve.
  - o Kontrolli për rënie të mundshme të gurëve dhe përmbytje të shpejtë gjatë shirave të parë.
- Zbatimi i të gjitha veprimeve të tjera të përshkruara në seksionin 6.4.4 të këtij Planit (p.sh. mbledhja e të dhënave, raportimi, etj.).

## 5. Institucionet, agjencitë, strukturat dhe organizatat e përfshira në reagimin ndaj zjarreve (lista e veprimeve kryesore, të gjitha veprimet dhe subjektet janë përshkruar në kapitullin 6.4 tabela 5)

***Në nivel qarku***

- **Drejtoria e Mbrojtjes Civile në bashki**

  Në koordinim me Kryetarin e Bashkisë/ KMCB koordinon menaxhimin e përgjithshëm të emergjencës dhe të gjitha strukturat operacionale të përfshira, siç tregohet në plan. Mban kontakte me njësinë administrative në Karbunarë dhe dërgon raporte të rregullta për situatën. Në konsultim me kryetarin e bashkisë dhe strukturat operacionale, vlerësohet evakuimi i popullsisë. Në veçanti për skenarin e analizuar ky sektor merret edhe me informacionin (për qytetarët dhe mediat), duke vënë në dispozicion burimet për të lehtësuar punën e shuarjes (duke pasur parasysh vlerën shumë të lartë të DC, përdorimi i ekskavatorëve është i domosdoshëm për të siguruar perimetrin) dhe transferimin e njerëzve. Aktivizon dhe menaxhon zonën për të akomoduar popullsinë.

- **Drejtoria e Shërbimeve Sociale**

  Përgjegjës kryesor për ndihmën popullsisë, duke përfshirë sigurimin e strehimit dhe mbështetjen për të evakuuarit.

- **Drejtoria e Shërbimeve Publike**

  Ndihmon popullsinë në përgatitjet e strehimit emergjent dhe sigurimin e furnizimeve ushqimore dhe vakteve.

- **Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësore**

  Ofron ndihmë shëndetësore sipas nevojës, duke siguruar mbështetje mjekësore për individët e prekur.

- **Drejtoria e Planifikimit të Territorit**

  Vepron si shërbim teknik përgjegjës për vlerësimin fillestar të dëmeve dhe rehabilitimin e rrjetit rrugor të ndikuar (psh renia e pemëve të djegura).

- **Drejtoria e Integrimit Europian**

  Monitorimi i zbatimit të procedurave të Mbështetjes së Vendit Pritës.

- **Mirëmbajtja e rrugëve, ujitjes, kullimit, pyjeve dhe varrezave**

  Aktivizimi i personelit dhe burimeve për të përballuar emergjencën. Pjesëmarrja në vlerësimin e dëmeve dhe nevojave në zonat e djegura.

- **Inspektoriati i Mbrojtjes së territorit**

  Paralajmërime të hershme dhe informacione për emergjencat, duke këshilluar publikun sipas nevojës. Pjesëmarrja në vlerësimin e dëmeve dhe nevojave në zonat e djegura.

- **Drejtoria e Policisë Bashkiake**

  Aktivizon burimet për të menaxhuar emergjencat dhe fatkeqësitë. Koordinon dhe bashkëpunon me policinë vendore dhe strukturat e tjera për:

o Zbatimin e procesit të evakuimit të popullsisë civile.

o Ofrimin e sigurisë për ndihmën ushqimore dhe ndihmesën gjatë emergjencës.

o Zbatimi i masave të sigurisë dhe ruajtja e rendit publik, sigurisë dhe kontrollit të trafikut.

- **Sektori i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi**

Mobilizon burimet, bashkëpunon me struktura të tjera operacionale lokale si dhe me struktura të tjera kombëtare dhe ndërkombëtare. Kryen operacione për shuarjen e zjarrit dhe shpëtimin e popullatës në rrezik.

- **Sektori i Planifikimit, Përballimit të Emergjencave Civile dhe Krizave – Prefekt i Qarkut Fier**

Koordinon aktivitetet rajonale dhe ruan komunikimin me bashkinë dhe AKMC, veçanërisht duke informuar në nivel kombëtar dhe duke kanalizuar kërkesat rajonale për ndihmë.

• **Drejtoria Rajonale e Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike**

Menaxhon sistemin e shpërndarjes së energjisë elektrike dhe ndërhyn për të siguruar furnizimin. Në rastin e operacioneve ajrore, koordinon me Drejtorinë e Zjarrfikësve për të bërë ndërprerje të synuara të energjisë.

- **Agjencia Rajonale Ekstensionit Bujqësor Lushnjë**

Mobilizimin dhe aktivizimin e burimeve në veçanti për shpëtimin dhe mbrojtjen e kafshëve dhe ushqimit të tyre. Vlerësimi i dëmeve në kulturat bujqësore.

• **Administrata e Zonave të Mbrojtura Pyjore qarku Fier, Divjakë.**

Koordinimin me autoritetet lokale, bashkinë, prefekturën, strukturat e planifikimit dhe të mbrojtjes civile për përballimin e emergjencës ose fatkeqësisë.
Aktivizimin e të gjitha burimeve për përgjigjen ndaj emergjencës.

• **Agjencia Rajonale e Mjedisit**

Mobilizon dhe aktivizon burimet, veçanërisht për vlerësimin e dëmeve.

• **Dega e Kryqit të Kuq Fier**

Mbështet evakuimin dhe menaxhimin e popullsisë së prekur.

• **Drejtoria Vendore e Policisë Fier/Komisariati Fier**

Aktivizon burimet e menaxhimit të emergjencës për:

- Zbatimin e procesit të evakuimit të civilëve.
- Mbylljen e rrugëve të rrezikshme dhe të rrugës së nevojshme për të lehtësuar kalimin.
- Zbatimin e masave të sigurisë dhe ruajtja e rendit publik, sigurisë dhe kontrollit të trafikut.

***Në Nivel Qendror***

• **Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile:**

Koordinon aktivitetet në nivel shtetëror dhe ofron mbështetje për Ministrinë përgjegjëse për Mbrojtjen Civile dhe në nivel prefekture dhe bashkie

- **Ministria e Mbrojtjes**

  Koordinon aktivitetet e forcave të armatosura dhe kontribuon në marrjen e vendimeve në menaxhimin e emergjencave

- **IGJEO (Instituti i Gjeoshkencave):**

  Është përgjegjës për lëshimin e paralajmërimeve të motit dhe kryerjen e funksioneve të monitorimit të motit. Mund të sigurojë parashikime dhe të dhëna të motit të dobishme për koordinimin dhe shpërndarjen e burimeve.

# 9. Referenca

**Referencat ligjore:•**


- Ligji Nr. 115/2014 datë 31.7.2014 "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.
- Ligji Nr. 107/2016 "Për prefektin e qarkut"
- Ligji nr.139 / 2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar.
- VKM Nr. 88, datë 22.2.2023 "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian" 2022–2030
- Ligji 45/2019, datë 18.07.2019 "Për mbrojtjen civile"
- Ligji Nr. 97/2019 "Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 9, datë 16.12.2019, të këshillit të ministrave, "për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore"
- Ligji Nr. 75/2016 "Për Miratimin e Marrëveshjes së Parisit"
- Ligji Nr. 155/2020 "Për ndryshimet klimatike"
- Ligji Nr. 152/2015 "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin".
- VKM Nr. 168, datë 24.3.2023 "Për miratimin e vlerësimit të riskut nga fatkeqësitë në nivel qendror"
- VKM Nr. 94, datë 22.2.2023 "Për miratimin e strategjisë kombëtare për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë 2023–2030 dhe planit të veprimit".
- VKM Nr. 807, datë 28.12.2023 "Për miratimin e Planit Kombëtar për Emergjencat Civile"
- Ligji Nr. 10 138, datë 11.5.2009 "Për shëndetin publik" i ndryshuar.
- VKM Nr. 241, datë 27.3.2013 "Për organizimin dhe funksionimin e inspektoratit shtetëror shëndetësor"
- Ligji Nr.10 107, datë 30.3.2009 "Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.
- VKM Nr. 419, datë 4.7.2018 "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor".
- Ligji Nr. 10 431, datë 9.6.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit", i ndryshuar
- VKM Nr. 568, datë 17.7.2019 "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit".
- VKM Nr. 708, datë 9.9.2020 "Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit".
- Ligji Nr.7746, datë 28.7.1993 "Për hidrokarburet (kërkimi dhe prodhimi)", i ndryshuar

- VKM Nr. 276, datë 16.5.2018 “Për miratimin e mënyrës së organizimit, të strukturës, organikës dhe statutit të Autoritetit Rrugor Shqiptar”, i ndryshuar.
- VKM Nr. 750, datë 16.9.2015 “Për miratimin e rregullores së Policisë së Shtetit”.
- Ligj nr. 102/2014 datë 31.7.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Rregullore e brendshme mbi organizimin dhe funksionimin e degëve doganore.
- Ligji Nr. 10 465, datë 29.9.2011 “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
- VKM Nr. 683, datë 2.9.2020 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e autoritetit kombëtar të veterinarisë dhe mbrojtjes së bimëve”.
- VKM Nr. 147, datë 13.3.2018 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e agjencive rajonale të ekstensionit bujqësor”.
